

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



Për Lexuesin

Arsyeja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti – shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshton faktin e krijimit – dhe me këtë, ekzistencën e Zotit, në këto 140 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz t'a braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, të treguarit se kjo teori është një mashtrim është një detyrë e rëndësishme, e cila është ngushtë e lidhur me religjionin. Është e domosdoshme që ky shërbim i rëndësishëm t'i ofrohet secilit. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

Të gjitha librat e autorit shpjegojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e Allahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptoj ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influentuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.


Përveq kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezentimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësin e Allahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësoj materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfrime të pashpresa, dyshim-krijuese dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.

MREKULLIA E
KRIJIMIT TË
NJERIUT

HARUN YAHYA
(ADNAN OKTAR)



Për Autorin

Autori, i cili shkruan me pseudonimin Harun Yahya, u lind në Ankara më 1956. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Ankara, pastaj studioj artet në Universitetin Mimar Sinan të Stambollit dhe filozofinë në Universitetin e Stambollit. Që nga 1980 ka botuar shumë libra lidhur me çështjet e besimit dhe shkencës. Harun Yahya është i njohur si një autor që ka shkruar shumë punime në demaskimin e mashtrimit të evolucionistëve, shfuqizimin e pohimeve të tyre dhe lidhjen e errët ndërmjet Darwinizmit dhe ideologjive të përgjakshme siç janë fashizmi dhe komunizmi.

Pseudonimi i tij përbëhet nga emrat 'Harun' (Aaron) dhe 'Yahya' (John), në përkujtim të profetëve të nderuar të cilët luftuan kundër mungesës së besimit (fesë). Vula e Profetit në kopertinën e librave ka kuptim simbolik që është i lidhur me përmbajtjen e tyre. Ajo prezanton Kur'anin (shpalljen e fundit) dhe Profetin Muhamet, i fundit nga profetët. Nën udhëzimin e Kur'anit dhe sunetit autori qëllim të tij bën përgënjeshttrimin e doktrinave fundamentale të ideologjive pa fe dhe ka 'fjalën e fundit' që të shuan plotësisht kundërshtimet e ngritura kundër religjionit. Vula e Profetit të fundit, i cili arriti mençuri dhe moral perfekt, përdoret si një shenjë e qëllimit të tij të thënjes së fjalës së fundit.

Të gjithë librat e autorit janë të përqendruara në një qëllim: të bartet porosia e Kur'anit te njerëzit, inkurajimi i tyre në të menduarit e çështjeve themelore lidhur me fenë (siç është ekzistenca e Zotit, uniteti I Tij dhe Amshueshmëria), dhe të ekspozohet themeli i brishtë dhe i prishur i ideologjive të sistemeve pa fe.

Punimet e Harun Yahya-së lexohen në shumë vende, nga India në Amerikë, Anglia

në Indonezi, Polonia në Bosnje dhe Spanja në Brazil. Disa nga librat e tij janë në dispozicion në gjuhën angleze, frënge, gjermane, spanjolle, italiane, portugeze, urdeze, arabe, shqipe, ruse, serbo-kroate (boshnjake), polake, malay, uygur, turke dhe indoneze.

Shumë të çmuara në botë, këto punime janë bërë instrumente që shumë njerëz të rigjejnë besimin në Zot dhe shumë të tjerë të depërtojnë më të thellë në fenë e tyre. Stili i qartë, i lehtë dhe i rrjedhshëm për tu kuptuar iu jep këtyre librave një veçanti, të cilat drejtpërdrejt kanë efekt në secilin që i lexon dhe i studion ato. Imune ndaj kundërshtimeve, këto punime karakterizohen me veçori të efektit të menjëhershëm, rezultate definitive dhe të pakundërshtueshme. Ata të cilët lexojnë këto libra dhe i kushtojnë vëmendje serioze nuk mundën më tutje sinqerisht të përkrahin filozofin materialiste, ateizmin apo çfarëdo ideologjie apo filozofie të prishur. Nëse vazhdojnë edhe më tutje ashtu, do të jetë vetëm për shkak të këmbënguljes sentimentale meqenëse këto libra përgënjeshtrojnë ideologjitë e tilla që nga themeli. Të gjitha lëvizjet bashkëkohore të mohimit janë tashmë ideologjikisht të mposhtura duke iu falemnderuar përmbledhjeve të librave të shkruara nga Harun Yahya.

Nuk ka dyshim se këto veçori rezultojnë nga urtësia dhe qartësia e Kur'anit. Modestia e autorit synon të shërbej si mjet në kërkimin e njerëzimit për në shtegun e drejtë të Zotit. Asnjë përfitim material nuk kërkohet në botimin e këtyre punimeve.

Duke marr parasysh këto fakte, ata të cilët inkurajojnë njerëzit që të lexojnë këta libra, të cilët hapin 'sytë' e zemrës dhe udhëzojnë për t'u bërë shërbëtorë më të devotshëm të Zotit, ofrojnë një shërbim tejet të çmueshëm. Përvoja ka treguar se është humbje kohe dhe energjie propagandimi akoma i librave të tjerë, të cilët sjellin vetëm konfuzion dhe dyshim në zemrat e njerëzve. Është e qartë që për librat që kanë efekt aq të madh, është e pamundur që të theksohet më tepër fuqia letrare e autorit se sa qëllimi fisnik i shpëtimit të njerëzve nga humbja e besimit. Ata të cilët dyshojnë në këtë mundën me lehtësi të shikojnë se qëllimi i vetëm i Harun Yahya-së është që të mposht mosbesimin dhe të përhap vlerat morale të Kur'anit. Suksesi dhe ndikimi i këtij shërbimi manifestohen në bindjen e lexuesit.

Një çështje duhet të mbahet në mend: Arsyeja kryesore e mizorisë së vazhdueshme, konfliktit, dhe sprovave që shumica e njerëzve kalojnë është mbizotërimi i ideologjisë së mosbesimit. Kjo gjendje mund të marr fund vetëm me mposhtjen ideologjike të mosbesimit dhe me transmetimin e mrekullive të krijimit dhe moralit të Kur'anit në mënyrë që njerëzit të jetojnë sipas tij. Duke pasur parasysh gjendjen e botës sot, e cila udhëheq njerëzit në tatëpjetën e spirales së dhunës, korrupsionit dhe konfliktit, është e qartë se ky shërbim duhet të ofrohet sa më shpejt dhe në mënyrë efektive. Përndryshe, mund të jetë shumë vonë.

Nuk është ekzagjerim të thuhet që përmbledhja e librave të Harun Yahya-së kanë këtë rol prijës. Me vullnetin e Zotit, këto libra do të jenë mjete përmes të cilave njerëzit në shekullin 21 do të arrin paqën, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

MREKULLIA E KRIIMIT TË NJERËT



HARUN YAHYA
(ADNAN OKTAR)

MREKULLIA E
KRIJMIT TË
NJERIUT



www.harunyahya.com

PËRMBAJTJA



HYRJE

11



**NJË SISTEM I MREKULLUESHËM
PËR NJË JETË TË RE**

15



**NJË ARMATË PERFЕКTE E CAKTUAR
NË QËLLIMIN E SAJ**

29



**ROLI I QELIZËS VEZË NË FORMIMIN
E NJË NJERIU TË RI**

49



KRIJIMI I NJERIUT NGA NJË QELIZË

79



DREJT NJË BOTE TË RE

147



**EMBRIOLOGJIA HEDH POSHTË
GËNJESHTRËN E EVOLUCIONIT**

155



PËRFUNDIM

159



EVOLUCIONI IDE E GABUAR

161

Zoti është Ai i Cili e bëri tokën shtëpi/vendbanim të qëndrueshem për ju dhe qiellin si kulm, dhe ju dha formë nga format më të mira, e ju furnizoi me gjëra të mira dhe të shëndetshme. Ai është Zoti, Sunduesi juaj. Bekuar qoftë Zoti, Sunduesi i të gjitha botërave. (Kur'an, 40: 64)



HYRJE

Trupi i njeriut është makina më e komplikuar në botë. Ne shikojmë me të, dëgjojmë me të, marrim frymë me të, ecim dhe vrapojmë me të, dhe ndjejmë kënaqësi me të. Eshtrat e tij, muskujt, arteriet, venat dhe organet e mbrendshme janë të organizuara me një krijim të mrekullueshëm, dhe kur shikojmë këtë krijim në detaje gjejmë fakte edhe më mahnitëse. Çdo pjesë e trupit, edhe pse secila duket tejet e ndryshme nga tjetra, është e ndërtuar nga materiali i njejtë: qelizat.

Qelizat, që secila prej tyre është sa një e njëmijëta pjesë e milimetrit, janë njësi strukturale që formojnë trupin tonë dhe çdo gjë në të.

Disa nga këto qeliza bashkohen që të formojnë eshtra, të tjerat që të formojnë nerva, mëlçinë, shtresën e brendshme të stomakut, lëkurën apo kornen e syrit. Secila e ka madhësinë dhe formën që saktësisht i përgjigjet nevojave të asaj pjese të trupit.

Si dhe kur qeliza, e cila ka funksione aq të ndryshme, erdhi në ekzistencë?

Përgjigja në këtë pyetje do të na dërgoj në një process i cili në çdo moment është i mbushur me misterie. Të gjitha përafërsisht 100 trilion qeliza të cilat sot e përbëjnë trupin tënd erdhën nga ndarja e një qelize të vetme.

Ajo qelizë e cila pati strukturën sikurse të gjitha qelizat në trupin tënd tash, erdhi nga bashkimi i vezës së nënës tënde dhe spermatozoidit të babait tënd.

Në Kur'an, Zoti nganjëhere iu referohet mrekullive në tokë dhe në qiell, dhe nganjëhere misterieve të krijimit të gjërave të gjalla si shenja të ndryshme të ekzistencës së Tij. Krijimi i mrekullueshëm i qenies njerëzore është njëra nga më të rëndësishmet e këtyre shenjave.


Në shumë vargje, si mësim për qenien njerëzore, Zoti këshillon ata që të shikojnë krijimin e tyre. Ai shpjegon në detaje krijimin e qenies njerëzore dhe fazat e zhvillimit të tij. Në Suren 56, Ai tregon për krijimin e njeriut:

Ne iu krijuam juve, e përse nuk e pohoni të vërtetën? A keni menduar për spermën që e derdhni? A jeni ju që e krijoni atë apo Ne jemi Krijuesi? (Kur'an, 56: 57-59)


Përmbajtja e njeriut që përbëhet nga 60-70 kilogram mish dhe eshtra fillimisht ishte në një pikë lëngu. Sigurisht që është një mrekulli që një qenie njerëzore inteligjente, me ndjenja me të gjitha aftësitë e të folurit dhe dëgjimit dhe me një sistem fizik kompleks të mrekullueshëm të vijë në ekzistencë nga një pikë lëngu. Ky zhvillim sigurisht që nuk ishte rezultat i një procesi të rastit apo veprimi i rastësishëm, por është një proces i vetëdijshëm i Krijuesit.

Ky libër do të shpjegoj në detaje mrekullin që përjetohet vazhdimisht, nga çdo person në faqen e tokës, mrekullin e krijimit të njeriut. Duhet të jetë e qartë që gjërat të cilat shtjellohen në këtë libër janë vetëm një pjesë e ndërlikimeve të krijimit të njeriut; por edhe me aq sa paraqitet në këtë libër del në pah fuqia e përhershme e Krijuesit, njohuria e Tij e pakufishme dhe inteligjente që rrethon dhe përfaqon gjithë universin. Ky libër do t'i përkujtojë njerëzit se Zoti I Madhërishtë është 'Krijuesi Më I Mirë'.

Ne e krijuam njeriun nga lloji i baltës më të pastër; pastaj e bëmë pikë (uji) në një vend të sigurt; pastaj shndërruam pikën në një droçkë dhe shndërruam droçkën në një copë mishi dhe shndërruam atë copë mishi në eshtra dhe i veshëm eshtrat me mish; dhe pastaj atë e sollëm në jetë si krijesë tjetër. I Bekuar qoftë All-llahu, më i miri Krijues! (Kur'an, 23: 12-14)







*Është Ai I Cili iu formon
në mitër ashtu si dëshiron Ai.
Nuk ka Zot tjetër përpos Tij, I
Plotëfushishmi, I Urti.
(Kur'an, 3: 6)*

Një Sistem i Mrekullueshëm i Krijuar për një Jetë të Re

Vazhdimësia e racës njerëzore në botë është e mundur me punën perfekte të sistemit riprodhues. Trupat e meshkujve dhe të femrave janë mjaft të ndryshëm nga njëri tjetri në funksionin e organeve të tyre riprodhuese, por këto sisteme shumë të ndryshme funksionale në mënyrë perfekte plotësojnë njëra tjetrën me rezultatin që një qenie e re njerëzore lind në këtë botë. Nga elementet themelore të prodhuara në dy trupa të ndryshëm, të pavarur nga njëri tjetri, një nga mrekullitë më të mëdha të botës ndodh: mrekullia e krijimit të njeriut.

Në mënyrë që mrekullia e krijimit të njeriut të ndodh, përgatitjet e duhura në të vërtetë fillojnë shumë vite më herët. Së pari, qelizat riprodhuese të mashkullit dhe të femrës duhet të bëhen funksionale. Kjo ndodh gati në çdo qenie njerëzore përmes procesit të quajtur pubertet. Elementi më i rëndësishëm në këtë proces sigurisht që është sistemi hormonal, i cili vendos komunikimin në mes të qelizave nën drejtimin e trurit.


Zoti ka krijuar një sistem në të cilin të gjitha nevojat e trupit të njeriut dhe zhvillimi i tij janë nën kontrollin e trurit. Ai ka bërë që mesazhet që shkojnë në tru nga organet të vlerësohen në tru, i cili pastaj e jep përgjigjen e duhur; kjo pastaj dërgohet në fushat e duhura në një kohë tejet të shkurtër.

Në këtë proces sistemi hormonal përdoret për të dërguar informatat. Zoti ka krijuar në trupin e njeriut një rrugë postare perfekte për komunikim. Në këtë rrugë postare, molekulat mesazh-bartëse quhen 'hormone' ku secila prej tyre me të vërtet kryen funksionin e postierit. Ashtu si postieri që shkon nëpër rrugët e qytetit për të shpërndarë letrat tek adresa e caktuar, ashtu edhe hormonet bartin urdhërat nga truri te qelizat përkatëse. Në këtë mënyrë, brenda trupit aktivizohen funksionet e nevojshme për jetën e njeriut.

Por këtu duhet të kujtohem që hormonet nuk janë qenie njerëzore të cilat posedojnë vetëdije për të ditur çfarë mesazhe duhet bartur, në cilin vend duhen bartur, apo të vendosin për drejtimin e rrugës së tyre. Ato nuk kanë pasur ushtrime apo nuk kanë fituar njohuri pas viteve të studimit. Hormonet që ne po i quajmë postier, janë të përbëra nga molekulat që mund të paraqiten me formulat më komplekse. Me të vërtet është një mrekulli e madhe që një molekulë e di ku është duke shkuar dhe çka duhet të dërgoj; që d.m.th. të vendos se cilin mesazh t'a dërgoj të cilat qelizë; t'a gjej rrugën pa u humbur asnjëherë në terrin e plotë të trupit të njeriut i cili është me miliona herë më i madh se sa ajo dhe këtë detyrë e kryen pa të meta, pa e dëmtuar veten apo mesazhin. Vetëm ky shembull është dëshmi e mjaftueshme e sistemit të jashtëzakonshëm që Zoti e ka vendosur në trupin e njeriut.

Funksionimi i sistemit hormonal të njeriut në përgjithësi fillon kur ende është në mitrën e nënës dhe vazhdon deri në vdekje. Gjëndrrat riprodhuese fillojnë të funksionojnë po ashtu si rezultat i efekteve nga hormonet. Mirëpo ndryshe nga pjesët e tjera të trupit, sekretimi i hormoneve që ka të bëjë me gjëndrrat riprodhuese fillon në pubertet. Hipotalamusi, një vend i vogël në bazën e trurit, konsiderohet si kontrollues i sistemit hormonal; në pubertet, fillon t'u dërgoj mesazhe gjëndrrave të hipofizës që t'i bëjë organet riprodhuese të fillojnë funksionimin.

Edhe këtu është e nevojshme të theksohet një tjetër mrekulli. Hipotalamusi është në dijeni për zhvillimet në trupin e njeriut, p.sh. e di moshën e njeriut dhe a është apo nuk është personi i zhvilluar mjaft fizikisht që sistemi i tij i riprodhimit të fillojë funksionimin. Dhe hipotalamusi kryen punën e tij në mënyrë të vetëdijshme. Me fjalë të tjera, hipotalamusi, llogarit kohën dhe vendos se moshë madhore e personit ka ardhur, dhe u jep urdhërin e duhur gjëndrrave



TMjeshtri i sistemit hormonal është hipotalamusi. Lidhjet e tij me pjesët e tjera të trurit janë ilustruar në foto.

të ndryshme endokrine në trup. Dërgon mesazhet (hormonet) saktësisht në momentin e duhur te organet e paracaktuara riprodhuese dhe siguron fillimin e zhvillimit të nevojshëm që të lejoj racën njerëzore të vazhdojë. Dhe kjo nuk ndodh te hipotalamusi i një njeriu të vetëm; në këtë moment hipotalamuset e milionave njerëzve në botë janë duke kryer këtë funksion në të njejtën mënyrë dhe gati në të njejtën periudhë.

Fakti që kjo pjesë mishi, që zen vend në trupat tonë jo më shumë se disa katror sheqer, është e vetëdijshme për kohën dhe mund të bëj rregullime për pasazhet e kohës sigurisht që është diçka që kërkon vëmendjen tonë. Si bën kalkulime të tilla hipotalamusi? A i ka treguar dikush hipotalamusit

se çka duhet të bëj, apo e kuptuar nga vetvetja? Si kalkulon hipotalamusi se gjëndrrat riprodhuese duhet të zhvillohen në mënyrë që qenia njerëzore të vijë në ekzistencë? Si e di që hormoni i posaçëm duhet të sekretohet në këtë kohë të posaçme? Dhe si vendos që cili në mesin e të gjithë hormoneve që prodhon, do të vendos sistemin riprodhues në veprim saktësisht në kohën e duhur? A ka parashikim që të vendos për planin e së ardhmes, dhe bën masat e nevojshme dhe përgatitjet që ky plan të ndodh? Pse pret deri në kohën e saktë, kur trupi i njeriut është gati fizikisht për prodhim, e as më herët e as më vonë?

Intelegjenca që mund të bëj një pjesë mishi pa sy, veshë apo tru, të drejtojë qelizat sikur të ishte vet një qenie inteligjente është e pakrahasueshme dhe e madhe për t'u imagjinuar nga ne.

Nuk është as rasti as ndonjë forcë tjetër që e vë hipotalamusin në dijeni të kohës; inteligjenca e lartë që ia jep atij funksionin e veçantë i përket Zotit. Është Zoti I Gjithëdijshëm I Cili inspiron këtë pjesë të vogël të mishit që të dijë se çka duhet të bëj. Se çdo gjë është nën kontrollin e Zotit është shpallur në këtë varg:


...Zoti është mbikqyrës i të gjitha gjërave. (Kur'an, 33:52)

Në faqet që pasojnë, është e dobishme të mbahet në mend ky fakt.

Hormonet Mund t'i Dallojnë Gjinitë

Hipotalamusi ndërmer hapat e parë të nevojshëm që të sjell meshkujt dhe femrat në fazën e pubertetit duke dërguar Gn-RH hormonin (duke liruar – Gonadotropinën) nëpërmes qarkullimit të gjakut te gjëndrra e hipofizës. Gjëndrra e hipofizës fillon funksionin e saj me urdhër nga hipotalamusi dhe fillon të dërgoj hormone të cilat aktivizojnë organet riprodhuese. Këto janë LH (luteinizing) hormoni dhe FSH hormoni (stimulojnë folikulin). Secila nga këto hormone sekretohen (tajiten) te meshkujt dhe te femrat, por efekti i tyre është i ndryshëm.¹

Përkundër faktit që të njejtat hormone sekretohen (tajiten) te meshkujt dhe te femrat, është shumë befasuese se çfarë ndryshimi të plotë kanë



Hipotalamusi në bashkëpunim me lobin e përparëm të gjëndrrës së hipofizës dhe testiseve shkakton prodhimin e spermës te mashkujt (majtas). Prodhimi i hormonit te femra (djathtas) përfshin hipotalamusin, gjëndrrën e hipofizës dhe vezorët. Këto veprime biokimike të veçanta te meshkujt dhe te femrat demonstrojnë ekzistencën e një ndërtimi dhe plani inteligjent.

efektet e tyre. P.sh. FSH hormoni te femrat stimulon prodhimin e vezës; te meshkujt, i njejti hormon stimulon prodhimin e spermatozoidit. Te femrat hormoni LH kujdeset që veza të lëshohet në rrugën e saj në mitër dhe që hormoni tjetër i quajtur progesteron të sekretohet (tajitet) nga sistemi riprodhues i femrës. Progesteroni shërben që mitra të përgatitet për frytin. I njejti hormon kryen një funksion plotësisht të ndryshëm tek meshkujt, ku stimulon qelizat që të sekretojnë (tajisin) hormonin testosteron. Testosteroni prodhon karakteristikat e mashkullit dhe kujdeset për prodhimin e spermës.

Sigurisht që është interesant që hormone të njejta që prodhohen në trupa të ndryshëm sipas formulave të njejta të shkaktojnë rezultate plotësisht të ndryshme nga njëra tjetra.


Kur një hormon sekretohet (tajitet) në trupin e mashkullit, e di që i përket mashkullit dhe bën ndryshimet e duhura. P.sh. testosteroni bën zhvillimin e muskujve në trupin e mashkullit, e bën zërin më të thellë dhe mjekrrën të rritet.

Hormoni i njejtë sekretohet (tajitet) në trupin e femrës sipas formulës së njejtë por, te femra, shkakton rezultate plotësisht të kundërta. Hormoni që i jep një zë femëror femrës dhe një zë mashkullor mashkullit dhe rregullon zhvillimin e trupit duke u bazuar në

gjini, është një hormon që di të dallojë në mes të anatomisë dhe metabolizmit të mashkullit dhe të femrës. Fakti që një hormon posedon njohuri të tillë domethënë që ai ka inteligjencë dhe që ai ka pranuar udhëzime.

Shumë njerëz nuk dijnë rreth ndikimit të hormoneve në organet riprodhuese të mashkullit dhe të femrës, ndërlidhjet në mes të qelizave apo se si funksionet e trupit vendosen në veprim. Ata nuk kanë ide për zinxhirin komandues të trupit, dërgimin dhe pranimin e mesazheve, që zhvillimi i trupit varet nga këta urdhëra, dhe që pengesa më e vogël në funksionimin e sistemit mund të sjell pasoja fatale, e as që kanë kontrol mbi këto funksione. Nuk është aspak e pazakonshme për një person i cili nuk ka pasur ushtrime të veçanta në këtë fushë të mos ketë njohuri për këto gjëra por fakti që një grup molekular ka këtë njohuri është i habitshëm.


Si hormonet, me stukturat e tyre molekualre që pamë, erdhën në ekzistencë dhe mbartin informata kimike? Si ndodh që nuk janë të kënaqura vetëm me njohjen e metabolizmit të trupit, por secila sikur një kimist, edhe



*A nuk vështruan ata
pushtetin e qijeve
dhe tokës dhe asaj
çka ka krijuar All-
llahu, dhe të shofin
se afati i tyre i
caktuar është afër?
Ata që mohojnë këtë,
në çfarë shpallje
tjetër do të besojnë?
(Kur'an, 7: 185)*

e përdor njohurin që e posedon duke e adresuar atë në fushat e trupit ku është e nevojshme? Si i dirigjojnë qelizat e tjera që të prodhojnë hormonet e nevojshme në kohën kur ato nevojiten? Si mundet një masë e pavetëdijshme e molekulave të ketë inteligjencë për të bërë të gjitha këto gjëra? Është e kuptueshme që molekulat e quajtura hormone nuk mund t'a kenë këtë inteligjencë. Është e qartë se të gjitha këto procese nuk u formuan nga rastësia nga ndonjë veprim tjetër i rastësishëm.

Është vetëm një sqarim për këtë: proceset biokimike nga të cilat meshkujve dhe femrave iu ipen karakteristikat e tyre të ndara, paraqesin ekzistimin e një plani dhe ndërtimi të qëllimtë. Ky ndërtim është puna e




Në ilustrimin lart shofim strukturën molekulare dhe të kristalizuar të hormonit progesteron (1), dhe poshtë, shofim strukturën molekulare dhe të kristalizuar të hormonit estrogjen (2). Është e qartë se këto hormone, të përbëra nga disa atome, nuk munden nga vullneti i tyre, të planifikojnë ndryshimet që ndodhin në trupin e njeriut. Është Zoti i Madhërisëm Ai që i krijoj ato dhe u dha atyre funksionin mahnitës.

intelegjencës supreme të Zotit. Atë që duhet t'a bëj njeriu është që të mendoj thellë për këtë art pa të meta dhe t'i nënshtrohet Zotit! Cili është sundimtari i çdo gjëje.

Zhvillimi i Qelizave Riprodhuese

Në fabrika që përdoren mjete teknologjike, shumë robot përdoren në fazat e ndryshme të prodhimit. Të gjitha programet, sistemet funksionale, pjesët mbështetëse të këtyre makinave, thënë shkurt, çdo informatë që është e nevojshme për prodhim është e lokalizuar në qendrën kontrolluese të asaj fabrike. Është si një bankë të dhënash në të cilën depozitohen të gjitha informatat e nevojshme që duhen përdorur gjatë fazave të prodhimit, për cilësi dhe kontroll dëmtimi. Trupi i njeriut është struktura më e avancuar dhe më komplekse në botë; nëse e bëjmë krahasimin me një fabrikë të tillë mund të themi se, në mënyrë që kjo fabrikë të vazhdoj funksionimin duhet t'i ketë të gjitha informatat të cilat janë të ruajtura në molekulën e ADN-së në bërthamën e qelizës.


ADN-ja përmban të gjitha informatat lidhur me njeriun dhe gjendet në bërthamën e çdo qelize të përafërisht 100 trilion qelizave në trupin tonë. Brenda një qelize, ADN-ja është e organizuar në proteinë të dendur ADN komplekse e quajtur kromozome. Në ilustrim djathtas, shifet se si kromozomet janë të paketuara në qelizë. Ky dizajn në ADN është një nga shembujt më të mirë të krijimit në mënyrë perfekte nga Zoti.



Kur një njeri është ende një qelizë e re vezë e fekunduar në mitrën e nënës, Zoti vendos të gjitha cilësitë që ai do t'i ketë në të ardhmen dhe i shtyp ato në molekulën e ADN-së. Që nga ngjyra e flokëve e deri te gjatësia e tij, sëmundja që është preh gjatë jetës e deri te çdo karakteristikë fizike çdo cilësi e njeriut ruhet me kujdes, por në një madhësi aq të vogël sa që mund të shifet vetëm me mikroskop elektronik.

ADN-ja gjendet në secilën qelizë të përafërsisht 100 trilion qelizave në trupin tonë. Mesatarja e diametrit të një qelize është 10 mikrona (një mikron është një e mijëta e milimetrit); nëse mendojmë për këtë, do ta kemi më të lehtë që të kuptojmë se sa shumë informata janë të ruajtura në atë hapësirë aq të vogël.

Nëse ADN-ën, e cila lejon që jeta e gjërave të gjalla të vazhdojë sipas një programi të planifikuar, e mendojmë si një enciklopedi, volumet e kësaj enciklopedie janë kromozomet e saja.



Është shumë e rëndësishme që këto volume kromozomesh paraqiten në çifte në molekulën e ADN-së. Në procesin e krijimit të tij, çdo qenie njerëzore pranon një palë të këtyre volumeve të kromozomeve nga nëna dhe tjerin nga babai. 23 kromozome që vijnë nga nëna dhe 23 kromozome që vijnë nga babai kompletojnë njëra tjetrën. Kjo është, 46 kromozome në bërthamën e një qelize njerëzore janë në të vërtetë 23 qifte kromozomesh. Kromozomi i 23-të ka funksion të veçantë: zakonisht shenohet me shkronjën X ose Y. Te meshkujt, njeri anëtarë i qiftit është kromozomi X dhe tjetri është kromozomi Y, te femrat kromozomi i 23-të është i përbërë nga dy X-a.²

Në dritën e kësaj informate një pyetje vije në mendje: pasi që çdo qelizë e njeriut përbëhet nga 46 kromozome, si ndodh që si rezultat i kombinimit të qelizave të nënës dhe babait, foshnja e re e lindur ka 46 kromozome? Do të dukej logjike që 46 kromozomet e nënës dhe 46 kromozomet e babait të prodhojnë një foshnje abnormale me 92 kromozome. Por kjo nuk ndodh. Si ndodh pra që secili lindet me nga 46 kromozome?



Përgjigja në këtë pyetje paraqet mrekullin e shkëlqyeshme të krijimit.

Një Ndarje e Pagabueshme...

Në qelizat e trupit ndodhin dy lloje të ndarjeve. Lloji i ndarjes i quajtur 'mitoz' ndodh në të gjitha qelizat e trupit. Gjatë mitozës, një qelizë jep dy qeliza bija gjenetikiisht identike. Si rezultat i kësaj ndarje, nëna qelizë ndahet për të formuar dy bija, secila prej tyre përmban numrin e njejtë dhe llojin e njejtë të kromozomeve sikur qeliza nënë.

Këtu, është e nevojshme që të qartësohet një pikë. Sikur qelizat riprodhuese të ndaheshin në këtë mënyrë dhe sikur të kishin numrin e njejtë të kromozomeve sikurse të qelizave të tjera të trupit, nuk do të ishte e mundur për qenien njerëzore të bëhej qenie njerëzore sepse sikurse që sqaruar më lart, lindja me kombinim të 46 kromozomeve nga babai dhe 46 nga nëna do të prodhonte një foshnjë me 92 kromozome duke shkaktuar një deformim të pamjes njerëzore. Mirëpo ndarja e qelizave riprodhuese bëhet ndryshe; kjo ndarje quhet 'meioz'. Gjatë 'meioz-ës' numri i kromozomeve në qelizë reduktohet përgjysmë, kjo d.m.th nga 46 në 23.

Fazat në formimin e vezë dhe spermatozoidet



Si rezultat i ndarjeve të ndryshme të qelizave primare vezë në vezore, formohen tri qeliza sekondare polare dhe një 'ootid'. Qelizat e vogla vdesin dhe e madhja formon vezën. Sikur të gjitha qelizat e prodhuara të kishin të njëjtën madhësi, zigoti i formuar pas fekondimit nuk do të kishte ushqim të mjaftueshëm.

Fazat e formimit të vezës, (qeliza riprodhuese e femrës) është ilustruar majtas. Veza formohet pasi që qelizat primare vezë në vezore (oogonia) të kalojnë nëpër një seri ndarjesh. Te mashkulli, spermatozoidi prodhohet kur qelizat primare të spermatozoidit në testise (spermatogonia) ndahen. Që nga momenti i ndarjes së tyre të parë, qelizat riprodhuese funksionojnë nën mbikqyrje. Kur mendohet për këtë harmoni të elementeve që përbëjnë trupin e njeriut, (qelizat, enzimet, hormonet), çdo njeri që di të mendojë kupton se ky sistem nuk ka mundur të bëhet nga rastësia. Është Zoti Ai që krijon njeriun, dhe gjërat e jashtëzakonshme që ndodhin në trupat tonë janë shembuj të artit të krijimit të Tij.

Para se të kompletohen këto ndarje, qelizat riprodhuese nuk kanë arritur pjekurinë. Në trupin e secilit mashkull dhe secilës femër është një mekanizëm që i bën këto qeliza të pjekura dhe i përgatitë ato për udhëtimin e vështirë që e kanë para vetes. Sistemet riprodhuese të mashkullit dhe të femrës, që janë plotësisht të panjohur për njëri tjetrin dhe shumë të ndryshëm në shumë mënyra, mundohen t'i bëjnë të gatshme për njëra tjetrën qelizat që i prodhojnë.

Sa i përket kësaj teme do të prezantohen shpjegime në detaje në faqet në vijim. Por, derisa lexoni këto faqe, është një pikë e rëndësishme që duhet t'a vëreni. Prej momentit të parë që qelizat riprodhuese fillojnë të ndahen, ato i janë të nënshturara një plani të qartë (të caktuar). Asgjë nuk është rastësi. Qelizat ndahen saktësisht sipas nevojës dhe mbajnë numrin e nevojshëm të kromozomeve pa asnjë ndryshim apo mangësi gjatë tërë procesit. Çdo organ, çdo qelizë nga e cila ai përbëhet, dhe organelet të cilat e përbëjnë qelizën, funksionojnë në harmoni perfekte. Përveq kësaj, molekulat që i formojnë enzimet dhe hormonet që luajnë rol në funksionimin e trupit, dhe atomet që i formojnë këto molekula, janë pjesë të një sistemi informativ tejet kompleks, i cili u tregon atyre se kur duhet të fillojnë punën e tyre, dhe ato kurrë nuk janë në padijeni se si dhe deri në çfarë shkalle është i nevojshëm ndikimi i tyre.


Qelizat, enzimet, hormonet, shkurt harmonia që ekziston në mes të gjitha pjesëve të trupit sigurisht së është diçka e cila ia vlen të mendohet rreth saj.

Fakti që molekula dhe atomet të cilat e përbëjnë këtë molekulë mund të bëjnë një plan, dhe veprojnë sipas tij; që njëra pjesë jep urdhër dhe pjesa tjetër bindet, e kupton atë dhe vepron është tejet e jashtëzakonshme që të mund të jetë e rastësishme. Fakti që kjo ka ndodhur dhe ende ndodh në të gjithë trupat e milionave qenieve njerëzore e bën atë edhe më të jashtëzakonshme, që e njejta harmoni funksionon perfekt në çdo individ. Është e qartë që kjo nuk mund të ndodh rastësisht, dhe që një intelegjencë e vetëdijshme, supreme është përgjegjëse për dhënjen e cilësive qelizave mikroskopike të cilat formojnë trupin tonë, gjithashtu edhe hormoneve që këto qeliza prodhojnë, enzimeve dhe qindmijërave elementeve të imëta në

sistemin e njeriut. Është e qartë se çdo pjesë e çdo faze të sistemit që funksionon në trupin e njeriut është larg të të kuptuarit nga njeriu dhe se kjo është punë e një intelegjence të fuqishme dhe të pakrahasueshme.

Kjo intelegjencë supreme i takon Zotit, I Cili ka krijuar gjithë universin deri në detajet më të vogla. Në Kur'an Zoti thotë që nuk ka zot tjetër përveç Tij:

All-llahu, s'ka Zot tjetër përpos Tij, Ai është i gjallë e Vet-Mbajtës; Atë nuk e zë as kotja as gjumi; gjithçka në qiej e në Tokë i përket Atij. Kush mund të ndërmjetsoj tek Ai përveç me lejen e Tij? Ai e di se çka ata kanë lënë pas dhe çka kanë përpara e ata nuk mund të kapin asgjë nga ditura e Tij përveç aq sa dëshiron Ai. Pushteti i Tij përfshinë qiejt e Tokën, Atë nuk e lodh ruajtja e tyre. Ai është më I Larti, Më I Madhërishmi. (Kur'an, 2: 255)



Ky është All-llahu, Zoti i juaj. Nuk ka zot tjetër përveq Tij, Krijues i çdo gjëje. Kështu që adhurojeni Atë. Ai është mbikqyrës i çdo gjëje. (Kur'an, 6: 102)

NJË ARMATË PERFEKTE E CAKTUAR NË QËLLIMIN E SAJ

Mendo për një armatë tejet të madhe e përbërë nga miliona ushtarë. Ata lëvizin drejt një caku të përbashkët, hasin në pengesa gjatë rrugës dhe përballohen me rrezik vdekjeprurës, por përkundër të gjitha këtyre vështirësive armata nuk dorëzohet. Hapësirën që këta ushtarë duhet t'a përshkojnë në mënyrë që të arrijnë tek caku është njëqind mijë herë më e madhe se sa ata vetë. Natyrisht, një armatë e tillë e ngjeshur e caktuar për një rrugë të tillë të vështirë ka nevojë për udhëzime dhe pajisje që të sigurohet arritja e qëllimit.

Kjo armatë gjigante me 300 milion ushtarë është brenda trupit të mashkullit. Ushtarët janë spermatozoidët. Madhësia e secilit është rreth një e qinda e milimetrit. Caku i tyre është që të arrijnë te qeliza vezë, dhe për t'a bërë këtë, ata duhet të kalojnë një rrugë shumë të gjatë.

Nga 300 milion spermatozoidet që së bashku nisen për në rrugë, vetëm më të fortit rreth 1000 kanë sukses që të arrijnë te veza. E nga këta vetëm një spermatozoid e fiton garën dhe fekondon vezën. Para se të fillojë kjo garë, spermatozoidet së pari kalojnë një udhëtim të gjatë brenda organeve riprodhuese të mashkullit, duke kaluar nëpër faza të ndryshme në rrugën e tyre të pjekurisë. Në këtë proces të pjekurisë, spermatozoidet kanë shumë ndihmësa.

Shtegu i Zhvillimit të Spermës

Në mënyrë që të fekondohet veza, rreth 200-300 milion spermatozoide përgatiten për udhëtim. Ky numër është befasues, por ka një rëndësi sa i përket kësaj. Siç do të shohim në detaje më vonë, një numër i madh i spermatozoideve që hyn në trupin e nënës së ardhshme vdesin gjatë rrugës dhe numri i qelizave të spermatozoideve që arrijnë deri te veza është shumë i vogël. Për këtë, numri i madh i spermatozoideve parandalon rrezikun që fekondimi i vezës të mos ketë sukses. Kjo armatë milionshe e spermës individuale prodhohet në organet riprodhuese të mashkullit që quhen testise. Spermatozoidet kalojnë në shumë faza gjatë prodhimit në testise dhe, në mënyrë që ata të mbijetojnë, vendi ku ata prodhohen duhet të jetë i freskët. Temperatura normale në trupin e njeriut është 37°C. Kjo temperaturë do të mbyste spermatozoidet, për këtë spermatozoidet nuk mund të jetojnë brenda trupit. Një nga karakteristikat më të dukshme të testiseve është se ata gjenden jashtë


trupit. Për shkak të këtij ndërtimi të veçantë që Zoti krijoi për mashkullin, spermatozoidet kanë një vend të përgatitur posaqërisht për prodhimin e tyre.

Testiest përbëhen nga një sistem me tuba të vegjël. Ky sistem i tubave zë një hapësirë mjaft të madhe, e cila iu lejon miliona spermatozoideve të prodhohen shpejt dhe në një vend ku mund të ruhen lehtë. Arsyeja pse spermatozoidet duhet të prodhohen shpejt dhe të ruhen është e kuptueshme kur kemi parasysh që për të fekonduar një vezë duhet të prodhohen 200-300 milion spermatozoide.


Kur mendojmë rreth numrit të spermatozoideve që prodhohen, mund t'i quajmë testiest fabrika në miniaturë. Për prodhimin e spermatozoideve ato kanë rreth 1000 tuba me një gjatësi të plotë rreth 500 metra. Këta tuba të vegjël quhen 'tubtha seminifer'. Secili është rreth 50 cm. i gjatë dhe përmban qelizat primare të spermatozoideve që të prodhojë spermatozoidet.³



Testiest e mashkullit, organet riprodhuese të mashkullit, lokalizimi i tyre në trup, kapaciteti i tyre riprodhues dhe ndërtimi i tyre i brendshëm janë shembull i ndërtimit të mrekullueshëm.



Në të djathtë, shofim sistemin e tubave të vegjël që përbëjnë testiset (tubthet seminifer). Këta tuba të vegjël përmbajnë qelizat primare të spermatozoideve. Në foton lart, shofim një detaj të lobit të testisit.



Tubthet seminifer janë të lidhura me qelizat formuese të spermatozoideve (spermatogonia) në faza të ndryshme të zhvillimit. Më vonë, këto qeliza fillojnë të shumohen, së pari kalojnë nëpër mitoz dhe pastaj kalojnë nëpër meioz. Siç kemi shpjeguar më herët, para fekondimit, qeliza primare e spermatozoidit ndahet sipas meiozës dhe përgjysmon numrin e kromozomeve të veta, kështu që foshnja do të pranojë 23 kromozome nga babai.

Në fund të kësaj ndarje, janë formuar katër qeliza të quajtura spermatide të cilat ende nuk janë të afta për të fekunduar vezën. Në mënyrë që këto qeliza sferike që përmbajnë nga 23 kromozome të jenë në gjendje të kryejnë funksionin e fekondimit, ato duhet të kalojnë nëpër ndryshime të mëtejshme.


Një grup qelizash janë vendosur në vend që t'i përgjigjen kësaj nevoje të posaqme të sistemit riprodhues të mashkullit dhe të ndihmojnë zhvillimin e qelizave spermatide saktësisht në kohën e duhur. Brenda dy ose tre javëve mbas kryerjes së meiozës, secila qelizë spermatide fizikisht do të transformohet nga këto qeliza 'infermiere' (qelizat Sertoli) të cilat i rrethojnë ato. Qelizat Sertoli kanë funksion të ndihmojnë dhe të ushqejnë qelizat e papjekura të spermatozoideve duke iu dhënë atyre ushqimin, hormonet dhe enzimet të cilat janë të nevojshme për të shkaktuar ndryshimet e duhura në spermatide.

MREKULLIA E KRIJIMIT TË NJERIUT

Në fazën finale të këtij procesi, arrihen cilësitë e duhura të zhvillimit të plotë të spermatozoidit, del bishti, koka dhe akrozomi, ajo pjesë e kokës e cila është mbushur me enzime. ⁴ (Për detaje shiko informacionin në pjesën e titulluar ‘Spermatozoidi Takon Vezën’)

Tërë puna e transformimit bëhet nga qelizat Sertoli të cilat gjenden në muret e tubthave. Këto qeliza kanë zgjatje citoplazmike dhe janë bukur të mëdha. Qelizat Sertoli mbajnë shtrëngueshëm në krahët e tyre qelizat spermatide të zhvilluara, duke u siguruar që ato të janë mirë të injektuara në citoplazmen e tyre. Në këtë mënyrë i furnizojnë me ushqim gjatë zhvillimit të tyre dhe i monitorojnë.⁵

Në këtë proces të cilin e shpjguam me pak fjalë, me të vërtetë ndodh një mrekulli e madhe. Spermatozoidet që garantojnë vazhdimin e racës njerëzore vijnë në ekzistencë duke iu falemnderuar qelizave Sertoli, të cilat përbëhen nga proteinat dhe acidet nukleike. Le të mendojmë për një moment. Fakti që, qelizat Sertoli të cilat janë pa intelegjencë apo vetëdije dhe pa sy, veshë e tru, mund t’a përkushtojnë veten në një detyrë të tillë është me të vërtetë një mrekulli. Fakti që një gjë e tillë ndodh është një dëshmi e qartë se qeliza është nën udhëzimin e një intelegjence supreme. Përveç kësaj, që këto qeliza janë saktësisht në vendin e duhur (në tubthet seminifer ku sperma



Tubthet seminifer, një pamje në detaje e ndërtimit e paraqitur lart, e cila siguron që spermatozoidet të prodhohen. Djathtas: pamje e pjesës së prerë të tubthit seminifer nën mikroskopin elektronik.

Majtas: ndërtimi i tubthit seminifer, paraqet zhvillimin e qelizave të spermatozoideve në faza të ndryshme.

zhvillohet) është një nga miliona dëshmit e krijimit perfekt të trupit të njeriut. Zoti ka vendosur secilën nga përafërsisht 100 trilion qelizave që përbëjnë trupin e njeriut në vendin e saj të duhur; Ai iu ka dhënë secilës cilësitë që nevojiten; dhe Ai iu ka dhënë secilës instinktin e kryerjes së punës në mënyrë perfekte. Sikurse që na thuhet në Kur'an:

... Nuk ka asnjë krijesë që Ai nuk e mban nën vëzhgim. Zoti im është në Rrugën e Drejtë. (Kur'an, 11: 56)

Një Sistem i Ndërvarur

Në paragrafin e lart folëm për rolin e qelizave Sertoli në transformimin e spermatoideve në spermatozoide. Cila është forca fizike që i aktivizon këto qeliza dhe i bën ato të dijnë detyrën e tyre që të ushqejnë spermatozoidet dhe të monitorojnë zhvillimin e tyre.

Impulsi i cili i bën qelizat Sertoli të kryejnë funksionin e tyre vjen nga hormoni (FSH) që stimulon folikulin, të cilin e kemi përmendur në paragrafin e më hershëm. Ky hormon sekretohet (tajitet) nga pjesa e përparme e hipofizës dhe stimulon qelizat Sertoli. Sikur ky hormon të mos prodhohet apo të dështoj të arrij fushën e nevojshme, spermatozoidet nuk mund të prodhohen. Kur qelizat Sertoli marrin stimulimin, ato fillojnë të sekretojnë (tajisinë) hormonin e quajtur estrogjen, i cili është i domosdoshëm për prodhimin e spermës. Qeliza tjetër që ndikon në prodhimin e spermës quhet qeliza 'Leydig'; ajo gjendet në mes të tubthave seminifer. Këto qeliza prodhojnë një hormon tjetër që nevojitet për zhvillimin e spermës. LH-ja (hormoni luteinizant) sekretohet (tajitet) nga pjesa e përparme e hipofizës dhe stimulon qelizat Leydig. Pastaj, këto qeliza fillojnë të prodhojnë hormonin testosteron. Testosteroni është hormon i cili ndikon në rritjen e organeve riprodhuese, zhvillimin e gjëndrrave të ndryshme të këtij organi dhe zhvillimin e karakteristikave seksuale të mashkullit; përveç kësaj, ky është hormoni më i rëndësishëm në prodhimin e spermës.


Qelizat Sertoli kanë edhe funksione tjera siç është prodhimi proteinës. Kjo proteinë do të bartë hormonet e estrogjenit dhe testosteronit te një lëng që gjendet në tubthet seminifer.⁶

Po ashtu edhe qelizat Leydig kanë edhe një funksion sekondar. Në mënyrë që spermatozoidet të lëvizin, ato kanë nevojë për energji; qelizat Leydig me fruktozën që e prodhojnë i furnizojnë me energji. (Më vonë do të flasim për këtë temë në detaje.)

Siç po e shikojmë, sikurse në pjesët e tjera të trupit, edhe sistemi hormonal po ashtu kryen një organizim perfekt në sistemin e riprodhimit. Çdo hormon menjëherë e kupton mesazhin që sillet dhe përgjigjet siç kërkohet. P.sh. gjëndrra e hipofizës, kur e kupton se ka ardhur koha, futet në veprim dhe dërgon urdhëra në qeliza të ndryshme në testise duke i informuar ato për punën që duhet të bëjnë në organe dhe në inde. Ajo që e stimulon aktivitetin e gjëndrrës së hipofizës është një pjesë tjetër e trurit që quhet hipotalamus. Faza e parë e krijimit të njeriut ka lidhje me të kuptuarit korret të porosive që barten nga hormonet dhe me ekzekutimin e drejtë të urdhërave.

Në çfarë mënyre qelizat dhe molekulat shquajnë dhe reagojnë në mesazhet e sjellura nga hormonet? Si e dijnë përbërjen kimike të secilës dhe çfarë metoda duhet të zbatohen që të ndikojnë në ato?

Fakti që, në mënyrë që prodhimi i spermës të ndihmohet, qelizat Sertoli dhe Leydig nisen në veprim me urdhër nga gjëndrra e hipofizës (gjëndërr mjaft larg tyre, të cilën kurrë nuk e kanë parë dhe e cila ka plotësisht ndërtim tjetër nga ato) duke u kombinuar me faktin që këto qeliza nuk do të kryenin asnjë funksion pa këtë urdhër, e bën të pamundur sqarimin e aktivitetit të tyre me termin e rastësisë. Është e pamundur që hormonet të kenë fituar karakteristikat e tyre të veçanta si rezultat i ndodhive serike të rastësishme, sepse një ndarje apo një ndërprerje gjatë një faze të sistemit do të ndikonte në tërë zinxhirin e procesit. Nëse një element në sistem është defekt, funksionimi i tërë sistemit do të dëmtohej. P.sh. sikur qelizat Sertoli të mos kuptonin domethënjen e FSH hormonit të dërguar nga gjëndrra e hipofizës dhe të mos fillonin të sekretojnë (tajisin) estrogjenin, sperma nuk do të prodhohej. Ose, sikur qelizat Leydig të mos e kryenin funksionin e tyre, furnizimin me fruktozë, apo sikur t'a prodhonin atë në sasi të pamjaftueshme, një spermë, edhe nëse e pjekur në secilin aspekt, do të vdiste pasiqë të hynte në mitrën e nënës sepse nuk do të gjente ushqim, dhe për këtë shkak nuk do t'a arrinte vezën, fekondimi nuk do të ndodhte.



Fazat e zhvillimit të spermatozoideve në tubthet seminifer janë të ilustruara lart. Tubthet seminifer kanë të bëjnë me zhvillimin e qelizave spermatozoide-formuese (spermatogonia) në faza të ndryshme. Përmes procesit të ndarjes, këto qeliza formojnë qelizat e quajtura 'spermatid'. Në fazën përfundimtare të këtyre proceseve, koka dhe bishti i spermatozoidit janë të formuara. Pas të gjitha këtyre proceseve komplekse kompletohet zhvillimi i qelizave riprodhuese të mashkullit, ku deponohen informatat që kanë të bëjnë me njeriun.

Kjo situatë paraqet një realitet të qartë. Ai I Cili krijoi lidhjet në mes të organeve dhe qelizave është Zoti. Ai ka inspiruar gjëndrrën e hipofizës, hipotalamusin, qelizat Leydig dhe Sertoli, thënë shkurt, çdo element të përfshirë në këtë proces, që të veprojë në atë mënyrë që të sigurohet prodhimi i spermës në trupin e mashkullit. Ai iu jep atyre aftësinë e të kuptuarit të gjuhës së njëri tjetrit. Çdo gjë ndodh sipas urdhërave të Zotit. Siç lexojmë në Kur'an:

Ai i sundon të gjitha, prej qiellit në tokë... (Kur'an, 32:5)


Strukturat e Tjera që Ndhmojnë

Spermën në Arritjen e Cakut të Saj

Një element tjetër i sistemit riprodhues i quajtur 'epididymis' i u ndihmon spermatoideve të zhvilluara në marrjen e aftësisë së lëvizjes dhe fekondimit të vezës. Epididymis është i ngjitur lirshëm në pjesën e jashtme të testiseve, është tub spiral rreth 6 metra. Para se të fillojë udhëtimin, sperma ruhet për ca kohë në epididymis. Sperma pastaj lëvizë në drejtim të tubit lidhës 'vas deferens', një tub i gjatë që ngrihet (ngjitet) prej epididymis në zgavrën e komblikut (legënit). Sperma mund të ruhet në këtë tub për një kohë të gjatë pa e humbur aftësinë e fekondimit të vezës, dhe kur vjen koha, sperma del nga vas deferens dhe fillon udhëtimin e gjatë për te qeliza vezë në trupin e femrës.⁷

Që spermatozoidet të jenë në gjendje të fillojnë funksionin e fekondimit, ata kanë nevojë për ndihmësa të tjerë që të furnizohen me atë që kanë nevojë në këtë udhëtim të vështirë dhe të kanë mbështetjen që iu nevojitet për të mbijetuar. Një nga këta ndihmësa është gjëndrra e prostatës. Përveq saj, janë edhe dy gjëndrra sekretuese (tajuese) që quhen 'fshikëzat seminale' të vendosura në të dy anët e prostatës. Këto gjëndrra fillojnë punën e tyre të prodhimit të lëngjeve speciale që të shoqërojnë spermatozoidet në udhëtimin e tyre

Në prodhimin e spermës, në testise futen në veprim disa sisteme të ndërlidhura. Anash mund të shifni një pjesë të ndërtimit të brendshëm të ndërlidhur të testisit. Në ndërtimin kompleks të trupin të njeriut është një lidhje pa mangësi në mes të organeve dhe qelizave. Funksionet e trupit mund kryhen duke ju falemnderuar këtyre raporteve. Vetëm një pjesë e vetme e këtij sistemi të prodhimit të spermës mjafton për ne që të kuptojmë perfeksionin e ndërtimit të trupit tonë.




kur prodhimi i spermatozoideve të jetë kompletuar. Ky lëng përbëhet nga acidi citrik, kalciumi, acidi fosfatik, enzimi trombotik dhe profibrinolizina. Në organet riprodhuese të femrës gjendet një përzjerje e trashë e acideve të cilat parandalojnë shumimin e bakterieve. Përveq zvogëlimit të aftësisë së lëvizjes së spermatozoideve, kjo përzjerje acidike mund t'i mbytet ata, por lëngu nga prostata neutralizon efektet e acidit, në këtë mënyrë ju mundëson spermatozoidve që të notojnë lehtë në drejtim të vezës.

Këtu është mirë të ndalemi dhe mendojmë për një moment. Gjëndrra e prostatës në sistemin riprodhues të mashkullit vepron me njohuri për ambientin e trupit të femrës. E di që spermatozoidet do të ballafaqohen me ambientin acidik gjatë udhëtimit të tyre dhe që nuk do të jenë në gjendje të mbijetojnë në atë ambient. Veç kësaj, di të vendos se si t'ia dal me këtë rrezik dhe prodhon lëngun e nevojshëm për këtë. Nuk ka dyshim që këtu kemi të bëjmë me mrekulli. Është e pamundur të thuhet që një gjëndërr sekretuese (tajitëse) në trupin e mashkullit e di një ndërtim tjetër që nuk është i lidhur me veten e tij, dhe duke vepruar sipas kësaj njohurie sjell vendime dhe i kryen ato. Vetëm mendo: as qenia njerëzore me inteligjencë dhe aftësinë e dëgjimit, të pamurit, të kalkulimit në kryerjen e veprimit dhe arritjes së zgjidhjes nuk mund të parasheh llojet e rreziqeve në një ambient plotësisht të panjohur dhe të ndërmer masat e duhura. Por, gjëndrra e prostatës, një masë mishi e përbërë nga qelizat, e parasheh këtë. Në asnjë mënyrë nuk mund të thuhet që është gjëndrra e prostatës që bie këso vendime vitale dhe i zbaton ato. Është Zoti I Cili ka inspiruar këtë gjëndërr të kryej këtë funksion; është Ai I Cili ka krijuar çdo milimetër të trupit të sistemit riprodhues të mashkullit dhe të femrës.

Gjithashtu, gjëndrra e prostatës nuk është e vetmja gjëndërr që prodhon atë që kërkohet në sistemin riprodhues të mashkullit për udhëtimin e spermatozoideve. Lëngu që sekretohet (tajitet) nga fshikëzat seminale pranë prostatës është i domosdoshëm për këtë udhëtim. Pak pasiqë spermatozoidet të kenë filluar udhëtimin, ky lëng i bashkangjitet që t'u ndihmojë atyre të arrijnë fundin e udhëtimit të vështirë. Ky lëng përmban fruktozë të bollshme dhe substanca tjera ushqyese po ashtu edhe sasi të mëdha të "prostaglandinës" dhe "fibrinogjenit". Fruktoza dhe ushqimet e tjera i mbështesin spermatozoidet

MREKULLIA E KRIJIMIT TË NJERIUT



Lëngu i sekretuar (tajitur) nga gjëndrra e prostatës (lart) është jashtëzakonisht i rëndësishëm për prodhimin e spermës. Ky lëng bën neutralizimin e përzjerjes acidike në organet riprodhuese të femrës, i cili do të ishte fatal për spermën. Fakti që ky lëng i cili prodhohet në trupin e mashkullit ka cilësi që të neutralizojë efektet negative të një lëngu që prodhohet në një trup tjetër është dëshmi e krijimit të pakrahasueshëm të Zotit.

prej kohës që futen në trupin e femrës e deri në kohën e fekondimit të vezës. Veç kësaj, "prostaglandina" në këtë lëng në mënyra të ndryshme i ndihmon spermatozoidet në arritjen e vezës. Një nga funksionet e prostaglandinës është të reagojë në mukozën e kanalit të mitrës dhe të ofrojë një ambient të përshtatshëm për lëvizjen e spermatozoideve. Një funksion sekondar është të shkaktojë kontraksione të kundërta në mitër dhe në tubat fallopian që t'u lejojë spermatozoideve të lëvizin më lehtë.

Në këtë pikë është e qartë se ndeshemi prapë me një mrekulli të madhe. Lëngu i sekretuar (tajitur) nga fshikëzat seminale e di perfekt se si të ngatërroj strukturën e trupit të femrës të cilin nuk e ka parë kurrë. E di qysh më parë që kontraksionet e kundërta në mitër dhe tubat fallopian do të ndihmojnë lëvizjen e spermatozoideve dhe duke vepruar me një shkallë të lartë të

parashikimit, i shton një material kimit (prostaglandinën) përbërjes së vet e cila do të sjell këto kontraksione. Sikur të pyesësh cilindo kimist të kryej një reaksion të tillë; çfarë do të bënte?

Së pari do t'a kontrollonte spermatozoidin, ndërtimin e tij dhe kërkesat që fekondimi të ndodh. Pastaj ai do të mendohej të mësoj për trupin e femrës, hormonet e saj, vezën, tubat fallopian të cilët bartin vezën në mitër, mitrën, indet e mitrës, sistemin nervor që shkakton kontraksionet dhe shumë detaje të tjera. Pastaj, duke kombinuar vitet e tij të studimit dhe përvojën e tij do të zbulojë substancat të cilat kanë ndikim në këto gjëra; ai do t'i merr ato dhe me eksperimente dhe hulumtime do të gjej se në çfarë proporcione duhet të kombinohen këto substanca. Një qenie njerëzore e pajisur me vetëdije ndoshta do të jetë në gjendje të bëjë tërë këtë me shumë përkushtim dhe përpjekje.

Megjithatë, ajo që kompletion këto gjëra nuk është kimist i cili është bërë ekspert në këtë fushë pas shumë viteve studimi. Janë qelizat, indet dhe organet e prodhuara nga atomet dhe molekulat pavetëdije. Po ashtu nuk mund të themi që ky grumbull i qelizave ka inteligjencë më të lartë dhe njohuri më të madhe se sa një kimist, apo se ato kryejnë këto funksione duke iu bindur vullnetit të tyre.

Nuk ka dyshim që ky lëng i prodhuar në sistemin riprodhues të mashkullit dhe i projektuar në atë mënyrë që të ndikojë në sistemin riprodhues të femrës, së bashku me qelizat, indet dhe organet që e prodhojnë atë janë një dëshmi e qartë e krijimit të Zotit.

Është tejet e qartë që i tërë ky proces harmonik nuk është punë e rastësisë. Një person me inteligjencë dhe vetëdije menjëherë do të mbërthej këto ngjarje mahnitëse që ndodhin pa të meta në çdo qenie njerëzore që ka jetuar ndonjëherë se janë punë e një inteligjence supreme dhe e një fuqie të përjetshme, dhe do t'i shërbej Zotit, që vetëm Atij i përket kjo inteligjencë dhe fuqi e përjetshme.


O njerëz! Keni frikë nga Zoti i juaj! Cili iu krijoi prej një vete dhe nga ajo krijoi palën dhe pastaj prej tyre u shtuan shumë meshkuj e femra. Keni Zotin në mendje nga i Cili ju kërkoni e gjithashtu edhe farefisin. All-llahu iu shikon juve vazhdimisht. (Kur'an, 4: 1)

Lëngu me Ndërtim Kompleks: Semeni

Kur spermatozoidet fillojnë udhëtimin e tyre, gjëndrra e prostatës sekretion (tajit) një lëng dhe menjëherë pas kësaj një lëng tjetër vjen nga fshikzat seminale; i bashkohet spermatozoideve dhe semeni është prodhuar. Të gjitha së bashku udhëtojnë drejt trupit të nënës. Siç kemi shpjeguar me herët në detaje, funksioni i këtij lëngu është që të ketë ushqimin gati që të furnizojë spermatozoidet me energjin që ju nevojitet, dhe posaqërisht të neutralizojë acidet në hyrje të mitrës së nënës, duke e bërë ambientin në të cilin do të lëvizin spermatozoidet më të lehtë për lëvizje.

Tërësia e këtij lëngu i cili derdhet nga trupi i mashkullit për procesin e fekondimit quhet semen. 10% e tij vjen nga kanalet e spermës, 60% nga fshikzat seminale, 30% nga gjëndrra e prostatës dhe pjesa tjetër janë spermatozoidet dhe nje sasi e vogël e lëngut që vie nga gjëndrrat tjera sekretuese (tajitëse).⁸ Kjo nënkupton, atë të cilin ne e quajmë semen është një kombinim kompleks i fruktozës, profibrinolizinës, ergotioneinës, acidit ascorbinik, flavinës, prostaglandinës, acidit citrik, kolesterolit, zinkut, acidit fosfatik, acidit laktik, fibrinoletikës, dhe enzimeve, hialuronidiazës dhe spermatozoideve. Ne kemi para syve një mrekulli të cilën Zoti e ka shpallur në Kur'an.⁹

Në shumë vende në Kur'an Zoti thërret për vëmendje në krijimin e njeriut dhe na urdhëron që të mendojmë rreth kësaj çështje. Shkencëtarët të cilët kanë shqyrtuar këto vargje të Kur'anit kanë zbuluar që një numër i mrekullive të Kur'anit janë të fshehura në ato vargje që japin informacionin



Anash shofim spermatozoidet duke lëvizur në lëngun seminal. Lëngu seminal është një përzierje e lëngjeve të sekretuara (tajitura) nga gjëndrrat e ndryshme. Në kundërshtim me mendimin e përhapur, nga e tërë përbërja e këtij lëngu kompleks, vetëm spermatozoidet kanë aftësinë e fekondimit. Ky fakt shkencor – i zbuluar kohëve të fundit – është shpallur në Kur'an para 1400 viteve.

rreth krijimit të njeriut. P.sh. me hulumtimet e bëra me ndihmën e teknologjisë moderne shkencore është zbuluar që semeni përbëhet nga përzierja e substancave të ndryshme. Mirëpo kjo informatë është treguar në Kur'an para 1400 viteve. Semeni në Kur'an është përshkruar si një pikë 'e përzier':

Ne e krijuam atë prej një pike të përzier, dhe Ne e bëmë atë të dëgjojë dhe të shoh. (Kur'an, 76: 2)

Nga elementet që e përbëjnë këtë lëng, vetëm një spermatozoid fekondon vezën. Një numër i madh i njerëzve mendon që fekondimin e bënë i tërë semeni, mirëpo, vetëm një pjesë e vogël e semenit, spermatozoidi, e bën këtë. Kjo d.m.th. që qenia njerëzore vie në ekzistencë jo nga semeni si tërësi por vetem nga një pjesë e vogël e tij (spermatozoidi).

Gjatë bashkimit seksual, nga trupi i mashkullit derdhet semeni me 250 – 300 milion spermatozoide. Por nga miliona spermatozoide, vetëm rreth 1000 arrijnë deri te veza dhe nga këto 1000, veza e pranon vetëm një. Kjo d.m.th. që thelbi i qenies njerëzore nuk është në semenin si tërësi, por vetëm në një pjesë të vogël të saj. Ky fakt, për të cilin shumë njerëz bile edhe sot nuk kanë njohuri apo janë të keqinformuar, është shpallur në Kur'an 1400 vite më herët. Kur'ani e shpjegon këtë realitet me këto fjalë:

A mendon njeriu se do të lihet të vazhdoj i pa vëzhguar? A nuk ishte një pikë sperme e derdhur? (Kur'an 75:36-37)

Në një varg tjetër, është treguar përsëri se semeni është përzierje dhe njerëzimi është krijuar nga 'ekstrakti' (fragmenti - pjesa) i kësaj përzierje.

Ai ka krijuar të gjitha gjërat në mënyrën më të mirë. Ai filloi krijimin e njeriut nga balta, pastaj bëri farën e tij nga ekstrakti i një lëngu të hedhur. (Kur'an, 32:7-8)

Nëse e shikojmë domethënjen nga arabishtja, bëhet e qartë se jemi të konfrontuar me një mrekulli të Kur'anit. Fjala shqipe 'ekstrakt' (fragment – pjesë) përkthen fjalën arabe 'sulala', dhe d.m.th. thelbi apo pjesa më e mirë e një gjëje. Apo nënkupton, që ajo është 'një pjesë e një tërësie'.

Kjo tregon qartë që Kur'ani është fjala e një Testamenti që di rreth krijimit të njeriut deri në detajin më të imët. Ky Testament i takon Zotit, Krijuesit të qenieve njerëzore.


Përgatitjet Përfundimtare në Zhvillim e Sipër...

Dukja e përgjithshme e spermatozoidëve e mbështetur nga lëngjet në semen tani është bërë e qartë. Çdo pjesë e spermatozoidit koka, qafa, pjesa mesme, bishti dhe pjesa e fundme kanë funksione të ndara.

Bërthama (pjesa e kokës) nuk është më e madhe se 5 mikron. Në këtë 5 mikron hapsirë janë vendosur informatat lidhur me trupin e njeriut dhe kërkohet që një qelizë të shndërrohet në qenie njerëzore. Në kokën e spermatozoidit është një paketim gjenetik me 23 kromozome të cilat do të barten në vezë. Kjo d.m.th. se në kokën mikroskopike të spermatozoidit janë paketuar sigurt informatat se si do të punojnë të gjitha organet e njeriut, ku do të lokalizohen, në cilën fazë qelizat do të fillojnë të zhvillohen dhe ndryshojnë, thënë shkurt, të gjitha informatat se si trupi i njeriut do të ndërtohet.

Përveç informatave gjenetike, koka e spermatozoidit ka edhe një veçori specifike. P.sh. në 'akrozom' emër që i është dhënë shtresës mbrojtëse të jashtme të kokës, janë substancat të cilat e ndihmojnë spermatozoidin në fazën përfundimtare të udhëtimit. Këto janë enzimet që mund të tretin indet. Duke përdorur këto enzime, gjatë procesit të fekundimit

Secila pjesë e spermatozoidit ka funksion të ndryshëm. Sikur spermatozoidi të mos kishte bisht, nuk do të lëvizte kurrë; sikur të mos ishte mitokondria në pjesën e mesme, spermatozoidi nuk do të prodhonte energji dhe do të mbetej i palëvizshëm; sikur të mos ishte akrozomi në kokën e spermatozoidit, do të kishte mungesë të disa enzimeve, që do të bënte të pamundur për spermatozoidin shpimin dhe fekundimin e vezës. Kjo tregon se spermatozoidi nuk ka mundur të prodhohej me kalimin e kohës, fazë pas faze, nga rastësia. Ndërtimi perfekt i spermatozoidit vjen nga Zoti.



spermatozoidi do të jetë në gjendje të shpoj vezën dhe të depërtoj në të.¹⁰ (shih 'Spermatozoidi dhe Veza Takohen')


Pjesa tjetër më e rëndësishme e spermatozoidit është bishti, i cili bën të mundur notimin e lehtë në ambientin e lëngshëm. Bishti i spermatozoidit vendos për drejtimin në të cilin do të notojë dhe ndihmon atë që të arrijë te qeliza vezë. Ky bisht, si e bën furnizimin me energji që nevojitet për lëvizjet e spermatozoidit? Nevojat e energjisë për spermatozoidin bëhen në mënyrë të mrekullueshme. Trupi i bishtit është depo karburantesh, i cili furnizon me energji gjatë udhëtimit. Në rrugën e gjatë derisa të arrijë te veza, nevojat e spermatozoidit për energji i plotëson mitokondria që gjendet në këtë pjesë. Duke përdorur bartësit e energjisë në qafën e spermatozoidit, mitokondria furnizon me ATP energji, e cila ia mundëson spermatozoidit të lëvizë lehtë.

11

Siç po shikojmë, në të gjitha aspektet spermatozoidi paraqet ndërtim perfekt. Pa bishtin spermatozoidi nuk do të mund të lëvizte, pa mitokondri energjia nuk do të mund të prodhohej dhe nuk do të kishte lëvizje. Sikur koka e spermatozoidit të ishte e ndërtuar në mënyrë perfekte përveç se të mungonte akrozomi, enzimet e nevojshme nuk do të prodhoheshin dhe nuk do të kishte ndonjë qëllim në arritjen e vezës nga spermatozoidi; sepse nuk do të ishte në gjendje që të depërtonte në qelizën vezë për t'a fekunduar.

Prandaj, spermatozoidi nuk i siguroj të gjitha këto tipare nëpër faza gjatë rrjedhës së kohës siç pohon teoria e evolucionit. Kur qenia e parë njerëzore u paraqit në botë, spermatozoidi duhet t'i ketë pasur të gjitha këto tipare. Meqenëse, me cilëndo mangësi nga këto tipare do të ishte e pamundur për spermatozoidin të bënte fekondimin, dhe sikur, siç pohojnë evolucionistët, spermatozoidi në të kaluarën nuk i ka poseduar të gjitha këto tipare, atëherë njeriu nuk do të shumohej; do të ishte fshirë nga faqja e tokës. Kjo tregon se spermatozoidi erdhi në ekzistencë me ndërtim perfekt, kjo d.m.th. se demonstroi faktin e krijimit. Krijuesi i ndërtimit perfekt të spermatozoidit është Zoti, Krijuesi i çdo gjëje.

Koka e Spermatozoidit e Mbuluar me Parzmore (blindim) Mbrojtëse



Në ilustrimin lart shofim kokën e spermatozoidit të blinduar. Në pjesën e kokës të spermatozoidit janë të lokalizuara nukleusi (bërthama) dhe enzime të ndryshme tretëse. Në mënyrë që të ruhet ky material nga rreziqet gjatë udhëtimit, pjesa e kokës së spermatozoidit është e mbuluar me parzmorë (blindim 1-2). Pasiqë të mbulohen kokat e spermatozoideve ato vendosen në qeska mbrojtëse dhe plumbohen (3-4-5-6). Spermatozoidet vazhdojnë udhëtimin të sigurt duke e ruajtur në këto qeska nukleusin 5 mikrona në madhësi që përmban informatat që kanë të bëjnë me trupin e njeriut. Po ashtu në qeska janë edhe enzimet tretëse të cilat do të shpajnë vezën në fillim të procesit të fekundimit. Kjo është vetëm një nga fazat e prodhimit të spermatozoideve. Pas kësaj, motori dhe bishti i spermatozoidit 'montohen' dhe rezultati është një punë e mrekullueshme inxhinierike. Në këtë pikë prapë duhet të vrasim mendjen: Si mësojnë qelizat pavetëdije të konstruktojnë diçka dhe të prodhojnë atë? Si e dijnë ato se në cilën mënyrë t'i bëjnë gati spermatozoidet për trupin e nënës, kur dijmë faktin se ato nuk kanë njohuri për atë trup? Në këto pyetje është vetëm një përgjigje: Zoti, I Cili krijoi të gjitha gjërat, i krijoi spermatozoidet.

Sistemet e Krijuaara për Njëri – Tjetrin

Kur spermatozoidet largohen nga trupi i mashkullit me anën e semenit, nuk janë plotësisht të gatshëm për të fekonduar vezën. Derisa t'a lënë trupin e mashkullit, lëvizja e tyre kontrollohet nga sekrecionet në fushën ku ato janë të ruajtura. Për këtë arsye, kur semeni formohet dhe arrin trupin e femrës, spermatozoidet nuk mund të kryejn funksionin e fekondimit. Si, atëherë ndodh që spermatozoidet, kur të ndahen nga sistemi riprodhues i mashkullit, marrin aftësin e fekondimit të vezës?

Në mënyrë që procesi i fekondimit të lehtësohet, një numër i sistemeve në trupin e femrës duhet të jenë gati. Disa lëngje që sekretohen në sistemin riprodhues të trupit të femrës ndihmojnë spermatozoidet duke rritur aftësin e tyre që të fekondojnë vezën. Ja disa nga ndryshimet që ndodhin në spermatozoide të cilët arrijnë trupin e femrës:

1. Lëngjet që sekretohen (tajiten) në mitrën e femrës dhe tubthat fallopian përmbajnë një materie kimike që shkatërron faktorët që frenojnë lëvizjet e spermatozoideve në aparatën riprodhues të mashkullit. Në këtë mënyrë, rritet lëvizja e spermatozoideve që arrijnë aparatën riprodhues të femrës.

2. Lëngjet në aparatën riprodhues të mashkullit (tubthat seminifer, në epididymis, dhe vas deferens) të gjithë përmbajnë nivel të lartë të kolesterolit. Kolesterolit vazhdimisht i jepet membranës qelizore që mbështjellë akrozomin, duke e forcuar këtë membranë dhe duke penguar lirimimin e enzimeve. Nga pikëvështrimi i mundësis që spermatozoidi të fekondoje vezën, kjo veçori është e dëmshme. Për këtë arsye, spermatozoidet që kalojnë në trupin e femrës duhet të shpëtohen nga ky efekt. Sikurse edhe për miliona detaje në fazat e riprodhimit të njeriut, edhe për këtë qëllim është përgatitur një sistem i veçantë. Spermatozoidet që hyjnë në trupin e femrës i bashkohen lëngut të mitrës. Ky lëng e ul nivelin e kolesterolit në semen, i cili i përmban spermatozoidet, në këtë mënyrë e bën kokën e spermatozoideve (akrozomin) më të brishtë. Kështu që, kur spermatozoidi arrinë qelizën vezë, enzimet brenda akrozomit dalin jashtë lehtë dhe sigurojnë fekondimin e vezës me depërtimin e tyre në membranën e vezës.

3. Depërtueshmëria e membranës në kokën e spermatozoidit i cili futet në trupin e femrës rritet në marrdhënje me jonet e kalciumit. Me hyrjen e një sasive të madhe të kalciumit në spermatozoide, lëvizja e spermatozoideve rritet. Bishti (flagellum) që shkakton lëvizjen e spermatozoidit ndryshon lëvizjet e dobëta të valëzuara në lëvizje të forta dhe në këtë mënyrë lehtëson arritjen e vezës.¹²

Pa dyshim, për ata të cilët mendojnë me kujdes, ka shumë tregues të rëndësishëm që gjenden në krijimin e spermatozoidit se ai është tepër harmonik dhe plotësues me trupin e femrës.

Fakti që spermatozoidi dhe trupi i femrës në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, bashkëpunojë për të sjellur të njejtën mrekulli, është tregues i një intelegjence të vetëdijshme të madhe. Spermatozoidet, para se të futen në trupin e femrës dhe derisa janë në trupin e mashkullit, marrin masa që të prodhohet çka është e nevojshme që të korrigjohen mangësitë që mund të krijojnë probleme për ata në trupin e femrës. Një ambient i veçantë është i përgatitur në trupin e femrës që të rritë lëvizjet e spermatozoidit i cili është tejet i vogël për t'u parë me sy. Duket sikur trupi i femrës të ketë ditur që udhëtimi i spermatozoideve është shumë i gjatë dhe ju nevojitet energji që atë t'a përfundojnë shpejt; duket sikur të ketë ditur çfarë komponimi kimik nevojitet për të përshkuar vezën, ka supozuar se spermatozoidet kanë mangësi në këtë pikë dhe ka vendosur që kolesterolin është shkaku, dhe pastaj ka prodhuar diçka për neutralizimin e kolesterolit, në këtë mënyrë ka përgatitur ambientin në të cilin veza do të përshkohet në mënyrën më të lehtë. Dhe të gjitha këto i ka bërë vet.

Duhet të përkujtojmë se ajo që është përmbledhur më lart është vetëm një pjesë e vogël e hapave të hyrjes së spermës në trup për të fekunduar vezën. Këta hapa kompletohen si rezultat i mijërave reaksioneve komplekse kimike ku po ashtu janë të përfshira disa proteina, enzime dhe lëngje. Por, është veçanërisht e rëndësishme të përmendet se nuk është qëllimi ynë të numërohen këto detaje thjeshtë për të cekur njohuri shkencore, qëllimi ynë është që të theksojmë të vërtetën se, në kundërshtim me atë që pohojnë evolucionistët, formacioni i trupit të njeriut është tejet kompleks që të jetë produkt i rastësisë së verbër: ai është rezultat i sistemeve pa të meta plotësuese, të ndërvarura dhe të ndërlikuara. Nuk është e mundur që një qenie njerëzore, apo edhe

një enzim i vetëm apo molekul që aktivizon spermatozoidet, të vijë në ekzistencë nga rastësia.


Deri këtu kemi folur se si një qelizë e spermës e prodhuar në trupin e mashkullit siguron aftësin e fekondimit të vezës me ndihmën e substancave kimike të trupit të femrës. Të pauzojmë dhe mendojmë: a mundet një sistem kaq kompleks të vijë në ekzistencë nëpër faza siç pohon teoria e evolucionit? Sigurisht që një gjë e tillë është e pamundur, por gjithsesi do të shqyrtojmë një skenar të tillë.

Sperma e prodhuar rastësisht në trupin e mashkullit së pari vjen në kontakt me trupin e femrës. A mundet, që si rezultat i rastësisë, t'i gjej të gjitha lëngjet të gatshme dhe duke pritur për spermën që t'ia ofrojnë aftësinë e fekondimit? Nëse jo, atëherë pas dështimit të parë të spermës për të arritur sistemin riprodhues të femrës për fekondim qelizat riprodhuese të femrës a do të sjellin vendim dhe të fillojnë të prodhojnë substancat kimike të nevojshme?

Është e qartë se këta dy shembuj nuk akordohen mirë me logjik apo inteligjencë; ato janë skenare që nuk mund të ndodhin. Me shembujt që i kemi marrë për këtë çështje, konfrontohemi me një të vërtetë: të gjitha këto sisteme janë dëshmi e diturisë dhe fuqisë së pafund të Zotit I Cili krijoi gjithçka. Zoti ka krijuar në thellësit e trupit të njeriut mrekulli të cilat janë shumë të vogla për syrin për t'i parë dhe përtej kapacitetit të mendjes njerëzore për t'u kuptuar. Me këtë, Ai na tregon se ka dëshmi për besim të cilat ndodhin në trup, të cilat janë plotësisht të pavarura nga vullneti dhe dituria e njeriut. Dhe Ai na përkujton neve se dominimi I Tij është mbi të gjitha, duke përfshirë edhe vet qeniet njerëzore.

Me të vërtetë, Zoti i juaj është falës i madh. Ai iu njohu juve mirë kur Ai iu krijoi prej toke, dhe kur ishit embrione në mitrat e nënave tuaja. Kështu që mos deklaroni dëlirësi për vetveten. Ai e di më së miri se kush e ruan veten nga e ligësia. (Kur'an, 53: 32)

*Ne do të ua tregojmë atyre Shenjat e Tona
në horizont dhe në vetveten e tyre derisa
t'ju bëhet e qartë se është e vërteta. A nuk
mjafton që Zoti i juaj është dëshmitar për
çdo gjë? (Kur'an, 41: 53)*



ROLI I QELIZËS VEZË NË FORMIMIN E NJË NJERIU TË RI

Me fillimin e pubertetit, ka ngjajshmëri në zhvillimet e trupave të femrës dhe të mashkullit. Qeliza riprodhuese e femrës, veza, së bashku me sistemin riprodhues të femrës përgatitet për të kompletuar sistemin riprodhues të mashkullit.

Me ardhjen e pubertetit te femrat, sikurse tek meshkujt, hipotalamusit saktësisht e di se kur vjen koha që të dërgoj urdhëra te gjëndrra e hipofizës për të prodhuar hormonet e nevojshme për të nxitur qelizat vezë në pjekuri. Gjëndrra e hipofizës pranon urdhërat, menjëherë ju bindet atyre dhe fillon të prodhojë hormonet e nevojshme.

Prodhimi i qelizave riprodhuese te femrat nuk është i vazhdueshëm sikurse te meshkujt. Ky prodhim ndodh në kohëra të veçanta. Është detyrë e gjëndrrës së hipofizës të përcaktoj kohën. Gjëndrra e hipofizës siguron prodhimin e hormonit që do të sjell në pjekuri qelizat vezë në vezore. Ky hormon e di shumë mirë se ku duhet ta kryej funksionin e tij, shkon drejt e në vezore dhe njofton se koha për pjekurinë e vezës ka ardhur. Kështu, qelizat vezë e kuptojnë urdhërin menjëherë dhe fillojnë një aktivitet intenziv brenda vezores i cili shpie në pjekurin e vezës.¹³

Tani le të shikojmë këtë informatë më thellë. Si, kjo gjëndërr sekretuese (tajitëse) e quajtur hipotalamus e përcakton kohën? Dhe si e kalkulon pa u hutuar kohën e saktë të këtij procesi, i cili ka ndodhur në miliona femra në


të kaluarën dhe të tashmen? Hipotalamusi është i lokalizuar në pjesën e poshtme të trurit; nuk është mekanizëm kohor, nuk ka lidhshmëri me botën jashtë trurit; është një masë mishi e përbërë nga qelizat. Funkzioni i kësaj mase mishi në përcaktimin e kohës është diçka e jashtëzakonshme që nuk mund të injorohet. Por ky është vetëm një detaj i vogël i ndodhive të mrekullueshme që ndodhin vazhdimisht në trupin e njeriut. Ky lloj procesi mahnitës vazhdon pafund, në çdo milimetër të trupit të njeriut. P.sh. një mrekulli mahnitëse ndodh në gjëndrrën e hipofizës: një urdhër i dërguar nga hipotalamusi lexohet dhe kuptohet; bazuar në këtë të kuptuar një vendim mirret; sipas këtij vendimi, substancat prodhohen dhe dërgohen me materialin tjetër prodhues pa asnjë gabim në një vend të largët dhe të paparë. Po ashtu, gjëndrra e hipofizës është një grumbull qelizash. Bashkimi i këtyre qelizave dhe kuptimi i vetëdijshëm i urdhërave që dërgohen tek ato dhe zbatimi i komandës që e kanë kuptuar është një gjë e jashtëzakonshme. Çfarë vetëdije ua bën të mundur këtij grumbulli të qelizave të 'kuptojnë', 'konceptojnë', 'nxjerrin përfundime', 'sjellin vendime' dhe 'zbatojnë vendime'?

Trupi i njeriut është ambient i errët në të cilin nuk depërton drita dhe ka shumë lëngje që lëvizin më një shpejtësi të madhe; është vend i dendur dhe i komplikuar. Evolucionistët kurrë nuk kanë qenë në gjendje të shpjegojnë se si një masë molekulash në këso ambienti të dendur mund të shkojnë, pa u dëmtuar ose humbur, ku të dëshirojnë në masën komplekse duke kaluar nëpër materiale të tjera që janë shumë herë më të mëdha se sa madhësia e tyre, ose se si ato edhe mund të përdorin disa mjete për të dërguar substancat tjera në vendet ku janë të nevojshme. Kjo pamundësi për shpjegim ndodh sepse strehimi i vetëm i evolucionistëve, kur ballafaqohen me këto dëshmi të mrekullueshme të krijimit, është rastësia; por nuk ka hapësirë për rastësi në ndërtimin kompleks të trupit të njeriut apo të ndonjë gjallesë tjetër.

Duhet të përkujtojmë se intelijenca dhe vetëdija e përmendur në rrjedhën e të gjitha këtyre ndodhive nuk i përket asnjë qelize. Atë të cilën e quajmë qelizë nuk ka sy që të shikoj, gjuhë që të flas apo të kuptohet dhe nuk ka veshë që të dëgjoj. Qelizat janë krijime nga Zoti; ato janë vetëm mjete të cilat zbatojnë urdhërat e Tij; në çdo moment, me inspirim nga Ai, ato kryejnë procese tepër mahnitëse.

QELIZA VEZË FILLON TË ZHVILLOHET...

Veza prodhohet në një organ i cili në çdo aspekt është projektuar posaqërisht për këtë qëllim; vezorja. Në çdo femër, janë dy vezore, njëra në të djathtë e tjetra në të majtë. Në këto vezore, është një hapësirë e mjaftueshme për hyrje daljet e fijeve nervore, enëve të gjakut dhe kanaleve limfatike. Brenda kësaj hapësire, janë indet fijëzore të pasura me gjak. Që qelizat vezë të formohen të sigurta, ato duhet të ruhen dhe ushqehen nga këto inde. Përbrenda kësaj sturkture mbrojtëse, janë shumë qeska (folikule) të madhësive të ndryshme. Në secilin folikul është një qelizë vezë primare. Por normalisht, një vezë e pjekur e vetme lirohet nga vezoret në secilin muaj në mënyrë që gjatë një kohe vetëm një fetus (fryt) të rritet.




Lart shofim ndërtimin e brendshëm të mitrës. Një sistem i veçantë është krijuar në trupin e femrës i cili llogarit çdo eventualitet që mund të ndodh në prodhimin e vezës dhe në kompletimin e udhëtimit të saj. P.sh. miliona qeliza në tubën fallopiane janë përgjegjëse që t'ia mundësojnë vezës arritjen në mitër. Anash shofim një foto të tubës fallopiane ku zbarkon veza e pjekur.

MREKULLIA E KRIJIMIT TË NJERIUT

Por ky prodhim nuk përbëhet vetëm nga një fazë. Në mënyrë që kjo qelizë vezë të piqet, disa zhvillime duhet të ndodhin njëra pas tjetrës. Që, qeliza vezë primare të piqet dhe të bëhen qelizat riprodhuese, duhet të bëhet një ndarje me mitoz dhe dy ndarje me meioz, në renditje të saktë pa hutime. Si rezultat i ndarjeve, ndodh ndryshimi në numrin e kromozomeve në qelizë dhe lloje të ndryshme të qelizave formohen. Sikurse në rastin e qelizave riprodhuese të mashkullit, po ashtu edhe te femra, 46 kromozomet në qelizat primare të vezës reduktohen në 23.

Si rezultat i ndarjes së qelizës vezë me anë të mitozës dhe meiozës, prodhohen tri qeliza të vogla dhe një qelizë e madhe (ootid). Qelizat e vogla vdesin për shkak të mungesës së ushqimit, ndërsa qeliza e madhe pëson disa ndryshime dhe bëhet vezë. Sikur secila nga këto qeliza të kishte madhësinë e nejtë, nuk do të kishte ushqim të mjaftueshëm për zhvillimin e zigotit në fund të procesit fekondues. Por fakti që njëra nga qelizat ka më shumë ushqim, dhe të tjerat janë të vogla parandalon paraqitjen e problemit të tillë.

Zhvillimi i vezës nuk është fenomen i pakontrolluar që ndodh rastësisht nga vetvetja. Siç shpjeguem në fillim, ajo që i jep formë këtij zhvillimi, sikur në rastin e sistemit riprodhues të mashkullit, janë hormonet e sekretuara



Anash shofim paraqitjen e një qelize vezë e imët me madhësi sa kokrra e kripës, e cila është një nga elementet më të rëndësishme në formimin e njeriut. Sistemi që nevojitet për prodhimin e një qelize të vetme të këtyllë, gjendet në trupin e çdo femre të gjallë sot në botë, sikurse që ka qenë prezente në të gjitha femrat të cilat jetuan ndonjëherë. Ky është krijimi i pa të meta i Zotit



Një qelizë vezë në madhësi prej 150 mikrona, pangjyrë dhe gjysmë-transparente (Iart). Është në formë të një sfere dhe pjesa e jashtme e saj është e rrethuar me një membranë të butë, por megjithatë e fortë. Brenda ndërtimit të vezës ka lëndë ushqyese si yndyrë, sheqer dhe proteina. Kjo rezervë e lëndës ushqyese siguron që qeliza vezë të ushqehet gjatë udhëtimit, dhe nëse fekondimi ndodh, kujdeset për nevojat e saj derisa ajo të arrijë në mitër.¹⁴

(tajtura) nga gjëndrra e hipofizës, e cila është e lokalizuar nën tru. Fazat e formimit të vezës dhe hormoneve të përfshira në këtë proces mund t'i radhisim kështu:

1. Rritja e Folikulit: kjo është faza në të cilën qeliza e vezës fillon të formësohet. Qeliza primare e vezës gjendet, siç thamë edhe më herët, në atë që quhet folikul. Formimi i folikulit merr rreth 14 ditë. Hormoni i hipofizës, FSH (hormoni stimulues i folikulit), vjen në vezore me qarkullim të gjakut. Ky


hormon është përgjegjës për formimin dhe zhvillimin e folikulit në vezore dhe për prodhimin e vezës nga qeliza primare që gjendet në folikul. Në të njejtën kohë, ky hormon është shkaktar për sekretimin (tajitjen) e estrogenit nga folikuli i pjekur.

Estrogjeni është një hormon i cili ndikon posaqërisht në mitër. Përshpejton ndarjen e qelizës me mitozë në mitër, kjo fushë pastaj ajët (fryhet) duke formuar një mbrojtëse të butë në të cilën embrioni do të ngjitet pas procesit të fekondimit. Përveç kësaj kujdeset që sasi e mjaftueshme e gjakut dhe lëngjeve indore të drejtohen në mitër. Këto përgatitje bëhen çdo muaj. Nëse veza fekondohet, ajo strehohet në këtë pëlhurë të përgatitur posaqërisht në të cilën ushqehet dhe vazhdon zhvillimin.

Sikurse në çdo fazë të krijimit të njeriut, edhe këtu ndodh një mrekulli po ashtu. Qelizat në sistemin riprodhues të femrës përcaktojnë qysh me herët nevojat e embrionit të cilin do t'a presin, bëjnë përgatitjet që të përmbushen nevojat dhe punojnë që të furnizojnë ambientin tepër të përshtatshëm për zhvillimin e fetusit. Si mundet një grumbull qelizash të veprojnë operacione që kërkojnë një shkallë të tillë të vetëdijes dhe intelegjencës? Natyrisht që është e pamundur të thuhet se qelizat posedojnë vetëdije dhe intelegjencë të tillë, por qelizat në sistemin riprodhues të femrës (edhe qelizat në gjëndrrën e hipofizës) i bëjnë këto gjëra që i deklaram të pamundura për ato, dhe përgatisin qysh më herët një ambient më se të përshtatshëm për nevojat e embrionit të cilin nuk e kanë parë kurrë.

Nuk është e mundur për askend me mendje intelegjente të pohoj se qelizat i bëjnë këto gjëra nga vullneti dhe intelegjenca e vet. Në të vërtetë, vetëm ndokush mendimi i të cilit është seriozisht me të meta mund të pohoj se qelizat e komponuara nga atomet pa vetëdije mund të bëjnë atë që ai vet me intelegjencën e tij të vetëdijshme nuk mundet t'i bëjë. Duke qenë rasti kështu, realiteti para nesh është i qartë kristal: të gjitha qelizat të cilat kontribuojnë në krijimin e njeriut kryejnë funksionet e tyre të inspiruara nga Krijuesi, ato janë mjete në realizimin e një mrekullie që ndodh kur çdo qenie njerëzore vjen në botë.

2. Ovulacioni: Në këtë fazë folikuli që e bart vezën çahet dhe veza lirohet. Mirëpo qeliza vezë e cila është liruar nga vezorja në hapësirë ka




Një përmbledhje e bashkëveprimeve të cikleve të mitrës dhe vezorëve. Maturimi i një veze nuk është diçka që ndodh nga vetvetja. Faza e zhvillimit të vezës drejtohet nga hormoni që sekretohet (tajitet) nga gjëndrra e hipofizës që gjendet nën tru. Një qelizë vezë që bart të gjitha informatat në lidhje me organizmin e gjallë dhe e përgatitur për procesin e fekondimit formohet nga veprimet komplekse dhe ndërlihdhëse.

nevojë për ndihmë. Përndryshe, qeliza vezë nuk do të ishte në gjendje kurrë t'a gjej vendin për t'u takuar me spermatozoidin. Kështu, në këtë fazë, tubi fallopian, që gjendet në mes të vezorës dhe mitrës, hyn në veprim. Qeliza vezë, që është liruar nga vezorja në hapësirë, kapet nga tubi fallopian, i cili ka fije të gjata sikur një oktapod. Tubi fallopian ofron një ambient të përshtatshëm për fekondim dhe fazat e mëvonshme varen nga ajo se a është apo nuk është sperma prezente në këtë tub.

Kontrollues në tërë këtë proces është hormoni luteinizant (LH) që sekretohet (tajitet) nga gjëndrra e hipofizës. Është e vlefshme të përmendet një gjë tjetër interesante për këtë hormon. Hormoni LH është absolutisht

MREKULLIA E KRIJIMIT TË NJERIUT



Qelizat vezë zhvillohen në vezore, në strukturat e quajtura folikule. Në këtë ilustrim shohim fazat e zhvillimit të një qelize vezë dhe lirim të saj nga folikuli. Të gjitha femrat rregullisht përsërisin këtë fazë në një kohë të veçantë. Në secilin muaj gjatë një periudhe të veçantë, qelizat vezë të reja formohen dhe të njëjtat hormone sekretohen (tajiten) vazhdimisht ndërsa trupi i femrës përgatit veten sikur fekondimi të ndodhte. Por në periudhën finale të përgatitjes, përgatitjet ndryshojnë në bazë të asaj se a janë apo nuk janë spermatozoidet prezente. Kjo është një mrekulli e qartë e krijimit.


i nevojshëm për çarjen e folikut në të cilin është lokalizuar qeliza vezë e pjekur dhe për lëvizjen e saj në drejtim të vendit ku do të takohet me spermën. Mungesa e këtij hormoni rezulton në dështimin e folikut që të përparojë për në fazën e ovulacionit, edhe nëse nuk ka mangësi në sekretimin (tajitjen) e hormoneve tjera. Por ky lloj i problemit nuk ndodh dhe 2 ditë para fazës së ovulacionit, për një arsye të cilën shkencëtarët ende nuk janë në gjendje ta shpjegojnë, sekretimi (tajitja) i hormonit LH nga gjëndrra e hipofizës rritet. E njëjta ndodh edhe me hormonin FSH dhe me ndikim të këtyre dy hormoneve, ovulacioni ndodh çdo muaj. Me fjalë të tjera, edhe këtu po ashtu gjëndrra e hipofizës bën një kalkulim mahnitës të kohës dhe fillon sekretimin (tajitjen) e hormonit saktësisht në kohën dhe sasinë e duhur.

Natyrisht se ky aktivitet i dijshtëm nuk pritët nga gjëndrra e hipofizës apo qelizave që e përbëjnë këtë gjëndërr. Pasiqë aty ka intelegjencë superiore dhe urdhër që shifet, është Një të Cilit kjo intelegjencë dhe ky urdhër i takon: është intelegjenca dhe urdhëri i Zotit që paraqiten në të gjitha këto ngjarje të mrekullueshme në fazat e zhvillimit të krijimit të njeriut.

3. Korpus Luteum (trupi i verdhë) – Faza Luteale: pas daljes së vezës nga folikuli, folikuli i zbrazur mbushet me gjak. Ekzistojnë qeliza të veqanta të quajtura ‘granuloza’ dhe ‘theka’ të cilat rrethojnë hapsirën boshe ku gjenden këto folikule; ato shumohen dhe zënë vendin e gjakut të mpiksuar në folikule. Këto qeliza akumulojnë lipide të verdha dhe për këtë quhen qelizat luteine, nga fjala latine luteus ‘saffron’ – e verdhë).¹⁵

Kështu që folikuli nga i cili është liruar veza fryhet me lëngje që e kanë mbushur atë dhe bëhet element aktiv që quhet korpus luteum (trupi i verdhë). Korpus luteum luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e mitrës për embrionin dhe në udhëheqjen e shtatzanisë në mënyrë të shëndetshme. E veçanta më e rëndësishme e këtij elementi është sekretimi (tajitja) i hormonit të quajtur progesteron nën ndikimin e LH-së (hormonit luteinizant). Progesteroni ka një funksion jashtëzakonisht të rëndësishëm në stimulimin e mureve të mitrës. Ndryshimi më i rëndësishëm në mitër ndodh në mukozën e membranës (mucus) që vesh mitrën përmbrenda. Nën ndikimin e estrogenit dhe progesteronit, mukozja e membranës fillon të ajët (fryet). Gjëndrrat dhe enët e gjakut bëhen shumë dredha-dredha dhe trashësia e mureve të mitrës rritet. Qëllimi i këtyre ndryshimeve është që të përgatitet një vend i përshtatshëm për embrionin pas fekondimit. Përveç kësaj, lejon që shtatzënia të avancoj duke i bërë muret e mitrës të lirohen (zbuten). Progesteroni ndikon edhe në zhvillimin e gjëndrrave të qumështit.

Që një hormon të ketë ndikim në një hormon tjetër dhe të kenë ndjesin për t’i bërë këto gjëra saktësisht në kohën e duhur nuk mund të shpjegohet me veprimin e rastësisë. Kjo sjell ca pyetje në mendje: Si mundet që një molekulë e formuar nga atomet pa vetëdije të posedojë një fuqi të lindur kaq të ndjeshme dhe të marrë iniciativën për organizim të veprimeve të trupit kaq lehtësisht. Është e qartë se molekulat që përbëjnë hormonet nuk kanë intelegjencë dhe vetëdije. Kjo tregon se sistemi së bashku me tiparet



Kur veza lirohet nga folikuli, korpus luteum është i formuar dhe fillon të sekretoj (tajit) estrogenin dhe progesteronin. Progesteroni stimulon muret e mitrës. Në ndikim të këtyre hormoneve, ndodhin ndryshime në muret e mitrës. Qëllimi i këtyre ndryshimeve është përgatitja e një ambineti të përshtatshëm ku embrioni do të strehohet pas fekondimit. Të gjitha këto veprime ndodhin në të gjitha femrat në radhitje të njëjtë dhe me perfeksionin e njëjtë. Këto veprime janë rezultat i një plani dhe përcaktimi të qartë.

plotësuese është krijuar nga një fuqi supreme. Ai është Zoti, Sunduesi i tokës dhe i qiellit I Cili ka inspiruar molekulat që përbëjnë hormonet dhe atomet që përbëjnë molekulat në aktivitetet e tyre të vetëdijshme.

Faza korpus luteum zgjat 12-14 ditë. Në fund të kësaj periudhe, nëse fekondimi nuk ka ndodhur, korpus luteum degjenerohet dhe faza e njëjtë përsëritet. Me degjenerimin e korpus luteum-it, estrogeni, progesteroni dhe hormonet e tjera nuk sekretohen (tajiten) më; kjo d.m.th. se gjëndrra e hipofizës prapë fillon veprimin. Prapë fillon sekretimi (tajitja) i FSH-së dhe LH-së në gjëndrën e hipofizës, duke ndikuar që rritja e folikulit të filloj. Por këto folikule nuk mund të zhvillohen mjaft sepse mungesa e estrogenit dhe progesteronit bëjnë që një fazë e re të filloj – menstruacioni.

4. Menstruacioni: Kjo është fazë në të cilën veza e pafekonduar largohet nga trupi. Pasiqë fekondimi nuk ka ndodhur, muret e përgatitura të mitrës tkurren, enët e gjakut shtrëngohen dhe veza nxjerret jashtë. Pas kësaj faze, trupi fillon prapë të përgatitet për kryerjen e të gjitha këtyre funksioneve.

Tërë kjo fazë përsëritet te të gjitha femrat rregullisht gjatë një periudhe të caktuar kohore. Çdo muaj qeliza vezë të reja prodhohen, hormonet e njëjta sekretohen (tajiten) vazhdimisht në të njëjtën periudhë dhe trupi i femrës përgatitet sikur fekondimi të ndodh. Por në fazën e fundit, drejtimi i përgatitjes ndryshon në bazë të asaj se a është apo nuk është sperma prezente.

Përgatitjet për Fekondim

Qeliza vezë është 20-25 cm larg nga vendi ku hyn sperma në trupin e femrës. Kjo distancë është rreth 3000 herë e madhësisë së spermatozoidit. Duke e marr në konsideratë proporcionin e madhësisë së tij, kjo distancë është mjaft e madhe dhe për të kaluar atë spermatozoidi ka nevojë për mbështetje të madhe.

Para se veza të takohet me spermatozoidin, përgatitjet fillojnë në të dy trupat të mashkullit dhe të femrës. Pjesa më e madhe e këtyre përgatitjeve janë për mbrojtje të spermatozoidit gjatë udhëtimit në trupin e nënës. P.sh. në mitër ndodhin tkurrje dhe dallgëzime të ndryshme. Ky aktivitet i veçantë në mitër dhe tubin fallopijan lehtëson avancimin e spermës në drejtim të vezës. Gjëja interesante rreth këtyre tkurrjeve është substanca që i shkakton ato. Kjo substancë quhet prostaglandin dhe gjendet në lëgun e fshikzës seminale që vjen me spermën nga trupi i mashkullit. Përkundër faktit se vjen nga një trup tjetër, kjo substancë njihet strukturën e mitrës së nënës dhe ndikon në atë mënyrë që rrugën për spermën t'a lehtësoj.¹⁶

Që të ndodh fekondimi, ndryshimet që ndodhin në mitër nuk janë të kufizuara në këto. Gjatë kësaj periudhe tubat zgjerohen; nën ndikimin e hormonit të estrogenit, mukoza membranës që shtreson mitrën rritet në madhësi dhe peshë. Qelizat epiteliale të indeve të membranës të përbëra nga një apo më shumë shtresa të qelizave e ndarë nga një substancë ndërqelizore shumë e vogël shumohet. Ky ndërtim në mukozë merr një formë që do t'i lejojë spermatozoidet që me lëvizjen e bishtit të tyre të kalojnë këto hapësira. Përveç se i mundëson spermatozoidit të lëvizë lehtësisht, ky transformacion ka edhe një funksion tjetër shumë të rëndësishëm: indet shërbëjnë si depo dhe hapësirë filtruese duke lejuar që vetëm spermatozoidet normale të

*Është Ai I Cili krijoi qiejt
dhe tokën vetëm me të
vërtetën. Ditën që Ai
thotë 'Bëhu!' ajo bëhet.
Fjala e Tij është e Vërteta.
Gjithë sundimi është I Tij
në Ditën kur i fryhet
Trumpetës. Ai është
Njohës i të Padukshmes
dhe të Dukshmes. Ai
është I Urti, I
Gjithëdijshmi.
(Kur'an, 6: 73)*

MREKULLIA E KRIJIMIT TË NJERIUT


kalojnë. Nganjëherë spermatozoidet nuk kanë formën e duhur që të sigurojnë fekondimin. Në këtë rast, ato mënjanohehen në këto inde.

Siç po shikojmë, është e qartë se çdo lëvizje në mitër dhe vezore është projektuar në mënyrë të veçantë për arritjen e spermatozoidit tek veza. P.sh. mbasi të është kryer ovulacioni dhe mundësia e takimit të vezës me spermatozoidin të jetë siguruar, mukoza fillon të bëjë veprim të kundërt: ajo bëhet e trashë dhe e dendur, duke e ndaluar hyrjen e spermatozoideve të tjerë.

Arsyeja e ndryshimeve që ndodhin në sistemin riprodhues të femrës është që t'ia mundësoj spermatozoidit që të arrijë vezën (ovum). Por, siç pamë më lart dhe në pjesët e tjera, kjo është një çështje tejet interesante: elementet në sistemin riprodhues të femrës ndihmojnë qelizat që vijnë nga një trup plotëisht i ndryshëm.

Si ndodh që një qelizë të ketë aq shumë informata të detajuara për qelizën tjetër me të cilën kurrë nuk ka pasur një ambient të njejtë? (edhe sikur t'a kishin të njejtin ambient rezultati nuk do të ishte ndryshe.) si e di, p.sh. se lëvizja e këtyre qelizave duhet të lehtësohet? Në të vërtetë, nuk është e mundur që qelizat që prodhojnë lëngun në mitër të dijnë cilësitë e spermatozoideve në mënyrë që të përgatisin një ambient të përshtatshëm për ata.

Të gjitha funksionet që i kemi përshkruar deri në këtë pikë ndodhin në trupat e të gjitha femrave me renditje perfekte të njejtë. Kur shqyrtojmë



spermatozoidet duke lëvizur në mukus



Spermatozoidet kanë një ndërtim elastik që ju mundëson atyre t'i rezistojnë rrugës së gjatë dhe të vështirë në trupin e nënës. Siç shofim në foto në të majtë, disa spermatozoide janë të dëmtuara.

Spermatozoidet e dëmtuara eliminohen derisa udhëtojnë në trupin e nënës, ndërsa spermatozoidet e shëndosha vërehen dhe udhëhiqen për te veza. Kështu, veza gjithmonë bashkohet me një spermatozoid të shëndosh.

veprimin harmonik dhe plotësues të këtyre sistemeve, ballafaqohemi me një plan dhe ndërtim të qartë: sperma është e ndërtuar për trupin e nënës, organet riprodhuese të nënës janë të rregulluara posaçërisht për strehim të spermës. Sikur të ishte edhe defekti më i vogël në këtë harmoni, p.sh. sikur spermatozoidi të mos kishte bishtin që i mundëson lëvizjen, apo sikur të mungonte lëngu për balancimin e ambientit acidik në trupin e nënës, riprodhimi nuk do të ndodhte.

Kjo qartë tregon se harmonia e madhe që ekziston në mes të qelizave riprodhuese të trupit të mashkullit dhe të femrës është punë krijimi e qëllimshme dhe e planifikuar. Është Zoti I Plotfuqishëm, Zoti i universit I Cili krijoi llojin njeri nga një pikë lëngu, femrën dhe mashkullin, në harmoni me njëri tjetrin. Njerëzit duhet të mendojnë për mënyrën e përsosur të krijimit nga Zoti dhe t'a nënshtrojnë veten në mënyrë të pakushtëzuar ndaj Tij, duke u përkulur para fuqisë së përhershme të Zotit.

Dhe në krijimin e juaj dhe të të gjitha krijesave që Ai shpërnda, ka Shenja për besimtarët e vërtet. (Kur'an, 45: 4)


Lëvizjet e Vetëdijshme të Tubës Fallopiane

Mbasi veza e pjekur lirohet, ajo kapet nga tubi fallopian. Sikur qeliza vezë mbasi lirohet të mos kapej nga tubi fallopian, do të kalonte nëpër pjesët e tjera të trupit të nënës dhe nuk do të mund t'a takonte spermatozoidin.

Tubi fallopian është aty ku veza dhe spermatozoidi takohen. Në mënyrë që të sigurohet takimi, tubi fallopian kryen aktivitete të dyfishtë; së pari, e merr qelizën vezë të pjekur nga vezorja dhe e udhëheq në tub në vendin ku do të takojë spermatozoidin. Së dyti, i merr spermatozoidet nga kaviteti i mitrës dhe i dërgon te vendi ku do të takojnë vezën.

Së pari, tubat fallopiane, të cilat janë të lokalizuara pranë vezoreve, mbledhin të gjitha vezët e liruara nga vezorja. Skajet e tubave fallopiane janë sikur krahë të cilët i rrethojnë vezoret dhe janë të ndërtuar të mbedhin vezët e pjekura. Kur vezët të kenë arritur pjekurinë, krahët e tubave fallopian hapen, dhe sikur krahët e një oktapodi, ato kapin sipërfaqën e vezës dhe lëvizin mbi të me një lëvizje fshirëse. E ndihmuar nga këto aktivitete, në kohën e ovalucionit veza bie në tubën fallopiane. Veza e liruar në zgavrën e komblikut, hyn në tubën fallopiane e cila ka 10–20 cm gjatësi. Brendësia e tubës fallopiane është e mbuluar me miliona qime të imëta të cilat lëvizin në të njejtin drejtim, duke tërhequr vezën në vendin ku do të takohet me spermatozoidet.¹⁷


Në këtë kohë, qelizat e folikulit që rrethojnë vezën në kohën e ovulacionit ende qëndrojnë si një zarf i jashtëm. Mukoza e membranës që mbështjell vezën sekreton (tajit) enzime të cilat gradualisht




100 reach vicinity of ovum


bëjnë që ky zarf qelizor të lirohet. Kështu, qelizat e folikulit 'shpërlahen", dhe në këtë mënyrë membrana mbrojtëse e vezës i ekspozohet spermatozoideve.

Kohë zgjatja e këtyre veprimeve që bëhen nga tuba fallopiane është shumë e rëndësishme, sepse të dyja edhe veza edhe spermatozoidet kanë jetëgjatësi të kufizuar. Është e domosdoshme që spermatozoidet të arrijnë qelizën e vezës para se të kalojë kjo jetëgjatësi. Si bën rregullimet tubi fallopian për këtë? Si e di sa gjatë jetojnë qelizat e huaja?





momenti kur folikuli i pjekur e lëshon vezën



qeliza vezë është në lëvizje



tuba fallopiane përgatitet që të marr vezën



momenti kur tuba fallopiane merr vezën

Sigurisht që një masë mishi, disa centimetra në gjatësi, nuk e ka informatën apo shkathtësinë që të kryej këto veprime. Siç ndodh me çdo qelizë dhe ind, edhe tubi fallopian kryen aktivitetin e tij vetëm me inspirim nga Zoti, Krijuesi i të gjitha botërave. Për këtë arsye, ai mund të kryej lehtë dhe pa pengesa këtë aktivitet të vështirë. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që fekondimi i vezës të bëhet para se ajo të vdes, që është më së shumti 24 orë.

Mbasi të largohet nga vezorja, veza kapet nga tuba fallopiane me një kordinim të mrekullueshëm. Miliona qime të imëta në tubën fallopiane punojnë së bashku për një qëllim të përbashkët. Lëvizja e qimeve luan një rol të rëndësishëm në takimin e spermatozoideve me vezën.

Këtu kohë zgjatja është e rëndësishme, sepse qelizat riprodhuese kanë jetëgjatësi të kufizuar në trup.

Nëse mbesin aty gjatë, ato vdesin. Mirëpo, aktivitetet në tubën fallopiane kompletohen brenda kohës së kufizuar të jetëgjatësisë të spermatozoideve dhe të qelizës vezë. Këtu, kemi një çështje shumë të rëndësishme që ja vlen të përmendet: pjesët e mishit të përbëra nga qelizat nuk mund të bashkë-veprojnë, të bëjnë rregullime kohore, të mendojnë dhe veprojnë me vetëdije. Të gjitha këto qeliza dhe inde në trupin e njeriut janë nën kontrollin e Zotit.



qeliza vezë



qeliza vezë në tubën fallopiane

Spermatozoidi Takon Vezën

Pas kalimit të shumë proceseve në rrugën për pjekuri, veza lirohet nga tubat fallopian. Në këtë kohë, ajo bart me vete shumë qeliza që e rrethojnë atë. Para se veza të fekondohet, spermatozoidi i cili arrin në tubin fallopian duhet të kalojë nëpërmes këtyre qelizave, të cilat quhen qeliza 'granulosa', dhe pastaj depërton mantelin (mbulesën) e trashë rreth vezës.


Si kalon spermatozoidi këto pengesa?

Këtu shikojmë prapë perfeksionin e qartë të ndërtimit inteligjent të spermatozoidit. Në pjesën e spermatozoidit të quajtur 'akrozom', për të cilin kemi folur më herët, janë të vendosura enzimet hialuronidaz dhe proteolitik. Enzimi hialuronidaz zbërthen një substancë (acidin hialuronik) i cili i lidh shtresat e shumëfishta të qelizave granulose që janë të ngjitura me pjesën e jashtme të ovules (vezës). Në këtë mënyrë, i hap rrugë spermatozoidit të përshkojë zarfin (membranën) e vezës. Enzimi proteolitik bën tretjen e proteinave në indet e ngjitura të vezës. Me ndihmën e këtyre dy enzimeve, spermatozoidi arrin vezën.¹⁸

Si mundet që këto enzime të cilat i përkasin spermatozoidit, të prodhuara në trupin e mashkullit larg nga veza, janë të përbëra nga lënda që në mënyrë perfekte është në gjendje të ndikojë në ndërtimin e vezës? Kush zbuloi formulën për këtë veprim? Kush i vendosi enzimet saktësisht në vendin e duhur, në kokën mikroskopike të spermatozoidit, që të mundësohet fekondimi i vezës?

Nuk është vet spermatozoidi ai i cili i bën të gjitha këto gjëra. Nuk është e mundur që spermatozoidi të ketë dituri për ekzistimin e acidit hialuronik apo të efektit të këtij acidi që ka në qeliza, apo të di se enzimi hialuronidaza do të neutralizojë efektin e këtij acidi. Megjithatë, nuk është e mjaftueshme të dihet vetëm formula e këtij acidi; por duhet të sigurohet po ashtu edhe prodhimi i tij në trupin e njeriut. Dhe është e pamundur që spermatozoidi vet të formojë sistemin në trupin e njeriut që do të prodhojë këtë enzim. P.sh. nëse e pyet dikënd, i cili nuk ka kualifikim në mjeksi apo kimi, për emrin e enzimit i cili shkatërron strukturën e acidit hialuronik, apo nëse i kërkoni që t'a shkruaj formulën e strukturës së këtij acidi, sigurisht se nuk do të jetë në gjendje t'ju japë ndonjë përgjigje. Por spermatozoidi bën gjëra që njeriu me


*Zoti i juaj është një, nuk ka zot tjetër
përpos Tij. Ai i përfshinë të gjitha
gjërat në diturinë e Tij.
(Kur'an, 20: 98)*



një qelizë vezë e rrethuar nga
spermatozoidet





vetëdije (mendje) nuk është në gjendje t'i bëjë; me një vetëdije të formulave kimike, të cilat formula megjithëse nuk i di, ai përmban brenda trupit të tij substancën që garanton arritjen e qëllimit. Sigurisht që, të thuhet se spermatozoidi bën këtë është plotësisht kundër inteligjencës dhe arsyes. Duke lënë anash supozimet jo inteligjente dhe të paarsyeshme, kuptojmë se vet prezenca e enzimeve në spermatozoid që të ndikojë në strukturën e vezës është dëshmi e krijimit. Kjo harmoni pa të meta nuk mund të shpjegohet në asnjë mënyrë si rastësi. Fakti që spermatozoidi është në dijeni të strukturës kimike të një qelize tjetër megjithëse jeton plotësisht në një ambient tjetër; që analizon efektet që kanë këto kimikale; që pastaj prodhon kemikalet e nevojshme si rezultat i analizave; mund të shpjegohet vetëm në adresim të një Krijuesi me inteligjencë superiore, I Cili ka krijuar spermatozoidin me këto cilësi të veçanta.

Ndërtimi perfekt i spermatozoidit është një nga shumë dëshmitë se Zoti krijoj njerëzit dhe çdo gjë tjetër.



Në ilustrimin lart, shofim fazat e formimit të qelizës vezë dhe momentin e fekondimit kur spermatozoidi dhe veza takohen.

Udhëtimi i Vezës në Tubën Fallopiane



Pak para lirim të vezës së pjekur nga vezorja, tuba fallopiane futet në veprim për kapjen e vezës. Me prekje delikate në sipërfaqen e vezorës, mundohet të gjej qelizën vezë (1-2). Në mënyrë që veza e pjekur të fekondohet, ajo duhet të hyj në tubën fallopiane. Më në fund tuba fallopiane e gjen vezën e pjekur dhe e tërheq atë brenda. Tash, qeliza vezë fillon udhëtimin e saj. (3) Në mënyrë që veza të fekondohet dhe të arrijë në mitrën e nënës, duhet të kalojë një rrugë të gjatë në tubën fallopiane. Funkzioni i miliona qelizave në tubën fallopiane udhëheq vezën për në mitër. Qimet e imëta në sipërfaqen e këtyre qelizave (cilia) lëvizin vetëm në një drejtim. Në këtë mënyrë, sikur të ishin duke bartur një objekt të çmueshëm nga dora në dorë, ato shtyejnë qelizën vezë për në vendin ku ajo duhet të shkoj. Më në fund, veza takon spermatozoidet të cilat janë duke e kërkuar. (4) Vetëm një spermatozoid ka sukses të depërtoj në vezë. (5) Veza e fekunduar drejtohet për në mitrën e nënës me ndihmën e qimeve të imëta të tubës fallopiane (6). Secila qelizë kryen detyrën e saj pa të meta, sepse krijimi i Zotit është perfekt.

Spermatozoidi Vazhdon Udhëtimin e Tij


Kur spermatozoidi arrin shtresën e jashtme të vezës, membrana e tij e jashtme lidhet fort me receptorët sipërfaqësor të vezës. Mbase lidhja të arrihet, spermatozoidi lëshon mbulesën e tij të jashtme (akrozomin). Në të njëjtën kohë, membrana e vezës sekretohet (tajit) një substancë që quhet 'fertilizin', e cila nevojitet për të tërhequr spermatozoidin. Kjo molekulë ia mundëson spermatozoidit që të lëvizë më shpejt dhe të reagojë më lehtë me membranën e vezës. Përveç kësaj, fertilizini ndihmon reaksionin e akrozomit që gjendet në kokën e spermatozoidit.

Kur spermatozoidi prek membranën e vezës, substanca të reja hyjnë në lojë dhe një reaktion i ri ndodh. Kur spermatozoidi prek vezën, sekretohet (tajitet) një substancë që quhet 'anti-fertilizin' e cila neutralizon efektin e fertilizinit të sekretuar (tajitur) nga veza. Në këtë mënyrë, spermatozoidi i parë që arrin vezën ndalon spermatozoidet e tjera t'i afrohen vezës.¹⁶

Membrana që rrethon qelizën vezë fillon të ripërtrijë vetveten menjëherë mbas dy sekondash nga hyrja e spermatozoidit dhe ju ndalon rreptësisht hyrjen e spermatozoideve të tjerë. Janë bërë eksperimente ku është vërejtur se hyrja e disa spermatozoideve në vezë shkatërron membranën. Për këtë arsye është e nevojshme që membrana fekonduese të formohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Pas formimit të membranës fekonduese, asnjë spermatozoid nuk mund më të hyjë në vezë. Në këtë gjendje, qelizën e vezës mundemi t'a krahasojmë me një ndërtesë të mbrojtur nga sigurimi. Membrana e jashtme e qelizës së vezës me të vërtetë vepron ashtu si një sistem kontrollues sigurimi i një ndërtese e cila përmban informata shumë të rëndësishme: hyrja është e ndaluar në brendinë e qelizës.

Pasi që spermatozoidi të hyjë në ovum, koka e tij enjtet (fryhet) dhe lëviz shumë ngadal në drejtim të qendrës së vezës. Me vonë, brenda 30 minutave, veza bashkohet plotësisht me spermatozoidin. Si rezultat i të gjitha këtyre proceseve, informacioni gjenetik i mbajtur në spermatozoid transferohet te veza.¹⁹

Por edhe këtu është një pikë e rëndësishme: nëse receptorët e spermatozoidit dhe të vezës pranojnë njëri tjetrin, ata lidhen me njëri tjetrin,



Në foton e madhe shofim një qelizë vezë të rrethuar nga spermatozoidet; në foton e vogël, një numër të qelizave spermatozoide. Spermatozoidet kanë karakteristika të veçanta që u lejojnë atyre të bashkëveprojnë me ndërtimin e vezës. Vetëm një nga këto karakteristika, p.sh. ekzistimi i enzimit i cili ia bën të mundur spermatozoidit të shpoj sistemin mbrojtës të vezës dhe të futet në të, është dëshmi e krijimit. Zoti krijoi spermatozoidet me të gjitha karakteristikat e tyre të veçanta përnjëherë (jo gradualisht).


nëse jo lidhja është e pamundur. Arsyeja për këtë është siç vijon: veza e çdo qenie të gjallë sekretion (tajit) një substancë të quajtur fertilizin, e cila ka përbërje kimike të veçantë. Kjo është masë paraprake që parandalon qelizat spermë të llojeve të tjera (llojeve jo njeri) t'i afrohen vezës dhe të shkaktojnë degjenerim të llojit njeri. Kështu që, një macë nuk mund të shumohet me nje kalë dhe qenia njerëzore nuk mund të shumohet me ndonjë gjallesë tjetër.²⁰

Ngarkesa elektrike që bartet nga spermatozoidi dhe veza po ashtu kanë një efekt fekondimi. Veza çdoherë bart ngarkesë negative dhe spermatozoidi bart atë pozitive. Pasiqë ngarkesat e kundërta tërheqin njëra tjetrën, veza tërheq spermatozoidin kah vetja. Por me hyrjen e spermatozoidit të parë në vezë, ngarkesa ndryshon menjëherë. Tash veza merr një ngarkesë pozitive sikurse të spermatozoidit. Sikurse ngarkesat që zbrapsin njëra tjetrën, në momentin e bashkimit edhe veza fillon të zbraps të gjithë spermatozoidet e tjera.



Faza e Fundit e Fekondimit

Kur spermatozidi futet në vezë, ai e lëshon bishtin e tij dhe e le jashtë. Këtë mundemi t'a krahasojmë me një anije kozmike e cila duke u kthyer në tokë shkëput tankun e lëndës djegëse. Sikur që e dijmë, kur tanket me lëndë djegëse të cilat bartin anijen kozmike jashtë atmosferës së tokës, plotësojnë qëllimet, ato lirohen në hapësirë; kur lënda djegëse brenda tyre shfrytëzohet, tanket janë një peshë e panevojshme. Që të lehtësohet largimi nga atmosfera e tokës, është e nevojshme që këto tanke të lirohen saktësisht në kohën e duhur. Në të njejtën mënyrë, bishti i spermatozoidit, që ofron energjinë e nevojshme dhe aftësinë e lëvizjes, lihet prapa derisa spermatozoidi përpiqet të hyj në vezë.

Është e qartë te lexuesi i vëmendshëm se fekondimi është një proces sistematik dhe i logaritur mirë. Shumë ngadalë lëngjet që rrethojnë vezën zbërthejnë blindimin e spermatozoidit pasi ai të ketë arritur membranën e



Kur spermatozoidet takojnë vezën, vetëm një nga ato ka sukses që të përshkoj membranën mbrojtëse të saj. (1) Mbase spermatozoidi futet në vezë, ndryshime të caktuara ndodhin dhe veza mbyll veten për spermatozoidet e tjera. (2-3) Në kohën e futjes në vezë, bishti spermatozoidit shkëputet dhe mbetet jashtë. (4) Fekondimi bëhet.



Në momentin që spermatozoidi futet në vezë, ai e lëshon bishtin e tij. Në foto lart shikojmë, shkëputjen e bishtit të spermatozoidit fazë pas faze i cili ia ka dalur të futet në vezë. Shkëputja ndodh sepse lëvizja e vazhdueshme e bishtit brenda vezës do të dëmtonte vezën shpejt. Kjo shkëputje e bishtit të spermatozoidit mund të krahasohet me hedhjen e tankeve të lëndëve djegëse dhe motorëve të cilët më nuk nevojiten nga raketat dhe anijet kozmike derisa ato largohen nga atmosfera e tokës në rrugë për në kozmos. Fakti që spermatozoidi llogarit në diçka si kjo dhe heq bishtin me kohë, që të mos dëmtojë vezën, është shenjë e një aktiviteti me vetëdije të lartë. Ai i Cili bën këtë spermatozoid të veprojë në këtë mënyrë të vetëdijshme është Zoti, Krijuesi i spermatozoidit dhe vezës.

jashtme që rrethon vezën. Enzimet të cilat lirohen në momentin që blindimi i spermatozoidit shpohet lejon spermatozoidin të përshkojë membranën e jashtme të vezës dhe të futet. Ndryshimi i ngarkesës elektrike në këtë moment zbraps spermatozoidet e tjera dhe mbron organizmin e ri në zhvillim nga mysafirët e paftuar.

Sikur të mos ishte krijuar një sistem i tillë kaq mbrojtës dhe bashkëpunues, bashkimi i spermatozoidit dhe vezës kurrë nuk do të arrihej.

Sikur veza të mos sekretonte (taji) lëngun udhëheqës, nuk do të ishte e mundur për spermatozoidin të arrinte vezën, e cila duke marr parasysht madhësinë është shumë larg nga ai.

Sikur spermatozoidet të mos kishin blindimin e tyre, ato do të treteshin nga lëngu që rrethon vezën sikurse mikroorganizmat e tjerë.

Sikur enzimet speciale të mos ishin vendosur nën këtë blindim, spermatozoidi kurrë nuk do të mund të futej në vezë, edhe pas atij udhëtimit të gjatë për t'a arritur atë.

Sikur ngarkesa elektrike e spermatozoidit dhe e vezës, të ishte e njëjtë dhe jo e kundërt, veza do të zbrapste spermatozoidin dhe asnjë spermatozoid nuk do të futej në vezë.

Siç po shofim, në bashkimin e një spermatozoidi të vetëm me vezën ekziston një balancim dhe një llogaritje e jashtëzakonshme. Gjithashtu, ky balancim dhe kjo llogaritje nuk ka ndodhur vetëm njëherë; por ato përsëriten qysh nga fillimi i racës njerëzore në secilin miliona njerëz që janë të shpërndarë nëpër botë.

Edhe në një fazë të vetme nuk ka hapësirë për rastësi në këtë proces të mrekullueshëm, i cili paraqet qartë se Zoti krijoi qenien njerëzore.

Gjithçka në qiej e në tokë i takon Atij. Të gjithë janë të nënshtruar tek Ai. Ai është I Cili nisi krijimin dhe pastaj e regjeneron atë. Ajo është shumë e lehtë për Atë. Shëmbëlltyra më e lartë në qiej e në tokë është vetëm e Tij. Ai është I Plotëfuqishmi, I Urti. (Kur'an, 30: 26-27)

Mbrojtësja Parzmore (e blinduar) e Spermatozoidit



Pjesa e kokës së spermatozoidit është e mbuluar me parzmore (blindim 1-2). Nën këtë blindim gjendet edhe një blindim tjetër, dhe nën këtë gjendet materiali që bart spermatozoidi. (3-4) Ky blindim e ruan nga materialet e dëmshme që gjenden për rreth, materialin e vlefshëm që është brenda, e ky është, informacioni gjenetik. Mbrojtësja blinduese është shumë e fortë, megjithatë është e projektuar që të hapet lehtë në momentin e duhur. (5). P.sh. gjatë fekondimit kjo mbrojtëse e blinduar në kokën e spermatozoidit hapet dhe liron enzimet tretëse që i ka brenda. (6) Fakti se ky ndërtim i mrekullueshëm është vendosur në një qelizë mikroskopike është një shembull i krijimit pa të meta të Zotit.

Përcaktimi i Gjinisë së Foshnjës

Deri vonë njerëzit kanë menduar se gjinia e foshnjës përcaktohet nga qelizat e nënës, ose mendohej se gjinia përcaktohej nga qelizat e nënës dhe të babait. Mirëpo Kur'ani thotë ndryshe për këtë çështje; thotë se gjinia mashkullore dhe femërore krijohet nga sperma që hyn në mitër:

Ai (Zoti) ka krijuar të dy gjinitë, mashkull dhe femër, nga një pikë e semenit të derdhur (Kur'an, 53: 45-46)





E vërteta e kësaj shpallje në Kur'an është konfirmuar shkencëtarisht me zhvillimet në gjenetik dhe mikrobiologji. Tash është e ditur se gjinia përcaktohet nga spermatozoidi mashkullit dhe se veza e femrës nuk luan asnjë rol në këtë përcaktim. Çka përcakton gjinin janë kromozomet. Nga 46 kromozomet që përcaktojnë ndërtimin e njeriut, dy prej tyre quhen kromozomet e gjinisë. Këto kromozome të mashkullit janë të emërtuara XY dhe të femrës XX, sepse këto kromozome ju gjasojnë këtyre shkronjave. Kromozomi Y bart gjenet mashkullore dhe X bart gjenet femërore. Formimi i një njeriu fillon me bashkimin e njërit nga këto kromozome të cilat janë prezente në çifte të mashkullit dhe të femrës. Gjatë ovulacionit të femrës, qeliza e gjinisë ndahet në dy, secila bart kromozomin X. Të meshkujt, qeliza e gjinisë ndahet në dy spermatozoide, njëri bart kromozomin X dhe tjetri kromozomin Y. Nëse kromozomi X i femrës bashkohet me spermatozoidin që bart kromozomin X, foshnja do të jetë vajzë; nëse bashkohet me spermatozoidin që bart kromozomin Y, foshnja do të jetë djalë.

Kjo d.m.th. se gjinia e foshnjës varet nga ajo se cili kromozom i mashkullit bashkohet me vezën e femrës.


Natyrisht që, këto fakte ishin të panjohura deri në shekullin e njëzetë derisa nuk u paraqit shkencë e gjenetikës. Në shumë kultura gjerësisht besohej se gjinia e foshnjës përcaktohej nga femra. Saktësisht për këtë arsye, gruaja e cila linte vajzë ndëshkohej. Mirëpo, në Kur'an, 13 shekuj para zbulimit të gjeneve, ky paragjykim ishte refuzuar me shpalljen se origjina e gjinisë nuk vënie nga femra por nga semeni i mashkullit.

Kur'ani është fjala e Zotit, Sunduesit të të gjitha botërave. Mrekulli të tilla shkencore janë ndër dëshmitë e këtij fakti.



Gjinia e një foshnje varet nga ajo se cili kromozom i mashkullit bashkohet me vezën e femrës. Nga 23 çiftet e kromozomeve (d.m.th.. 46 kromozome individuale), 2 quhen kromozomet e gjinisë. Këto dy kromozome janë emërtuar si XY te mashkulli dhe XX te femra). Kromozomi Y bart gjenet mashkullore, kromozomi X bart gjenet femërore. Formimi i njeriut fillon me bashkimin e njërit nga këto kromozome, të cilat janë prezente në çifte të mashkujt dhe femrat (majtas). Nëse kromozomi X i femrës bashkohet spermatozoidin e mashkullit që përmban kromozomin X, foshnja do të jetë vajzë; nëse bashkohet me spermatozoidin e mashkullit që përmban kromozomin Y, foshnja do të jetë djalë.²¹

Është Libër që Ne e zbritëm për ju, plotë begati, kështu që njerëzit inteligjent të mendojnë për Shenjat e tij dhe të kushtojnë vëmendje. (Kur'an, 38: 29)



*Ata nuk madhërojnë All-llahun me
nderin që i takon Atij. Megjithatë Zoti
është I Plotëfuqishmi
dhe Ngadhënjesi.
(Kur'an, 22: 74)*

KRIJIMI I NJERIUT NGA NJË QELIZË

Transformimi Fillon:

Tre Etapat e Foshnjës në Mitër

Nga ajo që pamë deri këtu, shifet qartë se çdo periudhë kohore në formimin e spermës dhe të vezës dhe deri te takimi i tyre, çdo gjë që ndodh është një mrekulli. Ndryshimet që ndodhin kur këto dy qeliza bashkohen, dhe të gjitha përgatitjet që bëhen në trupin e femrës na paraqesin ndodhi të tjera të mrekullueshme.

Vetëm brenda disa orëve pasiqë veza të jetë fekunduar nga spermatozoidi, ajo ndahet dhe rritet shumë shpejt. Në ditët e sotme e dijmë se foshnja shkon nëpër tri faza të zhvillimit të embrionit derisa është në mitrën e nënës. Por ky informacion që u arrit me ndihmën e teknologjise moderne pas shumë viteve hulumtimi, është dhënë në Kur'an 1400 vite më parë. Këto fakte shkencore janë shpallur në këtë varg:

...Ai iu krijon juve fazë pas faze në mitrat e nënave tuaja në një errësirë të trefishtë. Ai është Zoti, Sunduesi i juaj, Sovraniteti është I Tij. Nuk ka Zot tjetër përveç Atij. Çka ju bëri pra të largoheni prej Atij? (Kur'an, 39:6)

Do të vëreni se ky varg paraqet se tri faza të ndryshme ndodhin gjatë zhvillimit të njeriut derisa gjendet në mitrën e nënës. Me të vërtetë, biologjia moderne ka vërtetuar se foshnja në mitrën e nënës kalon nëpër tri faza të ndryshme të zhvillimit, sikurse që është paraqitur në këtë varg. Kjo është një çështje e infomacionit bazë në të gjitha librat embriologjike që kërkohet të lexohet sot në fakultetet e mjekësisë. P.sh. Embriologjia Bazike e Njeriut, një punim bazë për embriologji, jep deklaratën në vijim:



Jeta në mitër ka tre etapa: 1) para-embrionike: java e parë deri dy javë e gjysmë; 2) embrionike: deri në fund të javës së tetë, dhe 3) fetale - nga java e tetë deri në lindje.

Këto etapa përbëhen nga faza të ndryshme të zhvillimit të foshnjës. Veçoritë kryesore të këtyre tre etapave mund t'i përmbledhim si në vijim:

- Etapa para-embrionike: Në etapën e parë, zigoti (qeliza e sapo fekunduar) shumohet. Brenda tre javëve të para, mbasi të jetë bërë grumbull qelizash, e ngulit veten në muret e mitrës. Përderisa qelizat vazhdojnë të shumohen, ato formojnë tre shtresa.

- Etapa embrionike: Etapa e dytë zgjat plotë pesë javë e gjysmë, gjatë të cilave foshnja quhet embrion. Në këtë etapë organet dhe sistemet themelore të trupit marrin formë nga shtresat e qelizës.

- Etapa e fetusit: Me hyrjen në etapën e tretë të shtatzënisë, embrioni quhet fetus. Kjo etapë fillon nga java e tetë e shtatzënisë dhe vazhdon deri në lindje, për dallim nga etapat e më hershme, këtu fytyra, duartë dhe këmbët e fetusit bëhen të dallueshme dhe merr pamjen e jashtme të qenies njeri. Në fillim të kësaj etape, të gjitha organet e fetusit 3 cm. janë nëpër vende. Kjo etapë zgjat tridhjetë javë dhe zhvillimi vazhdon deri në javën e lindjes.

Etapat të cilat i përshkruam këtu me pak fjalë dhe zhvillimet mahnitëse që ndodhin në secilën etapë do të shpjegohen në detaje në faqet në vijim.

Qeliza e Parë Fillon të Shumohet


Qeliza e parë që përmban 46 kromozome e cila është formuar me bashkimin e spermatozoidit dhe të vezës është qeliza e parë e njeriut të ri që do të hap sytë në botë pas nëntë muajve. Qeliza e parë dhe e vetme e cila përmban planin për tërë trupin quhet 'zigot'.

Ndarja e parë e qelizës fillon 24 orë pas bashkimit të spermatozoidit dhe vezës. Këto dy qeliza të formuara janë identike me njëra tjetrën. Me këtë, fillon dita e parë e periudhës nëntë muajshe të jetës në mitrën e nënës. Tash në mitrën e nënës nuk është një qelizë por janë dy. Më vonë ky numër rritet në katër dhe në këtë mënyrë vazhdon shumimi me ndarje.²²

Grumbulli i qelizave në tubin fallopian vazhdon të ndahet dhe rritet dhe lëvizë në drejtim të vendit ku ato do të kalojnë nëntë muajt e tjerë. Kjo është mitra e nënës (uterus).

Në këtë fazë, ndryshimet e nevojshme ndodhin në mitër. Gjaku nxiton në mitër dhe e bën atë të zhvilluar dhe elastike. Sikur që kemi përmendur në pjesët e mëparshme, korpus luteumi në vezore rrit sekretimin (tajitjen) dhe informon trupin se shtatzënia ka filluar. Ndërkohë, zigoti lëviz me një lëvizje notuese në drejtim të mitrës dhe fillon të dërgoj sinjale biokimike që përmban mesazhin, 'Unë jam këtu'. Këto mesazhe bëjnë trupin e nënës të përgatitet dhe sigurohet për prezencën e kripës, hekurit, gjakut dhe vitaminave të nevojshme për fetusin. Në të njëjtën kohë, mesazhi biokimik që zigoti ka sekretuar (tajitur) (hCG hormoni), arrin vezorën e nënës dhe bën që një hormon tjetër aty të sekretohet (tajitet) që të parandalojë periudhën tjetër të ovulacionit (periudhën menstruale) në trupin e nënës.²³

Zigoti ende është i përbërë nga disa qeliza. Fakti që e di se ku gjendet dhe menjëherë dërgon sinjale lidhur me periudhën 9 mujorshe që pason është një gjë e jashtëzakonshme. Si e di zigoti kujt t'ia dërgoj mesazhin? Si organelet e ndryshme që pranojnë mesazhin e dijnë se është duke ardhur nga një masë mishi mikroskopik të cilin kurrë nuk e kanë takuar më parë,



qelizë e spermës

3) tuba fallopiane që kap vezën


5) kromozomet shkëmbehen dhe qeliza fillon me ndarje

4) një spermatozoid i vetëm përshkon membranën e vezës për fekundim

2) veza shpërthen nga cista e rrethuar me qeliza ndihmëse

1) fazat e zhvillimit të vezës


1) Çdo muaj një vezë lirohet nga vezoret. 2) Veza e pjekur e thyen mbulesën që e rrethon dhe lirohet në zgavrën e komblikut. 3) Veza kapet nga tuba fallopiane duke ia bërë të mundur vezës që të fekondohet me spermatozoidin. 4) Vetëm një spermatozoid i vetëm ia del të përshkojë membranën dhe të fekundojë vezën. 5) Veza e fekunduar fillon të ndahet dhe shumohet duke formuar një grumbull (tog - tufëz). 6) Në këtë fazë formohen një grumbull qelizash, të quajtura blastociste. Kjo është faza e parë e transformimit të qelizave dhe formimit të indeve dhe organeve të trupit. 7) Grumbulli i qelizave arrijnë mitrën me ndihmën e tubës fallopiane. 8) Fillon të përgatitet për të ngjitur veten në murin e mitrës.




Duke ju falemnderuar veprimit të qelizave të veçanta të projektuara për këtë qëllim, ngjitet për murin e mitrës. 9) Nëse masa e qelizave ngjitet me sukses në murin e mitrës, ajo gjen një ambient mbrojtës ku mund të ushqehet dhe fillon të rritet. 10) Në fund të fazave të ndryshme të periudhës embrionike, në foto i paraqitur në fund të javës së tetë, një person në miniaturë me madhësi 2.5-3cm. Të gjitha këto faza dëshmojnë se njeriu është krijuar. Në krijimin e vetvetës ka shenja për çdo njeri që di të mendoj.



dhe fillojnë t'a ndihmojnë duke përgatitur ambientin në të cilin do të jetojë? Në fund të fundit, hormoni i sekretuar (tajitur) nga zigoti është i përbër nga molekulat; kështu që, në vendin që janë pranuar këto molekula, si e dijnë qelizat se cili është qëllimi i këtyre molekulave me arritje në atë vend? Kur një mesazh dërgohet te njeriu në gjuhën që ai e kupton, është e mundur për atë t'a lexoj dhe t'a kuptojë, dhe të sjell një vendim në bazë të asaj se çka ka lexuar. Por në këtë rast, mesazhi përmban një hormon të përbërë nga disa molekula; ato që dërgojnë mesazhin janë një grumbull qelizash; ato që pranojnë mesazhin janë një grumbull pak më i madh qelizash. Me të vërtetë është një mrekulli që qelizat lexojnë dhe kuptojnë mesazhet (hormonet) që ju vijnë sikurse një njeri që kupton një mesazh që lexon.




Përveç kësaj, si e di zigoti se çfarë materiali i nevojitet atij gjatë rritjes së tij?




Pas bashkimit me spermatozoidin, qeliza vezë fillon të ndahet. Në ndarjen e parë formohen 2 qeliza; këto dy qeliza ndahen dhe brenda një kohe të shkurtër një grumbull qelizash formohet. Si rezultat i transformimeve që pëson ky grumbull, strukturat vitale të foshnjës formohen. Mbas periudhës që foshnja kalon në mitrën e nënës, ajo në secilin aspekt është e gatshme për jetë në botën e jashtme.

P.sh. mendo për vetveten. Çfarë duhet ngrënë në mënyrë që trupi yt të bëhet i fortë? Çfarë minerale duhet të marrësh? Këtë mund t'a mësosh vetëm me mësim nga punimet shkencore që janë bërë në këtë fushë. Çfarë efekti ka në trupin tënd kaliumi, fosfori dhe kalciumi? Prej cilit ushqim mund t'i marrësh këto gjëra? Kur dhe sa duhet ngrënë këtë ushqim? Këto janë gjëra të cilat nuk mund t'i dijs pa u konsultuar me një ekspert. Ti, një qenie me aftësi mendore, shikim, inteligjencë dhe ndjenja, me mundësinë e të folurit, mund të dijs për këto gjëra vetëm duke kërkuar ndihmë; ndërsa një grumbull i vockël qelizash e dijnë se për çfarë kanë nevojë dhe çfarë duhet të prodhohet për t'u përmbushur nevojat; e dijnë se kush mund t'a prodhojë atë që është e nevojshme dhe se duhet të dërgohet një sinjal për të filluar procesi i prodhimit. Përveç kësaj, përkundër faktit se ka qenë në trup për vetëm ca ditë, zigoti e di si duhet



Zemra, nervat, shtylla kurrizore, arteriet, mushkërit, dhëmbët, eshtrat, sythat e shijes – të gjitha këto pjesë vitale formohen derisa embrioni kalon nëpër faza në mitrën e nënës. P.sh. në fund të muajit të tretë, gjinia e foshnjës është e përcaktuar. Pjesët e trurit janë formuar. Në fund të muajit të tetë, praktikisht të gjitha pjesët e trupit të foshnjës janë formuar.




dërguar informata kimike dhe llogarit se organe të ndryshme në trup janë të afta të pranojnë këtë informat kimike.

Sigurisht se nuk mund të thuhet se një grumbull qelizash ka këto informata të jashtëzakonshme dhe sajon një plan në bazë të atyre. Është një fuqi supreme që i bën këto qeliza të kryejnë këto funksione të mrekullueshme dhe i krijon ato në atë mënyrë që iu mundson atyre të bëjnë punën e tyre. Kjo fuqi i takon Zotit, Sundimtarit të vetëm të qiejve dhe tokës. Si dëshmi për neve për fuqin e Tij të patundëshme, Zoti ka inspiruar qelizat e gjalla, të pavetëdijshme, mikroskopike, në atë mënyrë që t'a kryejnë detyrën e tyre komplekse në mënyrë perfekte që mendja e njeriut nuk mund t'a kap.

Grumbulli i Qelizave Fillon të Lëviz

Grumbulli i qelizave lëviz në drejtim të vendit të sigurt të përgatitur për të dhe vazhdon me ndarje nga dita në ditë. Në çdo 30 orë një ndarje ndodh. Duke u ndarë në 2, 4, 8, 16, qelizat gradualisht formojnë grumbullin (togun); duke lëvizur së bashku me spermatozoidet e pasuksesshme, shkon ngadal nga tubi fallopian drejt mitrës.


Sikur t'a zmadhoni tubën fallopiane në të do të shikoni pamje që paraqitet në fund të oqeanit. Grumbulli i qelizave vazhdon rrugën e tij për shkak të lëvizjes së valëzuar në tubën fallopiane. Kjo lëvizje, e cila ka siguruar fekundimin e vezës me shtyerjen e spermatozoidit në drejtim të saj, kësaj radhe bart vezën për në mitër. Qime të vogla (silia) që gjenden në sipërfaqen e qelizave të tubës fallopiane lëvizin në të njëjtin drejtim. Në këtë mënyrë, ato bartin vezën sikur të ishin duke bartur një objekt shumë të çmuar, në drejtim të vendit ku duhet të shkoj.



Pamja e jashtme e masës së qelizave të formuara nga ndarja e qelizës duket si një pjesë mishi.

Këtu, sikur të gjitha elementet e përfshira në këtë funksion kanë pranuar një urdhër nga një qendër e përbashkët dhe ato fillojnë përnjëherë të punojnë për qëllimin e njejtë. Ky urdhër është i atillë që çdo vend i ndryshëm i trupit e kupton dhe e zbaton.

Derisa grumbulli i qelizave është në tubën fallopiane ai kalon nëpër një numër të fazave të ndarjes. Grumbulli me rreth 100 qeliza hyn në mitër. Por në mënyrë që të bëhet ndarja, qelizat duhet të ushqehen. Kjo kërkesë duhet të konsiderohet si një aspekt i rëndësishëm i mrekullisë së krijimit të njeriut. Zoti e ka krijuar tubën fallopiane në atë mënyrë që t'i përgjigjet nevojave të zigotit. Në këtë periudhë të pritjes, qelizat tajitëse alternojnë me qelizat e



Kur shikojmë lëvizjen në tubën fallopiane, kemi përshtypjen se jemi duke shikuar në fund të një oqeani (fotoja e vogël). Këto qime të imëta në tubën fallopiane (lart) bëjnë lëvizje të valëzuar, e cila ndihmon vezën të lëviz në drejtim të mitrës.

vogla në formë të qimeve që shtresojnë (veshin përbrenda) tubën fallopiane. Qelizat tajitëse prodhojnë sasi të mëdha të sekrecionit (lëngut) mes tjerash molekula organike, jone dhe ujë për ushqyeshmërin e zigotit.²⁴

'...mitra rritet në madhësi për të mbrojtur embrionin. Tubat fallopiane bëjnë atë që është e nevojshme për të ushqyer qelizat...' Me këto fjali deri këtu kemi folur rreth indeve dhe organeve të cilat e mbrojnë grumbullin e qelizave të formuara pas bashkimit të vezës dhe spermatozoidit, për masat e duhura që të sigurohet ushqyeshmëria dhe për punën për të strehuar këto qeliza. Nuk duhet të harrojmë se këto organe dhe inde po ashtu janë të komponuara nga qelizat. Kështu që, si ka mundësi që një qelizë mund të ndiej nevojën e tjetrës dhe saktësisht në kohën e duhur, të bëj ndryshimet e nevojshme për të ushqyer dhe mbrojtur atë?

Kur shtrojmë këtë pyetje, përgjigja e parë që vjen në mendje do të jetë se këtu ka një inteligjencë që kontrollon qelizat. Askush nuk do të mendojë për një përrallë në të cilën 'një ditë qelizat fillojnë të bëjnë një ndryshim rastësisht dhe pastaj këto qeliza disi bëhen të afta për të prodhuar ushqim që i nevojitet zigotit, dhe pastaj vazhdojnë t'i mbajnë këto dukuri mahnitëse që ndodhin në të gjitha femrat.' Është e qartë se kushdo që bën një pohim të tillë do të akuzohej për trillim. Përgatitjet që mitra i bën për të strehuar embrionin dhe karakteristikat e veçanta të tubave fallopian të cilët mundësojnë furnizimin me ushqim për zigotin, janë veprime të cilat ekzistojnë vetëm në njohurin e Zotit. Secila nga këto gjëra është një manifestim i bekimit dhe mëshirës që Zoti ka për çdo gjë të gjallë të krijimit të Tij perfekt.

Grumbulli i Qelizave Ngjitet në Mitër

Që shtatzënia të vazhdojë në mënyrë të shëndetshme, grumbulli i qelizave duhet të gjejë një vend të duhur që të banoj. Duhet të zgjedhet një vend që ofron mbrojtje dhe t'i ketë karakteristikat që të ndihmoj lindjen pas nëntë muajve. Përveç kësaj, ky vend duhet po ashtu të jetë afër enëve të gjakut të nënës të cilat do të furnizojnë foshnjën me ushqim. Vendi më i përshtatshëm për këtë gjë është muri i mitrës.

Mitra: Një Strehë e Sigurt e Krijuar për Embrionin




Mitra është një organ muskulator i zbrazët që peshon rreth 50 gram. Natyrisht që nuk është mjaft e madhe për foshnjën që të zhvillohet në të. Prandaj, struktura e mitrës duhet të pësoj një transformacion. Gjatë shtatzënisë, mitra rritet gradualisht, duke arritur rreth 1.100 gram në fund të shtatzënisë.

Për shkak të kësaj karakteristike, mitra realizon kushtet më të përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e vezës së fekunduar dhe për daljen e një njeriu komplet të formuar. Përveç kësaj, duke qenë saktësisht në qendër të zgavrës të komblikut të nënës, ajo e strehon foshnjën dhe e mbrohet në rrjedhën e zhvillimit të saj.²⁵

Në Kur'an Zoti paraqet cilësinë mbrojtëse të mitrës së nënës dhe na përkujton edhe njëherë për mëshirën e Tij për njerëzimin:


Ne krijuam njeriun nga balta më e pastër; pastaj vendosëm atë, një perlë e gjallë, në një vend të sigurt. (Kur'an, 23: 12-13)



Grumbulli i qelizave, që përparon në drejtim të mitrës nga tuba fallopiane, lëviz me vetëdije për atë se çka është duke bërë. Qëndron në tubën fallopiane për 3-4 ditë por nuk përpiqet të ndalet apo të strehohet në ndonjë vend aty. E di se para se të arrij në mitër, asnjë vend në të cilin do t'a ngjiste veten nuk do t'a pranonte apo lejonte të mbijetonte. Vazhdon në drejtim të mitrës, e gjen në muret e mitrës një vend ku enët e gjakut janë të bollshme dhe strehohet aty. Sikur një farë e mbjellur në tokë që i nxjerr dhe i shtrin rrënjët e saj, ashtu dhe grumbulli i qelizave (zigoti) vazhdon të rritet dhe lëvizë thellë në inde të cilat do të ushqejnë atë, për veten ai prodhon kanale të reja për këtë ushqim.

Këtu është e dobishme të përmendet një pikë e rëndësishme. Është mrekulli që një grumbull qelizash është në gjendje të zgjedh vendin më të përshtatshëm për të vendosur veten. Në librin e tij, *Fillimi i Jetës*, G. Flanagan po ashtu pyet 'Si grumbulli bën një zgjedhje të tillë 'të kujdesshme' mahnitëse?'²⁶

Pika në të cilën Flanagan tërheq vërejtjen është shumë e rëndësishme. Në mënyrë që të ilustrojmë këtë pikë të rëndësishme, le të marrim së pari një shembull. Imagjinoni një foshnje që është sapo ka filluar të ecë. Vendoseni këtë foshnje në një ndërtesë që është miliona herë më e madhe se sa ajo, dhe në të cilën nuk ka qenë kurrë më parë; pastaj prisni që kjo foshnje të zgjedh për vete dhomën me ambientin më të përshtatshëm në këtë ndërtesë. A mundet një foshnje të bëjë një gjë të tillë?



*Thuaj: ' A të kërkoj Zot tjetër pos All-llahut, kur Ai është
Zoti i të gjitha gjërave?' Atë që bën secili e ka për vete.
Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit. Në fund ju do të
ktheheni te Zoti i juaj, dhe Ai do t'i zgjidh për ju përçarjet
e juaja. (Kur'an, 6: 164)*

Një embrion i struktur në mitër



Sigurisht që jo. Nëse ky veprim është i pamundur për një foshnje që nuk e ka arritur moshën që të përdorë aftësitë mendore, dmth që nuk ka përvojë e njohuri të mjaftueshme, aq më shumë është e pamundur për një masë mishi, me disa centimetra, që të lëviz në errësirën e një trupi, e të gjej për vetveten vendin më të përshtatshëm, më të rehatshëm dhe më të sigurt?

Përveç kësaj, ky grumbull qelizash nuk është ende qenie njerëzore. Kujtojmë që, ajo së cilës i referohemi këtu është një masë mishi e përbërë (për momentin) nga disa qindra qeliza, pa veshë, sy, tru, duar apo krahë. Por kjo masë qelizore, duke demonstruar një aftësi njohëse të veçantë, strehon veten në mitër në vendin më të përshtatshëm për vetveten.

Mrekullitë e krijimit të njeriut nuk ndalen këtu. Në çdo fazë të formimit të qenies njerëzore është një zinxhir i mrekullueshëm i dukurive mahnitëse. Kemi folur se si veza e fekunduar shumohet dhe se si e gjen vendin e nevojshëm për zhvillimin e saj. Në këtë fazë, një pyetje tjetër e rëndësishme lind: Ky grumbull qelizash, i përbërë nga qelizat plotësisht të ngajshme me njëra tjetrën, nuk ka një spirancë apo ndonjë organ tjetër të ngajshëm që t'ia bëj të mundur kapjen në një vend. Pra, si është e mundur të ngjitet në murin e mitrës?

Mënyra se si grumbulli i qelizave ngjet veten në murin e mitrës është një pjesë interesante dhe tejet komplekse e sistemit. Qelizat në shtresën e jashtme të grumbullit të qelizave sekretojnë (tajisin) një enzim që quhet hialuronidaza. Tipari i veçantë i këtij enzimi (siç kemi përmendur më herët në rastin e spermatozoidit) është aftësia për të zbrërthyer shtresën e acidit (acidin hialuronik) në indet e murit të mitrës. Kjo ju mundëson qelizave që përbëjnë grumbullin e qelizave (zigotin) të tretin indin e mitrës dhe të depërtojnë në mitër. Disa qeliza në grumbullin e qelizave tretin qelizat e mitrës, depërtojnë më thellë dhe ngulitin veten mirë në mur.

Ashtu siç përmendëm dhe më lart, fakti që një masë qelizash ka aftësi të zgjedh vendin më të përshtatshëm për veten dhe vendos se është e nevojshme të ngjitet në atë vend mbetet një diçka vërtet mahnitëse. Me sjelljen e vet, ky grumbull i vockël i qelizave paraqet aftësinë e llogaritjes së nevojave të veta dhe veprimin sipas kësaj llogaritje. Akoma më mahnitëse është që e di si të bëj këtë ngjitje dhe që disa qeliza e kanë këtë aftësi të veçantë.



Me ndihmën e tubës fallopiane, një grumbull qelizash (blastocisti) arrin në mitër dhe strehohet aty. Është trup i rrumbullakët pa grep apo ndonjë mekanizëm tjetër ngjitës dhe është një mrekulli e krijimit që është i aftë të ngjes vehten në mitër. Ajo që ia lejon embrionit t'ia dal me këtë është një enzim që sekretohet prej qelizave në shtresën e jashtme të tij (trofoblastet).

Sigurisht që është e pamundur që këto qeliza, duke përdorur intelgjencën dhe vullnetin e tyre, të analizojnë acidin hyaluronik në murin e mitrës dhe të fillojnë sekretimin (tajtjen) e enzimit hialuronidaza i cili do t'ia tret atë.

Siç shpjeguem më herët, nëse një person nuk ka përgatitje të posaçme në kimi, nuk di të jep një sqarim për këtë. Por, disa qeliza kanë këtë informat kimike dhe e përdorin atë për të kryer funksione vitale në prodhimin e asaj

që nevojitet për ekzistencën e tyre. Ky funksion i jashtëzakonshëm zbatohet jo vetëm nga një qelizë e vetme, por nga qelizat që kanë formuar çdo njeri në të kaluarën dhe të tashmen.

Siç po shihet nga ajo që kemi thënë, në formimin e grumbullit të qelizave të cilat do të formojnë embrionin më vonë dhe në ndryshimet që pësojnë qelizat që e strehojnë atë, vepron një plan i caktuar dhe i vetëdijshëm. Saktësisht në kohën e duhur, qelizat që përbëjnë tubin fallopian pësojnë një ndryshim dhe në momentin e përpiktë qelizat që e rrethojnë sipërfaqen e grumbullit të qelizave fillojnë të sekretojnë një enzim (hialuronidazën).

Ky plan i vetëdijshëm tregon se këto funksione që ndodhin në trupin e njeriut janë të kontrolluara nga një inteligjencë superiore.

Është Ai I Cili ju formon në mitër ashtu siç Ai dëshiron. Nuk ka Zot tjetër përveç Atij, I Plotëfuqishmi, I Gjithdijshmi. (Kur'an, 3:6)

Qelizat që Kryejnë Funksione të Ndryshme

Në ditën e tetë, qelizat fillojnë të diferencohen (të dallohen) dhe ato organizohen në dy grupe të ndryshme, në atë të jashtëm dhe atë të brendshëm. Masa e brendshme (embrioblasti), formon qelizat të cilat embrioni do t'i mbart gjatë gjithë jetës së tij. Grupi i jashtëm i qelizave (trofoblast), përbëhet nga qelizat të cilat ndihmojnë njeriun në fazën e jetës së tij që zhvillohet në mitrën e nënës d.m.th. gjatë periudhës nëntë mujore e deri në lindjen e tij.

Masa e qelizave të brendshme ndan veten nga grupi i jashtëm i qelizave të cilat do të shërbejnë për nëntë muajt. Regjioni i mbetur do të bëhet kordon umbilikal që do të ofrojë lidhjen në mes të embrionit dhe placentës e cila do të zhvillohet më vonë.


Në të njëjtën kohë që fillon të zhvillohet placenta, masa e qelizave të brendshme rrafshohet dhe zhvillohet në tri shtresa të qelizave që quhet 'disku embrionik'. Tre llojet e shtresave të qelizave janë ektoderma, mesoderma dhe endoderma. Në një proces të quajtur diferencim, qelizat nga secila shtresë lëvizin në fusha të caktuara të diskut embrionik dhe pastaj palosen për të formuar tuba dhe grumbuj (togje). Këta tuba dhe grumbuj zhvillohen në inde dhe organe të ndryshme të trupit.²⁷

Ngjitja e Embrionit në Mitër është një Mrekulli e Kur'anit

Kur i shqyrtojmë vargjet e Kur'anit që kanë të bëjnë me ngjitjen e embrionit në mitër, kuptojmë njërën nga mrekullit më të mëdha të Kur'anit. Në Kur'an, kur i referohet ngjitjes së embrionit në mitër dhe fillimit të zhvillimit të tij, Zoti përdor fjalën 'alaq':


Lexo me emrin e Zotit tënd I Cili krijoi njeriun nga gjaku i ngjizur (alaq). Lexo: Dhe Zoti i juaj është më Bujari. (Kur'an, 96: 1-3)

Fjala 'alaq' në gjuhën arabe d.m.th. 'diçka që kacavirret, një substancë sikur shushunja'. Kur'ani na ka ardhur 1400 vite më parë dhe fakti që Zoti përdor këtë fjalë për të përshkruar zhvillimin e embrionit në mitrën e nënës është një nga mrekullit e tij. Fakti që kjo njohuri, e cila nuk ka mundur të zbulohet nga shkenca e asaj periudhe, e shpallur në Kur'an shekuj më parë konfirmon përsëri se Kur'ani është shpallje nga Zoti, Sunduesi i të gjitha botërave.



INë foton e parë, shofim qelizën-grumbull (tufëzën) duke kërkuar vendin në mitër. Mbas gjetjes së vendit të përshtatshëm, tufëza tret indin e murit të mitrës dhe e ngulit veten. (2-3). Embrioni e ngjet veten mirë për murin e mitrës dhe fillon të marr nga aty oksigjenin dhe ushqimet e tjera që i nevojiten. (4)

Pamja e qelizës vezë të
fekunduar në ditën e tetë




*A i bëjnë zotëra gjërat që nuk mund të krijojnë asgjë dhe vet
(ato gjëra) janë të krijuara; që nuk janë në gjendje t'iu
ndihmojnë atyre dhe as që mund t'i ndihmojnë vetvetës?
(Kur'an, 7: 191-192)*

Qelizat e shtresës më të jashtme (ektodermës) formojnë trurin, palcën kurrizore, organet shqisore dhe lentet e syrit. Përveç kësaj, kjo shtresë do të formojë edhe epidermën, gjëndrrat e djersës, smaltin e dhëmbëve, qimet dhe thonjtë. Shtresa më e brendshme e embrionit (endoderma) do të sjell zhvillimin e organeve që përbëjnë sistemin e tretjes dhe të frymëmarrjes (mëlçin, mushkëritë, pankreasin, etj) dhe gjëndrrat relevante (tiroidea, timusi, etj.) Shtresa e tretë (mesoderma) është e formuar në mes të këtyre dy shtresave. Nga kjo shtresë formohen zemra, muskujt, veshkët, gjëndrrat, enët e gjakut dhe organet riprodhuese. Enët limfatike dhe epiteli (sipërfaqja, ose shtresa mbështjellese e brendshme, indet) që mbulojnë sipërfaqën më të madhe të brendshme dhe të jashtme të trupit dhe organet e tij zhvillohen nga kjo shtresë. Qelizat që përbëjnë të gjitha indet e trupit janë të formuara nga këto qeliza të cilat zhvillohen prej njëres nga këto shtresa.

Është shumë me rëndësi të mendojmë për domethënjën e fjalisë së fundit në paragrafin më lart, dhe të shqyrtohet mirë kuptimi i asaj se çfarë është thënë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të kuptojmë zhvillimin e jashtëzakonshëm të qenies njerëzore. Fakti se të gjitha elementet që përbëjnë trupin e njeriut (organet, indet, sistemet, enët e gjakut, etj.) zhvillohen nga tre lloje shtresash që përbëjnë embrionin na shtyn të mendojmë se nga e marrin qelizat këtë inteligjencë supreme për të vepruar?

Ndërkohë, janë disa detaje të cilave ju duhet kushtuar vëmendje sepse janë pikërisht këto detaje që i bëjnë këto ndryshime akoma më të jashtëzakonshme. P.sh. në rrjedhën e zhvillimit të një qenie njerëzore ekziston një harmoni perfekte ndërmjet këtyre tre shtresave. Për prodhimin afërsisht të 200 llojeve të qelizave të trupit të njeriut nga tre lloje qelizash, nevojitet një renditje dhe kordinim i saktë. P.sh. rendi i ngjarjeve në diferencimin e qelizave të gjakut dhe qelizave të lëkurës është shumë i ndryshëm në secilin rast.




Nga qeliza bazë vijën të gjitha përafërsisht 200 llojet e qelizave të trupit të njeriut. (1) Qelizat bazë papritmas fillojnë të ndryshojnë (diferencohen) nga qelizat e tjera. Me këtë ndryshim (modifikim), formohen indet e trupit nga qelizat bazë. Qelizat yndyrore të cilat sigurojnë energji (2), qelizat të cilat shërojnë plagët (3) dhe qelizat e enëve të gjakut (4) janë disa nga këto inde.


Aktiviteti i Planifikuar i Qelizave që i Japin

Formë Trupit: Si Ndodh?

Tash grumbulli i qelizave është bërë një embrion. Sikur të mund t'i shikojmë qelizat gjatë kësaj periudhe, do të vërenim një aktivitet të madh. Qelizat të ngjajshme njëra me tjetrën ndahen dhe shumohen në kohë të caktuar dhe disa nga këto qeliza fillojnë të marrin strukturë tjetër nga qelizat e tjera. Ky proces nuk dallohet në fillim, mirëpo me çdo ditë që kalon, bëhet më e qartë se qëllimi i këtij aktiviteti është të vijë në ekzistencë, shpejt dhe sipas një plani, funksionet e domosdoshme për ndërtimin e trupit të njeriut. Të gjitha qelizat, shumë të ngjajshme me punëtorët e caktuar në një punë, shkojnë të punojnë në grupe. Më vonë, grupet e qelizave të cilat janë për të formuar organin e njejtë bashkohen njëra me tjetrën dhe formojnë një masë



(a) pamja e brendshme, rreth ditës së 14 pas fekondimit



(b) pamja e jashtme, rreth ditës së 25 pas fekondimit

Ndryshimet në mitër fillojnë me fekondimin dhe ajo bëhet një vend ku foshnja do të kalojë nëntë muaj në siguri dhe rehati. Mitra rritet në madhësi dhe ofron strehë mbrojtëse për embrionin. Të gjitha përgatitjet bëhen nga qelizat në mitër. Fakti që këto qeliza janë në dijeni për atë se çfarë ka nevojë qeliza tjetër, ka vetëm një sqarim, këto qeliza lëvizin sipas inspirimit të Zotit të Madhërishtëm.

dhe përgatiten për të formuar organet. Si rezultat i këtij aktiviteti intensiv, disa qeliza do të bëhen qeliza të eshtrave, ndërsa të tjerat do të bëhen qeliza të lëkurës dhe muskujve.²⁸


Qelizat e eshtrave mblidhen në vendet ku duhet të jenë eshtrat. Qelizat e muskujve grumbullohen në vendet ku duhet të jenë muskujt. Disa qeliza shkojnë edhe në vende më të thella dhe fillojnë të formojnë organet e brendshme. Disa formojnë trurin, disa sytë dhe të tjerat enët e gjakut. Me kohë, shtohen proceset e reja: p.sh. lëvizja e qelizave në vendet e tyre të caktuara dhe ndërtimi i disa organeve me vdekjen e programuar të qelizave të caktuara, etj. Shkurt, në rrjedhën e diferencimit, një strategji perfekte zbatohet ku qelizat kryejnë aktivitetin e tyre sipas një plani të qartë.

Inspirimi se si duhet të bëhet kjo përgatitje ju është njoftuar në mënyrë të veçantë secilit grup të qelizave. Informata e shkruar në ADN-në e çdo qelizë është e njejtë. Mirëpo vetëm kur çdo grup i qelizave përdor këtë informatë në programin i cili është vendosur brenda kufijëve të instiktit të tyre, ato mund të formojnë ndërtime të posaçme të nevojshme për organet që të kryejnë funksionet e tyre. Përveç këtij diferencimi, ndarja konstante bën që numri i tyre të rritet. Ky organizim perfekt nuk bie kurrë në anarki. Për shkak të këtyre përgatitjeve të bëra për formimin e zemrës, syrit, trurit, krahut, këmbës dhe organeve të tjera, trupi ngadal merr formë.²⁹

Mirë pra, por kush iu jep urdhërin këtyre qelizave të cilat të gjitha dalin nga një esencë e vetme? Si munden qelizat, të cilat nuk kanë intelegjencë, dije apo ndjenja, të kuptojnë këtë urdhër dhe t'a zbatojnë atë?

Shkencëtarët kanë ardhur në përfundim se plani që dikton diferencimin e qelizave dhe vendosjen e tyre në vendin e duhur në trup është i shkruar në ADN. Por kjo nxit një pyetje: Kush shkroi këtë plan madhështor aq perfekt në këtë bankë të dhënash mikroskopike të fshehur në bërthamën e qelizave?

Gjithashtu, kush bën që qelizat të lexojnë këtë plan të shkruar në ADN dhe t'a zbatojnë atë pa gabime? Si ndodh që miliona qeliza të ndryshme gjejnë informatën e përshtatshme për vetveten në një bankë të pafund informatash në ADN dhe ndryshojnë strukturën në bazë të saj?



Në fazat e para të lindjes, qelizat kopjet e veta i bëjnë identike. Ky shumim sikur të mos kontrollohej, njeriu nuk do të formohej; mirëpo, një copë e madhe mishi e përbërë nga qelizat identike do të ishte rezultati. Por kjo nuk ndodh. Qelizat identike fillojnë të ndryshojnë (diferencohen). Si rezultat i këtij ndryshimi, eshtrat, muskujt e lëmuar, epiteliumi, mëlçia, mushkëritë, shkurt, të gjitha qelizat dhe indet e trupit formohen. Sigurisht se kjo është dituria dhe fuqia e pakrahasueshme e Zotit që sjell këto transformime të mrekullueshme në qeliza dhe bën që prezenca e këtyre elementeve të veçanta t'a bëjnë njeriun njeri.

P.sh. mendo për qelizat të cilat formojnë sytë: Si e dijnë ato se kur bebëza është formuar plotësisht? Si e dijnë ato si të ndërtojnë strukturën e retinës, muskujve të syrit, lentet dhe si ia japin atyre madhësinë e duhur? Dhe si e dijnë ato se në cilën kohë duhet të ndalin këto procese?

Apo, si i dijnë qelizat që kurrë nuk i kanë parë mëlcinë, veshkët apo pankreasin tiparet e këtyre organeve dhe ndryshojnë strukturën e tyre në përputhje me këtë njohuri?

Gjithashtu, kur këto qeliza ndryshojnë strukturën e tyre në bazë të organeve të cilat do t'i formojnë, ato marrin në konsideratë shumë faktorë. P.sh. një qelizë e cila ndryshohet për t'u bërë qelizë e trurit duhet të kujdeset për sistemin nervor, ushqimin e trurit, furnizimin me oksigjen, nevojshmërinë e themelimit të lidhjeve në mes të të gjithë nervave të trupit, duhet të dallojë pjesët e trurit që shikojnë, dëgjojnë dhe ndiejnë. Qelizat e tjera marrin në konsideratë mundësin që truri mund të dëmtohet dhe e rrethojnë atë; ato i vlerësojnë faktorët negativ që mund të ndodhin gjatë procesit të lindjes kështu që formojnë strukturën në funksion të këtyre faktorëve. E gjithë kjo duket shumë mirë, por si mundën qelizat të paraqesin 'parashikim' të tillë në veprimin e tyre?

Të gjitha këto pyetje tregojnë se lindja e njeriut është një mrekulli e vërtet, dhe teoria e evolucionit në këtë pikë ka arritur në një rrugë pa krye. Asnjë evolucionist nuk mund të shpjegoj këtë bashkëpunim të jashtëzakonshëm që ndodh në mes gjeneve të ADN-së derisa qelizat formojnë organet dhe i japin formë trupit. Fakti që gjenet, të cilat i kemi përkufizuar si grumbull i atomeve pa dije, nuk mund të organizojnë rastësisht një harmoni kaq të vetëdijshme është aq e qartë sa që evolucionistët në përgjithësi preferojnë që të mos shtjellohet kjo temë fare.

Hoimar von Ditfurth, një shkencëtar evolucionist gjerman, ka këtë thënie rreth zhvillimit të mrekullueshëm që ndodh në mitrën e nënës:

'Fakti që një qelizë vezë e vetme ndahet që të formojë aq shumë qeliza të ndryshme, komunikimi perfekt natyral dhe bashkëpunimi në mes të këtyre qelizave kryeson ngjarjet që mahnisin shkencëtarët.'³⁰

Dhe G. Flanagan, autor i Fillimi i Jetës shkruan:

‘Si është arritur një organizim i tillë kaq i lartë? Çfarë i bën qelizat të veprojnë sikur dijnë se ku shkojnë, çfarë të jenë dhe çka të bëjnë kur të arrijnë atje? Dhe po ashtu të veprojnë në harmoni të tillë me qelizat partnere?’³¹

Flanagan është përpjekur t’i jap përgjigje këtyre pyetjeve, por ai është larg për të qenë i aftë që të shpejtoj këto ndodhi të mahnitshme.

‘Këto pyetje të mëdha na dërgojnë në një botë jashtëzakonisht të vogël të molekulave të vogla brenda qelizës, së pari tek ato që përbëjnë gjenet dhe formojnë programin gjenetik. Me arritjen e biologjisë molekulare, për të parën herë është duke u mundësuar zbulimi dhe qartësimi i këtyre proceseve. ‘Dukej se, libri i jetës u hap papritmas...’, megjithëse



qeliza e pankerasit



qeliza e zemrës



qeliza e gjakut



qeliza e mushkërisë



qeliza e vezë



qeliza e eshtrave



qeliza e veshkës



qeliza e muskulit



qeliza e trurit



qeliza e mëlçisë

Lart shofim disa nga llojet e qelizave të trupit. Në trup formohen përafërsisht 200 lloje të qelizave si rezultat i shumimit të qelizave që fillimisht janë identike. Përkundër faktit se informata e shkruar në ADN është e njëjtë, secila qelizë përdor vetëm informatën që i duhet asaj. Nuk paraqitet asnjë hutim. Qelizat e eshtrave asnjëherë nuk përipiqen të formojnë një sy apo ndonjë organ tjetër; qelizat nervore nuk ndërhyjnë me qelizat e kuqe të gjakut. Secila e di shumë mirë ku dhe si do të funksionoj. Është Zoti I Madhërishtëm, Sunduesi i të gjithave, Ai që garanton këtë organizim pa të meta dhe i inspiron qelizat e trupit për atë çfarë duhet bërë.

vetëm disa faqe magjepëse të tij. Ne jemi ende larg nga të kuptuarit e tërë tregimit. Është e qartë se qelizat punojnë së bashku aq mirë për shkak të ekzistimit të dialogut të vazhdueshëm në mes tyre dhe ato pranojnë udhëzimet e brendshme gjenetike në përputhje me rrethanat. Udhëzimet mbahen në gjene në formë të të ashtuquajturit kod-gjenetik, të radhitura me organizim të molekulave, ashtu si shkronjat e një alfabeti të veçantë. Programi gjenetik për foshnjën, i radhitur në atë kod, arrihet në ditën e parë të bashkimit të qelizave të prindërve. Prej aty e më tutje, çdoherë që ndonjë qelizë ndahet dhe jep dy qeliza

të reja, bëhet një kopje e përpiktë e të gjitha gjeneve dhe i transmetohet qelizës së re. Kështu që çdo qelizë e trupit bart saktësisht të njejtat gjene, dhe mban programin gjenetik të plotë. Sikur i tërë programi të ishte aktiv gjatë gjithë kohës, çdo qelizë thjeshtë mund të prodhonte klonime (kopje identike) të vetvetës, të gjitha me destinacion dhe funksion të njejtë. Ajo që bën të mundur prodhimin e shumëllojshëm të qelizave si dhe shpërndarjen e tyre në drejtime të ndryshme është fakti që gjenet kyqen dhe ç'kyqen pra, nuk janë aktive gjatë gjithë kohës. Kjo ndodh në përgjigje të sinjaleve që vijnë nga qelizat partnere pasiqë ato të gjitha përshtatin veten në programin e hollësishëm të zhvillimit. Këto ndodhi mund të krahasohen me një detyrë të vështirë ndërtimi që kërkon bashkëpunim të ngushtë. Secili e di planin kryesor, secili jep sinjale, dhe ju përgjigjet në mënyrë të ndjeshme sinjaleve të të tjerëve që të bëhet pjesë e pandarë e tërë projektit. Qelizat e embrionit punojnë në një mënyrë të krahasueshme, në një marrëveshje të shoqërueshme me gjenet të cilat kyqen dhe ç'kyqen sipas nevojës.”³²

Siç kuptojmë nga sqarimet e mësipërme, fakti që qelizat dallohen nga njëra tjetra dhe marrin funksione plotësisht të ndryshme dëshmon se aty

*Është All-llahu Ai që krijoi shtatë qiejtë dhe tokën në të njejtin numër, Urdhëri I Tij zbret te secila, që të dini se Zoti ka fuqi mbi të gjitha gjërat dhe që Zoti përfshin të gjitha gjërat në diturinë e Tij.
(Kur'an, 65: 12)*

ka një 'program gjenetik' i cili bën që ato të veprojnë brenda një plani të përcaktuar. Është e vërtetë se një program perfekt është ngulitur në çdo qelizë, por gjëja e rëndësishme është kjo: Kush e krijoi këtë program dhe e nguliti atë në qelizë? Programi për të cilin bëjmë fjalë nuk është një program i thjeshtë kompjuteri. Me përdorimin e këtij programi qelizat sjellin në ekzistencë njeriun i cili në vetvete ka miliona ndërtime organike të ndërlikuara e të ndërlydhura: një person që mund të dëgjoj, të shikoj, të ndiej, të mendojë, të marr vendime, të përjetoj kënaqësi, të çmoj bukurinë, që mund të studiojë qelizat e veta dhe ADN-në, dhe të sjell përfundime nga hulumtimet e veta. Përveç kësaj, sigurisht që është një mrekulli që masat e proteinave të cilat ne i quajmë qeliza, kuptojnë një program të tillë, veprojnë sipas tij, vihen në dijeni për atë që kërkohet dhe kompletojnë çdo fazë në mënyrë perfekte.

Richard Dawkins, evolucionist bashkëkohor i njohur, nuk mund të jep sqarim se si gjenet të cilat përmbajnë programin gjenetik të njeriut veprojnë së bashku në një shkallë të tillë të bashkëpunimit në formimin e njeriut.

Zhvillimi embrionik është i kontrolluar nga një rrjet i ndërthurur raportesh të ndërlikuara të pa imagjinueshme.³³

Dawkins ka kuptuar se raportet në mes të gjeneve përgjegjëse për krijimin e mrekullueshëm të njeriut dhe aftësitë e jashtëzakonshme të demonstruara nga gjenet nuk mund të kenë ardhur nga rastësia, sepse është e pamundur të shpjegohet një sistem kaq i ndërlikuar me mekanizmat e evolucionit, si rrjedhim ka bërë një pohim të tillë. Mirëpo, ai prapë lëshon një pikë të rëndësishme: Në të njejtën mënyrë është e pamundur që në zinxhirin e mrekullive të prodhimit të foshnjës, të ketë ardhur në ekzistencë nga rastësia ndonjë grimcë e nevojshme për krijimin e foshnjës, apo ndonjë qelizë e vetme. Brenda një periudhe prej nëntë muajsh, një qelizë e formuar në organet riprodhuese të nënës shndërrohet në qenie njerëzore që dëgjon, ndjenë, merr frymë, mendon dhe ky transformim në çdo detaj ndodh sipas një plani perfekt. Përveç kësaj, kjo mrekulli ndodh vazhdimisht me perfeksionin e njejtë për vite të panumërta.

Sipas pohimeve të evolucionistëve, tërë kjo ndodh nga rastësia; për ata, kjo mrekulli vjen si rezultat i vendimit të atomeve pa vetëdije të cilat prodhojnë qelizat e njeriut. Ata pohojnë se një ditë, atomet papritmas vendosën të

Qelizat i Japin Formë Trupit...



Fazat në formimin e njeriut përbëjnë një zinxhir mrekullish. Qelizat duke u bashkuar sipas një rregulli të caktuar i japin formë trupit. Ato ndërtojnë duartë, sytë, veshët, enët e gjakut, këmbët, zemrën, trurin, dhe qelizat nervore. ADN-ja e secilës qelizë përmban sasi gjigante informatash që kanë të bëjnë me çdo detaj të trupit të njeriut. Mirëpo qelizat në embrion në mesin e gjithë kësaj informate gjejnë dhe lexojnë atë e cila i takon organit të tyre të posaçëm. Në bazë të kësaj informate, qelizat ndërtojnë organet dhe indet. Si një qelizë është në gjendje të interpretojë informatën në ADN është diçka e vlefshme për t'u menduar. Kush e shkroi informatën në ADN e cila gjendet në bërthamën e qelizës? Kush i programoi qelizat në atë mënyrë që ato të lexojnë këtë informatë sikur një njeri dhe të veprojnë sipas saj? Në këtë pyetje është vetëm një përgjigje: Zoti krijoi njeriun në mënyrë perfekte. Është Ai i Cili i inspiron qelizat se çfarë duhet bërë.

bashkohen dhe prodhojnë organe të cilat ata nuk i kishin parë apo njohur më parë. Ata kapen aq verbërisht në pohimet e tyre të palogjikshme sa që besojnë se secila nga këto atome të pa vetëdijshme vendos se cilën pjesë do t'a formojë dhe shkojnë në vendet e duhura sipas këtij vendimi. Ata besojnë se çdo gjë ndodh pa ndërhyrje si rezultat i rastësisë: se qelizat dhe atomet vendosin nga vullneti i tyre që të ndërmarrin veprimin më të mirë, dhe ndërtojnë një trup njeriu në mënyrë perfekte. Edhe nëse ata nuk dëshirojnë të pranojnë atë që është thënë këtu, kjo është saktësisht përmbajtja e asaj që pohojnë ata.

Në këtë pikë është e qartë se përballë një logjike tejet të madhe evolucionistët gjejnë vetveten në një gjendje pa rrugëdalje.

Çdo detaj i shpjeguar deri këtu dhe ajo me të cilën do të mirremi më vonë, në kundërshtim me atë që pohojnë evolucionistët, tregon se fazat që ndodhin në formimin e njeriut nuk mund të ndodhin nga rastësia. Këto gjëra të jashtëzakonshme ndodhin jo nga puna e qelizave apo organeleve që i sollën ato në ekzistencë; jo nga aktiviteti i molekulave apo atomeve, por nga fjala e Zotit të Madhërishtëm, "Bëhu":

Ai është I Cili ju krijoi prej toke, pastaj prej një pike sperme, pastaj prej një embrioni, pastaj ju sjell foshnje në botë; ju e arrini pjekurinë, pastaj plakeni megjithëse disa nga ju vdisin të rinjë kështu që arrini moshën e paracaktuar dhe kështu me shpresë që do të rriteni në meçuri (urtësi). Është Ai I Cili cakton jetën dhe vdekjen. Kur ai vendos për diçka, Ai vetëm thotë "Bëhu" dhe ajo bëhet. (Kur'an, 40: 67-68)

Sistemi i Veçantë Mbrojtës i Përgatitur Për Embrionin

Qelizat të cilat ngjiten për mitrën e nënës vazhdojnë të zhvillohen dhe ushqehen në këtë vend të sigurt. Por kjo është një gjë mahnitëse, sepse ky embrion që rritet kaq shpejt ndeshet me rreziqe serioze – sistemin imunologjik të nënës.

Sistemi imunologjik çdo material të huaj që futet në trup e llogaritet si një armik dhe e sulmon atë. Përbërja gjenetike e embrionit është e ndryshme nga ajo e nënës dhe e trupit të saj, është një organizëm i huaj. Në momentin që qelizat e nënës vihen në dijeni të prezencës së këtij organizmi të huaj, ato

Njohuria që Demonstron Qeliza Vezë

Qelizat të cilat bëjnë përgatitje për t'u strehuar në muret e mitrave gjenetikisht janë të ndryshme nga ato të nënës. Pse ato nuk refuzohen sikurse një organ apo ind i transplantuar në trupin e nënës për shumë kohë ka qenë një mister i pazgjidhur. R.Flanagan e shpjegon këtë në këtë mënyrë:


... Tufëza (qeliza grumbull) ndrydh shënuesit e saj gjenetik dhe lëshon sinjale të veçanta që mund të krahasohen me një fjalë kaluese (kod / password) universal. Ky kod është i njejtë për të gjithë njerëzit dhe është i njejtë kod që qelizat e nënës e lëshuan kur ajo ishte tufëz (qelizë grumbull). Për këtë, qelizat e saj nuk mobilizohen tash që të mbrohen kundër arritësit të ri, sepse biologjikisht ato njohin tufëzën çerdhe-ngritëse si mik universal, e jo armik.³⁴

Vëmendje duhet t'i kushtohet këtu një pike shumë të rëndësishme. Sikur që thotë Flanagan, është misterie e madhe se si një grup i qelizave i dërgon një 'mesazh universal' një grupi tjetër të qelizave të cilat e pranojnë këtë mesazh dhe e 'kuptojnë' se ato nuk po takojnë një armik por mik. Duhet të përkujtojmë se nuk jemi duke folur këtu për një grup njerëzish, por për një masë të përbërë nga qelizat aq të vogla që nuk shihen pa mikroskop; një masë e cila nuk ka duar, sy, veshë apo tru, e përbërë nga atomet, molekulat dhe proteinat e pavetëdijshme. Sigurisht se të supozohet se një demonstrim i tillë vjen nga dituria e qelizave është jashtëzakonisht e pa logjikshme.

E vërteta që ballafaqohemi është e qartë: Ajo që i ofron embrionit të strehohet lehtë në mitrën e nënës dhe të mbijetojë është mëshira e Zotit, I Cili krijoi embrionin, nënën dhe sistemin mbrojtës të nënës.

Me të vërtet, Zoti ka dijeni për Orën (e kijametit) dhe lëshon shi tepër dhe e di se çka ka në mitër. Dhe askush nuk e di se çka sjell e nesërmja dhe askush nuk e di se në cilën tokë do të vdes. Zoti është I Gjithëdijshmi, Gjithënjohësi.

(Kur'an, 31: 34)



Qelizat imune të nënës afrohen të shkatërrojnë embrionin. (Iart) Mirëpo, ndërtimi perfekt në trup nuk i lejon ato të dëmtojnë vezës.

nxitojnë në drejtim të mitrës. Sikur të mos ishin ndërmarrur masa paraprake, qelizat mbrojtëse sigurisht se do t'a mbysnin embrionin.

Mirëpo në rrethana fiziologjike nuk ndodh një gjë e tillë, sepse embrioni që nga fillimi është nën mbrojtje të veçantë.

Para se embrioni të ngjes veten në murin e mitrës, qelizat trofoblaste fillojnë të formojnë një sipërfaqë për rreth embrionit, duke formuar një lloj filteri në mes të enëve të gjakut të nënës dhe embrionit. Qelizat imune të nënës janë të paafta që të zbulojnë indet trofoblastike sepse atyre iu mungojnë disa proteina të cilat i kanë shumica e qelizave të tjera dhe ato proteina i ndihmojnë qelizave imune që t'i zbulojnë ato. Duke ju falemnderuar kësaj karakterisike të qelizave trofoblaste, embrioni ruhet nga sulmet e sistemit imunologjik të nënës. Përveç kësaj, disa nga qelizat trofoblaste ndihmojnë që oksigjeni, ushqimi dhe substancat e tjera të nevojshme të arrijnë te embrioni.


Le të shikojmë në detaje ndërtimin e veçantë të këtyre qelizave.

Aftësia Ingjinierike e Qelizave Trofoblaste

Siç shpjeguar në faqet e mëparshme, përkundër faktit se qelizat trofoblaste shumohen nga e njejta qelizë vezë, ato ndahen nga qelizat të cilat formojnë embrionin; ato janë një grup qelizash që kryejn të gjitha aktivitetet ndihmëse në lidhje me zhvillimin e embrionit në mitrën e nënës. Në ditën e shtatë, këto qeliza nxjerrin zgjatje në çdo drejtim dhe fillojnë të rriten. Qëllimi i këtij ndryshimi është të depërtojnë në murin e mitrës. Gjatë këtij depërtimi, ato takohen me enët e gjakut të nënës dhe përshkojnë sipërfaqen e tyre të jashtme. Kështu që, brenda 7-8 ditëve, indi i embrionit lidhet me gjakun e nënës.

Disa qeliza trofoblaste prodhojnë enzime për shkatërrimin e membranës të enëve të gjakut në murin e mitrës. Në këtë mënyrë, shtypja që del nga gjaku i nënës në embrion është e zvogëluar. Qelizat trofoblaste nisen në aksion sikur të ishin në dijeni për rrezikun e brendshëm dhe marrin masat që të parandalojnë çdo gjë që do të rezultonte në vdekjen e embrionit. Sikur këto qeliza të mos bënin një rregullim të tillë në enët e gjakut të nënës, gjaku i

MREKULLIA E KRIJIMIT TË NJERIUT




Qelizat trofoblaste ndahen nga të gjitha qelizat e tjera të cilat formojnë embrionin. Ato janë një grup qelizash të cilat ndihmojnë embrionin në çdo detaj të zhvillimit të tij në mitrën e nënës. Për shkak të balancimit në mes të nënës dhe të embrionit që këto qeliza ofrojnë, zhvillimi vazhdon pa rrezik. P.sh. këto qeliza pengojnë shtypjen në embrion nga enët e gjaku të nënës apo elementet e sistemit mbrojtës të nënës që të dëmtojnë foshnjën. Sigurisht, është Zoti Ai që bën që këto qeliza të kanë njohuri për çfarë foshnja ka nevojë.

nënës do të rridhte me shtypje të lartë. Në situatë të tillë, qarkullimi i gjakut në embrion do të ndalej si rezultat i shtypjes së jashtme të nënës.

Në javët që pasojnë, një numër i këtyrë qelizave krijojnë një mbrojtëse në mes embrionit dhe gjakut të nënës. Kjo mbrojtëse quhet 'placenta' e cila ka një ndërtim shumë të veçantë. Kur e analizojmë atë së afërmi, shikojmë se qelizat trofoblaste krijojnë këtë mbrojtëse që të veprojnë si një ndalues i gjakut. Ky është një tipar shumë i rëndësishëm, sepse embrioni tash është i lidhur për indet e nënës dhe do të ushqehet me ushqim që vjen nga gjaku i nënës. Është e nevojshme që ushqimi të hyjë, por është shumë e rëndësishme që qelizat mbrojtëse në mitrën e nënës të mos arrijnë deri te embrioni së bashku me ushqimin. Kështu që, sistemi ndalues i formuar nga placenta pengon qelizat mbrojtëse të nënës në mitër që t'i afrohen embrionit. Mirëpo, nëse rrjedhja e gjakut nga nëna është e bllokuar, si ushqehet embrioni?

Përgjigja në këtë pyetje paraqet perfeksionin e strukturës së ndërtimit të qelizave. Hapësira të zbrazëta që gjenden në mes të këtyrë qelizave që shërbejnë si ndalues, janë të asaj madhësie që lejon ushqimin e nevojshëm për embrionin të tërhiqet nga protoplazma e gjakut të nënës. Oksigjeni, materiali ushqyes dhe mineralet nga gjaku i nënës, kalojnë përmes këtyrë hapësirave dhe arrijnë embrionin. Ndërsa, qelizat mbrojtëse, meqenëse janë aq të mëdha, nuk mund të kalojnë nëpër këto hapësira. ³⁵



Në të majtë shofim një embrion të ngulitur në muret e mitrës (blastocisti). Embrioni gjen një vend në mitër ku ka shumë enë të gjakut dhe vendoset aty. Sikurse fara që hidhet në tokë, përhap rrënjët e veta dhe përparon, ashtu edhe embrioni vazhdon të rritet dhe bën për vete kanale të thella në inde të cilat do t'a furnizojnë atë me lëndë ushqyese. Ato që e bëjnë këtë janë qelizat e posaçme, të quajtura trofoblaste, që gjenden në shtresën më të jashtme të embrionit.

Nëse mendojmë për urën të cilën ato e krijojnë në mes nënës dhe embrionit, nuk do të gabojmë të themi se puna e bërë nga qelizat trofoblaste kërkon një dituri ingjinerike pa të meta. Me sistemin që ato ndërtojnë, ato me të vërtet krijojnë themelin e një 'ure të jetës' në mes nënës dhe foshnjës. Këto qeliza veprojnë si ndalues të materialit të rrezikshëm që të futet në gjak dhe duke lënë hapësira në mes veti, ato lejojnë materialin e nevojshëm që të kalojë.

Këto shpjegime tregojnë vetëm disa funksione të qelizave trofoblaste, por është më se e mjaftueshme për të dhënë një ide të ndërtimit perfekt të këtyre qelizave. Në të gjitha rregullimet që ato bëjnë, ato lënë zbrastira duke formuar një sistem që vendos çfarë materiali është mirëbërës dhe e lejojnë të kalojë; ato e dijnë se cili material është i rrezikshëm për embrionin dhe nuk e lejojnë të futet. Është shumë e qartë se një ndërtim i tillë nuk do të vinte në ekzistencë nga rastësia.

Çdokush që pohon se të gjitha këto tipare të jashtëzakonshme janë rezultat i rastësisë, sigurisht që nuk do të jetë në gjendje t'ju përgjigjet pyetjeve të poshtëshenuara:

Si e dijnë këto qeliza për çka ka nevojë embrioni për zhvillimin e tij?
Si vendosin ato nga të gjitha ato materiale që gjenden në gjak se cili material është i nevojshëm?

Si e dijnë ato se qelizat mbrojtëse janë të rrezikshme për embrionin?

Si kanë ato njohuri që të krijojnë një filter që pengon kalimin e materialit të dëmshëm dhe lejojnë kalimin e materialit të nevojshëm?

Që raca njerëzore të vazhdojë, ky sistem nuk duhet të ketë as gabimin më të vogël. Secili që ka inteligjencë dhe vetëdije e di se rastësia nuk ju dha këtyre qelizave karakteristikat e tyre të veçanta. Rastësia nuk mund të prodhojë një ndërtim dhe të bëjë këtë ndërtim saktësisht të njëjtë në çdo genie njerëzore. Është Zoti i Cili krijon qelizat trofoblaste me të gjitha karakteristikat e tyre të veçanta dhe i drejton ato në rolin mbështetës në formimin e njeriut. Ky është vetëm një shembull i krijimit të artit të pakrahasueshëm të Zotit:

Ne nuk i krijuam qiejt dhe tokën dhe çdo gjë në mes tyre përveç se me të vërtetën dhe për një afat të caktuar. Por ata të cilët nuk besojnë largohen nga vërejtja jonë. Thuaj: "A keni menduar rreth atyre të cilët i thërrisni përpos All-llahut? Më tregoni se çka krijuan ata në tokë. Apo a kanë pjesëmarrje në qiej? Sillni ndonjë libër të zbritur para këtij apo ndonjë grimcë të diturisë hyjnore, nëse jeni duke e thënë të vërtetën." (Kur'an, 46: 3-4)

Placenta: Ura e Jetës

Sistemet mbajtëse të jetës të prodhuara nga teknologjia e fundit, që përdoren në shumicën e spitaleve dhe kushtojnë me miliona dollarë, janë primitive dhe gati të pavlefshme kur krahasohen me një masë mishi që peshon vetëm disa kilogram. Kjo masë mishi është placenta, që nga shkencëtarët quhet 'heroi i vërtetë i lindjes'.³⁶

Në një kohë të caktuar embrioni fillon të marr ushqimin, oksigjenin dhe materialet e tjera nga gjaku i nënës. Placenta, e cila është krijuar të plotësojë të gjitha nevojat e zhvillimit të fetusit, vepron si një urë duke siguruar kalimin e këtyre materialeve në mes nënës dhe fetusit. (Nga fillimi i muajit të tretë,

embrioni quhet fetus). Placenta është e mbushur me enë të buta të gjakut të cilat bartin te foshnja materialin ushqyes të filtruar nga qelizat trofoblaste; ajo dërgon tërë këtë material ushqyes dhe mineralet e rëndësishme siç është hekuri dhe kaliumi që vijnë nga nëna, së pari në zorrën umbilikale pastaj në kapilarët e fetusit. Përveç kësaj, placenta nuk kujdeset vetëm për furnizimin me lëndët ushqyese për metabolizëm të fetusit, por ajo gjithashtu zgjedh dhe transporton te fetusit lëndët ushqyese që janë të nevojshme për ndërtimin e indeve.³⁷ Aminoacidet janë të nevojshme për fetusin për të gjitha llojet e sintezës (karbohidratet, acidet nukleike - tullat ndërtuese të ADN-së, yndyrnat, etj.) Placenta zgjedh këto elemente dhe i merr ato nga gjaku i nënës. Përgjithësisht kjo realizohet nga bartës të veçantë. Ajo pajiset me këto elemente, përdor çka është e nevojshme për vetveten dhe dërgon një sasi të tyre në gjakun e fetusit, dhe është e nevojshme që me ato të pajiset në sasi të mëdha. Në mesin e këtyre elemente janë: hekuri që nevojitet për rritjen e volumit të gjakut dhe kaliumi që nevojitet për zhvillimin e eshtrave. Transferimi i këtyre elementeve në mënyrë të veçantë është efikas: edhe nëse nëna ka konsumuar pak hekur, placenta merr sasinë e nevojshme nga gjaku i nënës, furnizon nevojat e foshnjës dhe e mbron atë nga çdo lloj rreziku.³⁸

Placenta po ashtu në mënyrë efikase kryen edhe veprimin e kundërt, duke bartur materialin hedhës nga fetusit në gjakun e nënës.

Nuk duhet të harrohet se placenta, të cilën e shpjegojmë si 'zgjedhës', 'marrës', 'pajisës' dhe 'bartës' është një ind i përbërë nga qelizat. Është placenta ajo e cila kryen të gjitha aktivitetet e shënuara me fjalët më lart; p.sh. ajo e di se ka nevojë për hekur, dhe është e aftë të zgjedhë elementin e hekurit nga shumë substanca të tjera dhe e di se si hekuri i zgjedhur duhet të përdoret. Ajo nuk është njeri që ka njohuri por një grumbull qelizash e quajtur placenta. Qelizat të cilat përbëjnë placentën e njohin materialin që ato kanë nevojë dhe e zgjedhin atë, dhe fakti se një qelizë mund të njohë një element sigurisht se është një mrekulli. Përveç njohjes së këtij elementi, është edhe më mahnitëse që ajo e merr materialin e nevojshëm në sasinë e duhur dhe e bart atë në vendin e caktuar. Informacioni i dhënë deri këtu dhe ai që do të pasojë duhet gjithnjë të vlerësohet duke pasur këtë parasysh.



Placenta është urë vitale
ndërmjet nënës dhe foshnjës.

Ngjarjet të cilat ndodhin në mrekullin e krijimit të njeriut paraqesin një dituri të ekspozuar nga qelizat dhe nga molekulat dhe atomet që i prodhojnë qelizat. Në të vërtetë, kjo dituri nuk i takon asnjërës nga ato, por i takon Zotit I Cili i krijon ato dhe i inspiron për funksionet që duhet t'i kryejnë.

Të gjitha detajet të cilat do t'i hasim në faqet në vijim janë po ashtu dëshmi e qartë e krijimit.

Funksionet Tjera Vitale të Placentës


Zorra umbilikale, e cila lidh fetusin me placentën ka tre enë të gjakut dhe duket si një litar i gjatë. Njëra nga këto enë të gjakut quhet vena umbilikale. Ajo dërgon gjakun që bart materialin ushqyes dhe oksigjenin nga placenta te foshnja. Dy enët e tjera të gjakut quhen arteriet umbilikale ato transportojnë prej foshnjës në placentë gjakun i cili përmban dioksid karboni dhe produktet mbetëse nga materiali ushqyes.

Për shkak të ndërtimit të fortë dhe elastik (fleksibil) të zorrës umbilikale, ajo nuk dëmtohet ose deformohet lehtësisht. Është shumë e rëndësishme që të mos ketë problem në furnizim me gjak. Përveç kësaj, ndërtimi elastik i zorrës mundëson lëvizjen e foshnjës.

Nga këndvështrimi i funksionit të saj, placenta është krijuar që të veprojë për fetusin nganjëherë si mëlçja dhe stomaku, dhe nganjëherë si zorrë dhe veshkë. Gjithashtu, placenta nuk kryen funksionin e saj sipas një rregulli të fiksuar, por ndryshon atë sipas nevojave të foshnjës. P.sh. ushqimi që fetusit i nevojitet në muajin e parë dhe të dytë ndryshon nga ushqimi që i nevojitet në muajin e tetë dhe të nëntë; por për këtë placenta bën rregullimet dhe bën një ekuilibrim perfekt, duke zgjedhur ushqimin që foshnja t'a tret në mënyrën më të lehtë në secilën periudhë të zhvillimit të saj.


Një nga funksionet më të rëndësishme të placentës është të sekretojë (të japë) hormone (p.sh. estrogjenin dhe progesteronin) që janë të nevojshme për foshnjën. Nga këto hormone, progesteroni ka ndikim të veçantë në uljen e tkurrshmërisë së mitrës në trupin e nënës dhe i jep mbështetje fizike foshnjës. Në mënyrë që zhvillimi i foshnjës të vazhdojë, ai bën të mundur formimin e një ambienti tejet të rehatshëm. Përveç kësaj, ai lejon zhvillimin

MREKULLIA E KRIJIMIT TË NJERIUT



Tre tuba të ndryshëm përbëjnë kordonin umbilikal, të cilët sigurojnë lidhjen ndërmjet foshnjës dhe trupit të nënës. Njëri nga këta tuba bart ushqimin dhe oksigjenin për embrionin. Për këtë shkak, edhe pse embrioni jeton në një ambient të mbushur me lëng dhe mushkërit e tij janë të mushura me këtë lëng, ai nuk mbytet; dhe megjithëse ai nuk ka sistem tretës dhe nuk mundet për të ngrënë, embrioni nuk vdes nga uria. Dy tubat e tjerë largojnë mbeturinat e prodhuara nga embrioni. Mund të shifet se embrioni është krijuar me një ndërtim perfekt.

e gjëndrave të qumështit në gjinjët e nënës dhe në kohën e duhur ndihmon prodhimin e qumështit. Gjithashtu, ai ndihmon ngritjen e metabolizmit të nënës, kështu që i kontribon shëndetit dhe qetësisë së saj. Këto hormone sigurojnë që mitra të bëhet vend i rehatshëm dhe i sigurt për embrionin, dhe sekretimi (tajtija) i tyre në mënyrë dhe sasi të duhur janë shumë të rëndësishme që foshnja të ketë lindje të shëndetshme. Përveç kësaj, këto hormone përgatisin sistemin e nënës për lindje.



Organi që i kallon nevojat ndryshuese të fetusit dhe i përgjigjet këtyre nevojave pa mangësi është placenta. Qelizat në shtresën e jashtme të placentës formojnë një lloj filteri në mes të gjakut të nënës dhe fetusit. P.sh. derisa ia lejojnë kalimin materialit ushqyes nga gjaku i nënës, ato ia ndalojnë hyrjen elementeve të sistemit mbrojtës. Placenta është e përbërë nga qelizat. Si e dijnë këto qeliza çka i nevojitet fetusit? Si e kuptojnë nga cilat qeliza duhet t'a mbrojnë fetusin? Si e dallojnë në mesin e milionave molekulave atë çfarë i nevojitet embrionit? Kush ia dha këtë aftësi eksperte një mase mishi të quajtur placenta dhe qelizave prej të cilave përbëhet? Sigurisht që është Zoti I Cili ka marrur të gjitha masat paraprake që foshnja të mbijetojë dhe ka krijuar një sistem në trup për këtë qëllim. Zoti ka dituri të plotë për të gjitha llojet e krijimit.

Përveç këtyre funksioneve, placenta sigurohet që foshnja të jetë imune ndaj infeksioneve që mund të ndodhin në tre muajt e fundit të shtatzënis.

Ato që kemi shpjeguar deri në këtë pikë janë vetëm disa nga funksionet që ndërmerr placenta gjatë zhvillimit të foshnjës. Dhe, në çdo gjë që kemi shpjeguar këtu, ka një sasi të paimagjinueshme të detajeve. Secili sistem varet nga funksionimi i veprimeve kimike shumë komplekse.

Gjithashtu, çdo hulumtim i ri i bërë në lidhje me zhvillimin e fetusit zbulon një funksion të ri që placenta kryen për foshnjën. Në të gjitha këto është një çështje e përbashkët. Çdo aktivitet i placentës lidh ndërmjet tyre nënën me embrionin në një bashkim perfekt harmonik. Ky bashkim ka rëndësi të madhe sepse, sikur vetëm një nga balancimet në trupin e nënës të çrregullohet, embrioni nuk mund të mbijetoj.

Fakti që një organ i formuar nga qelizat është në dijeni të nevojave të një qenie të gjallë, vendos se çka është e nevojshme dhe vepron me njohuri se si t'ju përgjigjet këtyre nevojave; si dhe fakti që ky organ mund të prodhoj materialet e nevojshme në sasi të caktuar duke i zgjedhur dhe duke i marrë nga jashtë; shkurt, që një organ i tillë të paraqes aktivitet të dijsëm nuk është diçka që mund t'a bëj nga përpjekjet e veta. P.sh. nëqoftëse një njeriut i kërkohet të bëj të njejtën gjë, ai nuk do të jetë në gjendje të kryej këtë funksion. Të kuptohet se për çfarë dhe kur ka nevojë fetusit të marrë sasinë e nevojshme; të zgjedh materialin e duhur dhe të refuzoj materialin e padëshiruar janë gjëra të cilat një person pa kualifikim mjeksor nuk mund t'i realizojë. (Edhe një person me kualifikim mjeksor nuk do të mundte vazhdimisht, ditë dhe natë, të kryej këtë detyrë pa bërë asnjë gabim).

Por këto detyra që një njeri nuk mund t'i kryej, mund të bëhen në mënyrë efikase dhe pa të meta nga ky organ të cilin e quajmë placentë. Dhe placenta e secilit nga miliona qenie njerëzore që kanë jetuar nëpër mijëra vite ka demonstruar të njejtën detyrë perfekte dhe të vetëdijshme. Në të vërtetë ndërtimi perfekt i placentës dhe aktiviteti i saj i vetëdijshëm me të gjitha këto karakteristika janë rezultat i krijimit të Zotit. Të pohohet e kundërta do të ishte një hap përtej kufijëve të inteligjencës. Me ndërtimin e shkëlqyeshëm që Ai ka krijuar në trupin e njeriut, Zoti na paraqet neve artin e Tij të pakrahasueshëm, dhe na urdhëron neve në Kur'an që të mendojmë për këto të vërteta:

*Ai është I Gjallë – nuk ka zot tjetër përpos
Tij. Kështu që lutjuni Atij, dhe
adhurojeni sinqerisht. Lavdi i qoftë
All-llahut, Zotit të të gjitha botërave.
(Kur'an, 40: 65)*



Ai është Zoti i qiejve dhe i tokës dhe gjithçka në mes tyre, kështu që adhurojni Atë dhe këmbëngul në adhurimin e Tij. A njihni dikend tjetër që ia vlen Emrin e Tij? Njeriu thotë, "Kur unë të jem i vdekur, a mos do të ngritem prapë në jetë?" A nuk përkujton njeriu që Ne e krijuam atë më parë kur ai nuk ishte asgjë? (Kur'an, 19: 65-67)

Në temat që do të diskutohen në faqet në vijim, një çështje e rëndësishme nuk duhet të harrohet. Sikur që kemi parë në shembujt e dhënë deri këtu, të gjitha njësitë e trupit të njeriut të cilat veprojnë sipas një plani, kryejnë detyrat e tyre të ndryshme në kohë të caktuar, e dijnë në cilën pikë duhet të ndalen, nuk largohen nga vendi i detyrës së tyre, mund të punojnë në ekipe, bëjnë zgjedhje që të përmbushen nevojat e caktuara dhe prodhojnë materialin e nevojshëm në kohën e duhur, janë qeliza. Siç do të shikojmë në disa detaje më vonë, në veprimet e këtyre qelizave aq të vogla që nuk mund të shikohen me sy të lirë pa mikroskop, ka një intelgjencë të qartë, dhe kjo intelgjencë nuk iu përket qelizave. Qelizat e përbëra nga atomet pa dije dhe jetë nuk mund të kenë kapacitete të menduarit e të vepruarit. Kjo dije dhe intelgjencë supreme i përket Zotit. Është e rëndësishme të mbahet në mend vazhdimisht kjo e vërtetë; është mënyra me anë të së cilës individit thëllon vetëdijen e tij në këto ngjarje mahnitëse dhe sheh fuqinë e përjetshme të Zotit.

Trupi Vazhdon të Marr Formë

Në ditët e para embrioni merr ushqimin e nevojshëm vetëm nga gjaku i nënës. Tash, që të ushqej trupin e tij dhe të dërgoj oksigjen te qelizat e veta, embrioni ka nevojë për sistemin e vet qarkullues. Në mënyrë që të sjell sistemin e tij në ekzistencë, një numër i qelizave marrin një vendim të menjëhershëm që të bashkëpunojnë, dhe fillojnë të formojnë sistemin qarkullues. Ky aktivitet qelizor është dëshmi e qartë se ato dirigjohen nga një intelgjencë dhe dituri e përhershme.

Rreth ditës së 13-të, një grup qelizash lëvizin në vendin ku do të formohet krahërori dhe zemra. Duke rregulluar veten si tub në formë të një U-je, me një nivel të lartë të diturisë ato së pari formojnë strukturën bazë të zemrës. Pastaj, sikur të kishin dëgjuar se formimi i zemrës ka filluar, mijëra qeliza të

PREJ NJË QELIZE NË NJË KOKËL MISHI...

Qelizat vazhdojnë të ndahen dhe shumohen gjatë një periudhe kohore, duke formuar qelizat e syrit të ndjeshme ndaj dritës, qelizat nervore për perceptim të thartës, ëmbëlës, dhimbjes, nxehtësis dhe të ftohtit, qelizat e veshit që të ndejnë tinguj valor, qelizat e sistemit tretës për procesim të ushqimit, dhe shumë të tjera.

Mbas tre javëve të para të embrionit, qelizat e shumuara marrin pamjen e një kokle. Në Kur'an, ky zhvillim paraqitet si ndryshim prej një 'alaaq' (embrion) në një 'kokël':

Pastaj Ne bëmë atë pikë alaaq (embrion) dhe shndërruam alaaq-in në copë mishi dhe shndërruam copën e mishit në eshtra dhe i veshëm eshtrat me mish, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër. I Bekuar qoftë All-llahu, më i miri Krijues! (Kur'an, 23: 14)

Kohëve të fundit në shkencën e embriologjisë është zbuluar se faza e parë e formimit të foshnjës mbaron me këtë lloj zhvillimi. Mirëpo ky fakt shkencor është paraqitur 1400 vite më parë në Kur'an, i cili është perfekt dhe pa gabime, i dërguar nga All-llahu, Zoti i universit. E Lartë është Madhështia e Zotit.









Në foton majtas, shofim fetusin tre javësh të ngjitur për murin e mitrës. Kjo masë e qelizave që i gjason një cope mishi do të vazhdojë me ndarje dhe, në një kohë, sytë që na mundësojnë të shikojmë, hunda që na mundëson të nuhasim, shputat me të cilat ecim dhe vrapojmë, dhe duart dhe organet e brendshme do të formohen nga këto qeliza. Ky transformim i mrekullueshëm nuk mund të vjen nga rastësia. Nuk ka mundur të ndodh nga vetvetja. Është Zoti Sunduesi i të gjitha botërave, I Cili i rregulloi pa të meta të gjitha këto transformime në trup.

tjera fillojnë të ndërtojnë enët e gjakut që do të shtrihen në tërë trupin. Kështu që, me shpërndarjen e qelizave në vendet e duhura, formimi i enëve të gjakut kompletohet rreth ditës së 21, tani, sistemi qarkullues është gati për funksion, dhe me rrahjen e saj të parë rreth ditës së 25-të, zemra mban një ritëm prej 60 rrahjeve në minutë gjatë muajve të parë të zhvillimit.³⁹ Shtrëngimet (kontraksionet) shpërndahen në gjithë zemrën si valë, mirëpo kur formimi i zemrës përfundon, kontraksionet shpërndahen midis dhomëzave të ndryshme.

Zemra fillon të rrahë, por ende nuk ka gjak. Edhe për këtë aspekt kontribuojnë qelizat e duhura. Këto qeliza, në fakt, llogarisin paraprakisht se formimi i trupit të njeriut të ri ka nevojë për një substancë e cila quhet 'gjak', dhe ato bëhen qeliza të gjakut. Së shpejti gjaku fillon të rrjedh nëpër enë të gjakut. Në fund të javës së katërt, gjaku fillon të mbush plotësisht zemrën dhe enët e gjakut. Me të vërtetë, formimi i zemrës, sistemi qarkullues dhe gjaku në vetvete janë një gjë e mahnitshme. Përderisa asnjë nga këto ende nuk ekzistonte, qelizat, duke ekzekutuar një plan perfekt dhe duke shkuar në vende të duhura në kohën e duhur, formojnë sistemin qarkullues të domosdoshëm për jetën e njeriut. Asnjë nga fazat të cilat i kemi thënë këtu nuk janë rezultat i asnjë veprimi të rastësishëm; ky plan prefekt i ndërtimit nuk është e mundur të jetë bërë nga qelizat të cilat erdhën në ekzistencë nga një qelizë e vetme. Në këtë pikë gjithashtu, ajo me të cilën ballafaqohemi është një dëshmi e vërtetë e krijimit.



Formimi i Mrekullueshëm i Sistemit Qarkullues







Këto qeliza, të radhitura të pavarura nga njëra tjetra, faktikisht janë qelizat e enëve të gjakut. (1-2). Pak më vonë, këto qeliza papritmas bashkohen dhe fillojnë të formojnë një lidhje ndërmjet tyre. (3-4) Qelizat formojnë enët e gjakut. (5-6) Më në fund, ato ndërtojnë një sistem tubash pa qarje apo vrima. Sipërfaqja e brendshme e enëve të gjakut është tejte e lëmuar. Numri total i gjatësisë së enëve të gjakut është më shumë se 40.000 km. Kjo gjatësi është aq sa tërë perimetri i tokës. Ky ndërtim i mrekullueshëm është nga Zoti, Sunduesi i të gjitha botërave.

Jo vetëm formimi i sistemit qarkullues por gjithashtu edhe karakteristikat që posedon çdo element i saj janë të krijuara në një ekuilibër mahnitës. Gjaku i foshnjës që është duke u zhvilluar në mitrën e nënës ka shumë më shumë cilësira të veçanta nga ai i individit të rritur. P.sh. hemoglobina e gjakut të foshnjës është në gjendje të mbajë më shumë oksigjen se sa ajo e një të rrituri. Numri i qelizave të kuqe të gjakut në një kub centimetër të gjakut të marr nga një embrion është më i lartë se sa ajo që gjendet në volumin e njejtë të gjakut të foshnjës së posalindur. Në muajin e katërt, kordoni mund të bart një qarkullim të barabartë me 24 litra në ditë në mes të foshnjës dhe placentës. Ky qarkullim, që sjell furnizim për foshnjën nga placenta dhe kthen mbeturinat në placentë rrjedh vazhdimisht dhe aq shpejt sa që një udhëtim shkues-kthyes komplet ohet për rreth 30 sekonda.⁴⁰ Në këtë mënyrë, gjaku fillon të marr oksigjenin dhe ushqimet e nevojshme nga placenta dhe i bart ato te qelizat. Në momentin që formohen veshkët, gjaku fillon të pastrohet duke marr me vehte mbeturinat e mbledhura nga qelizat e foshnjës për te veshkët.

Le të ndalemi pak këtu që të shqyrtojmë: A është e mundur që një sistem kaq perfekt të jetë formuar një ditë nga rastësia, në mënyrë perfekte dhe nga vetvetja? A është e mundur që cilësitë e veçanta të gjakut të foshnjës, enët e gjakut që bartin gjakun në zemër dhe nga zemra në vendet e duhura, dhe elementet që lidhin qelizat e gjakut me placentën të vijnë në ekzistencë me kalimin e kohës nga rastësia? A është e mundur që të gjitha këto elemente në këtë sistem të kenë ndërtuar veten?

Sigurisht që jo. Ky sistem, me një rëndësi maksimale për qenien njerëzore, duhet vijë në ekzistencë në mënyrë perfekte dhe në një moment, sepse çfarëdo problemi në formimin e gjakut dhe enëve të gjakut do të shkaktonte ndaljen e zhvillimit të embrionit. Sikur zemra të pomponte gjakun para formimit të enëve të gjakut, gjaku do të rrjedhte pa kontroll dhe nuk do të kishte qarkullim. Apo, sikur zemra të mos fillonte rrahjen në momentin e duhur, gjaku nuk do të qarkullonte nëpër trup. Kjo d.m.th. se embrioni do të vdiste pa u zhvilluar në mitrën e nënës. Megjithatë, në secilin njeri prej milionave që kanë jetuar gjatë periudhave e deri më sot, nuk ka pasur problem me këto funksionime, zemra bën rrahjen e saj të parë saktësisht në kohën



FORMIMI I ZEMRËS

Formimi i zemrës është një mrekulli e qartë e krijimit. Papritmas, disa qeliza të shumara fillojnë të tkurren dhe të zgjerohen. Më vonë, qinda mijëra nga këto qelizave bashkohen që të formojnë zemrën. Kjo zemër do të vazhdojë të rrah gjatë gjithë jetës. Në ditën e 23të pas fekondimit, enët e gjakut të embrionit fillojnë të bashkohen, në ditën e 25 të shifet vetëm një dhomëz. Në ditën e 26të dhe të 27të dhomëzat e tjera fillojnë të zhvillohen. Në ditën e 33të ventrikujt dhe atriumet fillojnë të zhvillohen dhe në ditën e 40të zemra formohet plotësisht. Në foton e embrionit në të majtë, zemra është paraqitur me të kuqe.

e duhur dhe pompon mjaft gjak për trupin në zhvillim. Kjo e bën absurde pyetjen që e shtruar më herët: 'A mund të ketë ndodhur rastësisht?' Fakti që një sistem, një qenie e gjallë apo një organizëm vjen në ekzistencë në një moment është dëshmi e qartë se është krijuar. Kjo është një e vërtetë e qartë që secili person inteligjent do t'a pohoj.

Krijuesi i gjithë këtyre sistemeve perfekte është Zoti, I Cili krijoi njeriun së bashku me çdo gjë që i nevojitet dhe i dha atij formën më të bukur.

Ndërtimi i Sistemit Nervor

Derisa të gjitha këto veprime vazhdojnë, një ndërtim i rëndësishëm duhet të bëhet: sistemi nervor qendror. Sistemi nervor qendror (truri dhe palca kurrizore) del nga një e zgatur e trashë e ektodermës, shtresa më e jashtme e tri shtresave fillestare të embrionit. Anësoret e kësaj pllakëze neurale ngriten përderisa nervori mbështillet, i cili me t'u rritur më tutje, mbushet dhe kapsullohet, dhe kështu krijon një tub nervor.

Pjesa e përparme e këtij tubi trashet dhe shtrihet për të formuar trurin, ndërkohë pjesa e pasme formon palcën kurrizore.

Të gjitha zhvillimet të cilat i kemi përmbledhur këtu me një apo dy fjali kalojnë kufijtë e imagjinatës së njeriut. Fazat e tjera në formimin e sistemit nervor vazhdimisht vërtetojnë karakterin e jashtëzakonshëm të këtyre zhvillimeve.

Nga java e katërt në palcën e kurrizit fillojnë të prodhohen qeliza të veçanta nervore që quhen neurone. Ato prodhohen shumë shpejt në një shpjetësi prej 5000 në sekond.⁴¹


Një numër i madh i qelizave të trurit prodhohen në pesë muajt e parë të jetës së embrionit, dhe të gjitha para lindjes vendosen në vendin e vet në tru. Qelizat e sistemit nervor formohen shumë shpejt dhe pastaj fillojnë të shpërngulen në vendet më të largëta në mënyrë që të formojnë vargjet e sistemit nervor.

Në këtë fazë, është absolutisht e nevojshme për çdo njeri që secili neuron të gjej vendin e tij të rezervuar në sistemin nervor. Për këtë arsye, një udhëzues është i domosdoshëm që të ndihmojë orientimin e neuroneve

të reja drejt vendit të tyre. Këta udhëzues janë qelizat e veçanta të cilat zgjaten si një lloj kabloje në mes të vendit ku zhvillohet truri dhe palca kurrizore. Neuronet e lëshojnë vendin ku ato prodhohen dhe shpërngulen të ngjitura në këta udhëzues. Ato e dijnë vendin e caktuar të tyre, vendosen aty dhe menjëherë lëshojnë zgjatime duke formuar lidhje me neuronet e tjera.

E gjithë kjo është shumë mirë. Mirëpo, si e dijnë neuronet që duhet të nisen në një udhëtim të gjatë menjëherë mbas formimit të tyre? Si vendosin që të përdorin një udhëzues që të arrijnë tek vendi dhe të bashkëpunojnë me njëra tjetrën? Ato që quajmë neruone janë qeliza të vogla që mund të shikohen vetëm me anën e mikroskopit, dhe janë të përbëra nga atomet dhe molekulat. Pa dyshim se ato nuk mund të pozicionohen në mënyrë të tillë nga vendimi dhe vullneti i tyre. Ajo që i drejton ato nuk është truri, sepse truri i embrionit në mitrën e nënës nuk është zhvilluar ende.

Menjëherë mbasi të formohen këto qeliza, të dirigjuara nga informacioni që gjendet në to, lëvizin sikur të programuara drejt vendit të panjohur. Është e qartë se në procesin e formimit të trurit dhe sistemit nervor, asnjë ndodhi nuk mund vjen në ekzistencë nga rastësia, sepse një ndryshim në një fazë të vetme do të shkaktoje reagime të njëpasnjëshme zinxhirore duke bërë që tërë sistemi të prishet. Formimi i neuroneve dhe bërja e tyre sistem



Ndërtimi i trurit paraqitet qartë në ambientin me ujë në mitrën e nënës. Ky ndërtim bëhet nga qelizat të cilat nuk kanë inteligjencë apo dituri. Në fund të këtij procesi të mrekullueshëm foshnja do të ketë një total prej 10 bilion qeliza të trurit. Secila qelizë vepron me një njohuri paraprake se me cilën qelizë duhet të lidhet. Nga mundësit e pafundme, ajo gjen vendin ku përket. Bashkohet me qelizën që duhet të bashkohet. Në fund, arrihen 100 trilion lidhje perfekte në tru. Ai vullnet që ua lejon qelizave pa vetëdije, duke punuar në terr, të ndërtojnë kompjuterin më të shkëlqyeshëm në botë – trurin – është ditura e përjetshme e Zotit.

nervor është vetëm një fazë e formimit të trurit dhe sistemit nervor të lidhur me të. Jo truri, siç pohojnë evolucionistët, por asnjë neuron i vetëm nuk mund të formohet nga rastësia.

Ka shumë e shumë detaje të tjera në këtë zhvillim. P.sh. kur neuronet vijnë në ekzistencë në fillim, ato kanë ndërtim të ndryshëm nga ato të njeriut të pjekur. Në mënyrë që të kryejnë funksionet e kërkuara nga sistemi nervor i një njeriu në zhvillim, neuronet shpërngulen në një pjesë të veçantë të trupit, dhe në fazën e parë, metabolizmi i tyre ju mundëson atyre që të mbijetojnë pa oksigjen. Kur ato arrijnë në tru dhe vendosen aty, ato menjëherë marrin një metabolizëm që varet nga oksigjeni për mbijetesën e tyre. Për dobi të të gjitha qelizave nervore ky ndryshim duhet të ndodh çdo herë në mënyrë perfekte, përndryshe mbijetesën e tyre do të ishte e pamundur. Kjo padyshim se është një gjë e mrekullueshme.⁴²

Sot e dijme që është tejet e rrezikshme për njeriun që qelizat e trurit të mbesin pa oksigjen për një kohë të caktuar, dhe nëse kjo kohë zgjat paraqitet paraliza, pastaj vdekja është e pashmangshme. Mirëpo neuronet e para që vijnë në ekzistencë kanë një sistem krejt ndryshe. Sikur të ketë problem në këtë fazë, d.m.th, sikur të mos ndodh ndryshimi në metabolizmin e neuroneve saktësisht në momentin e duhur, embrioni nuk do të zhvillohej në njeri. Natyrisht që, nuk është e mundur që qeliza të vendos çfarë funksioni do të kryej në të ardhem dhe të ndryshoj ndërtimin nga vullneti dhe dijenia e saj në mënyrë që të kryej këtë funksion.

Duke qenë kështu, ne konfrontohemi me një të vërtetë të qartë: është Zoti I Cili krijon neuronet me këto karakteristika, i fut ato në punë në momentin e duhur dhe i përcakton drejtimin ku duhet të shkojnë. Çdo njeri duhet të di se është sjellur në jetë nëpërmes këtyre fazave, dhe të falemnderoj Zotin për madhësitë me të cilën e ka krijuar atë në njeri. Ai nuk duhet për asnjë moment të harroj se Zoti është Krijuesi i çdo gjëje, dhe përveç Atij, nuk ka forcë tjetër në qiell e në tokë.

...A nuk besoni në Atë I Cili ju krijoi juve nga dheu, pastaj prej një pike të spermës, dhe pastaj ju bëri juve njeri? Megjithatë, Ai është All-llahu, Zoti im, dhe unë nuk i bëj asnjë shok Zotit tim. (Kur'an, 18: 37-38)

Rëndësia e Planifikimit Ndërmjet Qelizave


Kur shikojmë zhvillimin e embrionit, vërejmë një shkallë të lartë të proporcionit dhe harmonisë. Në fund të muajit të parë, zhvillimi i syve, veshëve, hundës, mjekrrës dhe faqeve bëhen të dallueshme.

Në rrjedhën e këtij zhvillimi harmonik është shumë e rëndësishme që të ndodh rritja dhe ndryshimi struktural. Është e nevojshme që këto ndryshime të ndodhin në të njejtën mënyrë në të gjitha pjesët e trupit, sepse të gjitha organet e trupit të njeriut kanë ndërtim tepër të ndërlikuar. P.sh. vetëm syri ka 40 pjesë të ndryshme. Që syri të jetë i aftë të kryej funksionin e tij, është e nevojshme që rritja e këtyre pjesëve të jetë proporcionale, lidhjet në mes pjesëve të jenë të mira dhe çdo pjesë të jetë në vendin e vet. Përndryshe, syri nuk do të mund të kryej funksionin e tij. Në të njejtën mënyrë, në formimin e krahut, eshtrat dhe muskujt duhet të fillojnë formimin e tyre në të njejtën kohë.

Siç kuptohet nga e tërë kjo, të gjitha qelizat e embrionit veprojnë në harmoni. Secila nga ato është në dijeni të planit kryesor të trupit. Secila dërgon një numër të mesazheve dhe reagon në mesazhet që i vijnë nga qelizat e tjera. Të gjitha qelizat në embrion veprojnë së bashku; me mirëkuptim të vërtet, secila e ndryshme nga tjetra, ashtu siç duhet ato përdorin atë që nevojitet nga informacioni që gjendet në ADN.


Por si e dijnë qelizat ku të shkojnë dhe çka të bëjnë? Si mund të veprojnë së bashku në harmoni të tillë me qelizat e tjera? Kush vendos se si duhet të përdoret materiali gjenetik që gjendet në qeliza dhe si e bëjnë qelizat dallimin ndërmjet njëra tjetrës?

Në organet e trupit tonë nuk duhet të ketë mangësi apo tepricë. Një e metë në një organ nganjëherë është fatale; e më së paku shkakton paaftësi. Një teprim vendos një barrë të panevojshme në trup. Kështu që, së pari është e nevojshme që të vendoset numri i organeve që



*O njeri! Ç'të
mashtroi ty nga Zoti
yt Fisnik I Cili të
krijoi ty dhe të dha
formë të drejtë dhe
të proporcionoi ty?
Në çfardo forme që
Ai dëshiroi, Ai të
formoi ty.
(Kur'an, 82: 6-8)*

Është Zoti Ai që Krijon Trupin Nga një Copë Mishi



Para se të fillojë të zhvillohet, embrioni i ngjan një cope mishi. Sytë, veshët, zemra dhe organet e tjera zhvillohen dhe një person i ri vjen në ekzistencë. Lart, shofim zhvillime serike që ndodhin në formimin e fytyrës së njeriut. Çdo njeri në faqen e tokës ka kaluar nëpër këto faza. Njeriu si një grumbull qelizash të pavetëdijshme për ekzistencën e tyre, vazhdon nëpër këtë zhvillim në ambientin e mbrojtur dhe të sigurt në mitrën e nënës. Sytë simetrik, vetullat, hunda, goja dhe lëkura mbrojtëse të gjitha formohen në trupin e nënës. Këto transformime mrekulluese që shihen në foton lart janë dëshmi e artit krijues të Zotit. Është detyrë e secilit person në botë të mendojë për këtë të vërtetë dhe të falemnderoj Zotin.



trupi ka nevojë. Si vendoset për këtë numër? Si ndodh që kur një grup qelizash fillojnë të bëjnë një organ, një grup tjetër i qelizave nuk e bëjnë të dytin, d.m.th. të njejtin organ?

Evolucionistët mundohen t'i shmangen kësaj çështje duke thënë se molekula e ADN-së është përgjegjëse për këto funksione, por kjo është vetëm një mashtrim. Çështja kyçe për t'u shqyrtuar këtu është: kush i vendosi të gjitha informatat në molekulën e ADN-së të çdo qelize në trup. Gjithashtu, kush vendos se ku, kur dhe si kjo informatë të përdoret? Këtyre pyetjeve evolucionistët nuk mund t'ju japin përgjigje.

Qelizat formohen nga atomet pa jetë dhe dije, enët e gjakut, indet, ajri, era apo çfarëdo materiali tjetër, nuk kanë fuqi të sjellin vendime të tilla. Është Zoti I Cili nguliti këtë plan të mrekullueshëm në ADN dhe është Zoti I Cili siguron realizimin perfekt të këtij plani duke i frymëzuar qelizat që të bëjnë atë që duhet bërë. Zoti ka fuqi mbi të gjitha gjërat.



Përgatitjet për Botën e Jashtme

Foshnja, organet e të cilës zhvillohen ngadalë dhe e cila është në prag të fillimit të lëvizjes, pret një zhvillim të mëtjeshëm. Që foshnja të mbijetojë në një ambient plotësisht të ndryshëm nga ai në të cilin jeton tash, duhet që përgatitjet e nevojshme të bëhen.

Foshnja ka nevojë të fillojë të lëvizë ngadalë dhe t'i fus në veprim organet e sapo formuara. Ky problem është zgjidhur në mënyrën më të mrekullueshme. Në membranën që e ndan foshnjën nga mitra, një lëng i veçantë i quajtur "lëngu amniotik" fillon të prodhohet. Veshkët dhe mushkëritë e foshnjës, membrana amniotike dhe mitra që e rrethon kontribuojnë në formimin e këtij lëngu.

KRIJIMI MAHNITËS I SYRIT


Në javën e katërt, në dy anët e kokës së embrionit formohen dy zgavra. Është vështirë të besohet, por sytë do të formohen në këto zgavra në fillimin e javës së gjashtë. Me muaj qelizat punojnë sipas një plani të jashtëzakonshëm, duke formuar pjesë të ndryshme të syrit një nga një. Disa qeliza bëjnë kornen, disa bëjnë bebëzat dhe të tjerat bëjnë lentet. Kur një pjesë që ndërtohet nga një qelizë e posaçme kompletohet, qeliza ndalet së punuari. Secila qelizë bënë një pjesë të ndryshme të syrit; më vonë ato bashkohen me njëra tjetrën në një mënyrë mahnitëse. Në proces nuk ka gabime; asgjë tjetër nuk zë vendin e bebëzës, apo të kornesë, apo të muskullit të syrit dhe secili element është në vend. Këto veprime vazhdojnë dhe syri formohet në mënyrë perfekte me shtresat e tij të ndryshme.



Këtu duhet t'ia bëjmë vetes ca pyetje: Si e dijnë këto qeliza se duhet të ndërtojnë shtresa të ndryshme? Si vendosin ato kur të fillojnë dhe kur të përfundojnë ndërtimin e secilës shtresë? Në këto pyetje është vetëm një përgjigje: Qelizat mund të kryejnë këtë aktivitet të dijshtëm sepse ato lëvizin nën inspirimin e Zotit. Por evolucionistët të cilët mundohen të shpjegojnë formimin e njeriut nga veprimet e rastësisë nuk mund t'u japin përgjigje këtyre pyetjeve.

Një nga evolucionistët i cili shpjegoi planin perfekt në trupin e njeriut ishte Hoimar von Ditfurth. Në librin e tij, *Im Anfang War Der Wasserstoff* (Në Fillim ishte Hidrogjen), ai shpjegon formimin e njeriut në detaje dhe pranon se teoria e evolucionit kurrë nuk do të mund të jap përgjigje në pyetjet 'si' dhe 'pse':

Sikur të mos ketë një plan të përcaktuar ku dhe kur ndërtimi të fillojë dhe në çfarë rendi të vendosen në veprim secili nga elementet e tij, ai plan do të ishte i kotë, edhe sikur të ishte i shkëlqyeshëm në aspektet e tjera. Ne e dimë se ndërtimin e kësaj ndërtese duhet filluar nga themeli dhe pas përfundimit të mureve e



Formimi i syrit në embrion është përmbledhur si më lart. Një pjesë e projektuar zhvillohet nga pjesa frontale. Aty formohen invaginacione të brendshme ku kjo fushëgropë arrin shtresën e jashtme të embrionit (ektodermën). Nga këto invaginacione, që quhen fshikëza optike, do të dalin sytë.



Vullneti i cili e transformon një objekt të errët si pikë në sy tërheqës me ngjyra që regjistron tre dimensione është Zoti, Zotëruesi i çdo gjëje.

vendosim kulmin. Por para se të kompletohet instalimi i ujit dhe i rrymës, ne nuk mund të suvatojmë. Së bashku me planin që duhet të përcillet me përpikëri në çdo ndërtim, gjithashtu edhe koha është e caktuar për përfundim.

Kjo vlen edhe për ndërtimet natyrale dhe posaçërisht për qelizat. Mirëpo, ne nuk dijmë gati asgjë se si kjo marrëdhënie 'përpara dhe prapa (më vonë)' ndodh në organizimin e qelizës. Biologët ende nuk janë në gjendje të gjejnë se kush ju tregon qelizave se cila pjesë e planit duhet të kryhet dhe kur. Kush ua jep urdhërin që pengon veprimin e disa gjeneve m'u në kohën e duhur, si hiqet embargoja në disa gjene, dhe kush i organizon gjenet shtypëse dhe gjenet shtytëse në veprim? Këto janë pyetje për të cilat jemi në errësirë të plotë.⁴³

Në formimin e syrit, 'kamerës më të mirë në botë', kemi parë që qelizat e pavetëdije veprojnë me dituri tejet të lartë, duke krijuar syrin në trupin e nënës nga asgjëja. Sigurisht që, nuk janë vet qelizat që kanë sukses në kryerjen e kësaj pune të jashtëzakonshme: ato veprojnë nën inspirimin e Zoti të Madhërishtëm. Në Kur'an, Zoti tregon se Ai un jep njerëzve formën e tyre:



Ai është All-llahu – Krijuesi, Shpikësi, Dhënësi i Formës. Atij i përkasin emrat më të bukur. Çdo gjë në qiej e në tokë e madhëron Atë. Ai është i Gjithëfuqishmi, I Urti.

(Kur'an, 59: 24)



Mbështjellja e Muskujve Rreth Eshtrave

Deri vonë, embriologjistët mendonin që eshtrat dhe muskujt e embrionit zhvillohen në të njejtën kohë. Sidoqoftë, hulumtimet e vonshme zbuluan një fakt krejt tjetër i cili ishte i panjohur për njeriun. Së pari, indi kërcor i embrionit osifohet (eshtërohet). Pastaj qelizat muskulore që janë selektuar nga indet rreth eshtrave bashkohen dhe mbështillen përrreth eshtrave.

Ky fakt, që është zbuluar kohëve të fundit nga shkencë, është shpallur në Kur'an 1400 vite më parë:

Pastaj shndërruam pikën në copë gjaku (embrion) dhe shndërruam copën e gjakut në copë mishi dhe shndërruam copën e mishit në eshtra dhe veshëm eshtrat me mish, pastaj e bëmë krijesë tjetër. I Bekuar qoftë All-llahu, më i miri Krijues!
(Kur'an, 23: 14)

Kjo çështje, për të cilën Kur'ani informon 1400 vite më parë, shpjegohet kështu në një botim shkencor të titulluar *Zhvillimi i Njeriut*.

Në fazën e eshtrave gjatë javës së 7të forma e skeletit përcakton pamjen e përgjithshme të embrionit ; muskujt nuk zhvillohen në të njejtën kohë por zhvillimi i tyre pason përrreth eshtrave në tërë trupin dhe i veshin eshtrat. Kështu muskujt marrin format dhe strukturat e tyre të njohura.⁴⁴

Shkurt, fazat e zhvillimit të njeriut ashtu siç përshkruhen në Kur'an janë në harmoni perfekte me zbulimet e embriologjisë moderne. Zoti, Sunduesi i të gjitha botërave, ia ka dhënë njeriut këtë informatë shekuj më parë.



Në javën e gjashtë krahët dhe këmbët e embrionit paraqiten. Zinxhiri i mrekullive në zhvillimin e embrionit vazhdon pa ndalje derisa qelizat ndërtojnë duartë. Por disa nga këto qeliza më vonë sjellin një vendim të jashtëzakonshëm dhe mijëra qeliza mbysin vetën një nga një. Qelizat vdesin në një vijë të dallueshme duke formuar një kallëp për zhvillimin e gishtërinjëve. Qelizat e tjera i hajjnë qelizat e vdekura dhe formojnë kavitete në këto vende. Këto kavitete janë hapësirat në mes të gishtërinjëve. Dhe kështu gishërinjëet formohen. Vet fakti se qelizat mbysin veten për hir të qenieve njerëzore është dëshmi e qartë se Zoti krijoi njerëzit. Ndërkohë, disa qeliza fillojnë të formojnë këmbët. Këto qeliza nuk e dijnë se embrioni do të ketë nevojë për ecje në botën e jashtme, por ato ia ndërtojnë këmbët dhe shputat me strukturën më të mirë të mundshme. Burimi i aktivitetit të dijsëm të qelizave është inspirimi nga Zoti.

“Uji i Jetës” i Foshnjës: Lëngu Amniotik


Lëngu amniotik është i prodhuar posaqërisht për foshnjën; ajo siguron që organet të jenë të përgatitura për funksionim pas lindjes. Foshnja, sikur të ishte duke ushtruar e gëlltit lëngun amniotik që të përgatitet për botën e jashtme. Në këtë mënyrë, gjuha e saj fillon të ndjej shijen e hidhur, të ëmbël, të njelmët dhe të thartë. Pastaj gjëndrrat e pështymës fillojnë të funksionojnë. Lëngu amniotik që gëlltitet nga fetusi fillon të përgatisë zorrët për funksionin absorbues (thithës), dhe i bën veshkët të funksionojnë duke krijuar nevojën e filtrimit të vazhdueshëm të këtij lëngu të njejtë nga gjaku. Lëngu i marrur nga veshkët kthehet prapë te lëngu amniotik, pa e ndotur atë, sepse veshkët kanë aftësinë e dallimit nga funksioni i tyre i mëvonshëm, të filtrojnë dhe të sterilizojnë lëngun e gëlltitur nga foshnja. Ky lëng, vazhdimisht pastrohet me ndihmën e disa lëngjeve të tjera sikurse që pastrohet një pishinë noti.

Në të njejtën periudhë së bashku me këto zhvillime, lëngje që ndihmojnë tretjen e ushqimit fillojnë të sekretohen (tajiten) në stomak në mënyrë që sistemi i tretjes të përgatitet plotësisht.⁴⁶ Qelizat në zorrët e reja të foshnjës kanë aftësinë e dallimit në mes të sheqerërave dhe kripërave dhe kthejnë mbetjet e posaçme në gjakun e nënës. Në këtë mënyrë, të dyja, zorrët dhe veshkët vihen në veprim. Lëngu amniotik thithet nga zorrët e fetusit njëherë në tre orë, kjo ndodh tetë herë në ditë dhe kthehet te nëna nëpërmes gjakut. E njejta sasi e lëngut gëlltitet dhe lirohet në hapësirën e lëngut amniotik nga mitra e nënës, mushkëritë dhe veshkët e fetusit. Në këtë mënyrë, sasia e këtij

Në të djathtë, fetusi shifet në membranën amniotike. Lëngu brenda membranës mbrohet fetusin nga lëndimet dhe dëmtimet. Përveç kësaj, lëngu amniotik po ashtu i përgatit zorrët e fetusit për funksionin e tyre absorbues (thithës), ndihmon në funksionimin e veshkëve dhe ofron temperaturën konstante që i nevojitet foshnjës.

Prezenca e lëngut amniotik është po ashtu i rëndësishëm edhe për shëndetin e nënës. Ky lëng pengon fetusin të bëjë shtypje në mitër.





lëngu, që ka rëndësi vitale për fetusin, mbetet konstante. Ky organizim perfekt siguron funksionimin e sistemit të tretjes së fetusit pa ndonjë dëmtim të fetusit.

Në përputhje me rritjen e fetusit, sasia e lëngut amniotik shtohet, duke arritur rreth 30 ml në javën e dhjetë, 350 ml në muajin e pestë dhe 1 litër në muajin e shtatë. Në momentin e lindjes, sasia e lëngut bie në gjysmë litër.

47

Lëngu amniotik jo vetëm që përgatit sistemin tretës për periudhën pas lindjes, por gjithashtu ofron mundësinë që foshnja të lëvizë lirshëm në mitrën e nënës. Fetusi noton në këtë lëng sikurse një barkë e lidhur për liman (port). Edhe në këtë gjendje mund të lëvizë lirshëm në mitrën e nënës. Në të njëjtën kohë, ky lëng mbron fetusin nga lëndimet fizike të jashtme. Shtypja e bërë në lëng nga çfarëdo drejtimi shpërndahet barabartë në çdo drejtim duke e mbrojtur fetusin nga efektet e dëmshme. P.sh. nëse nëna vrapon, lëkundjet nuk kanë efekt në foshnjën; kjo mund të krahasohet me një tapë që noton në një enë të mbushur me ujë. Sistemi mbrojtës më perfekt i mundshëm është krijuar për fetusin; çdo lloj rreziku është parashikuar dhe masat paraprake janë ndërmarr.

Prania e lëngut amniotik është i rëndësishëm për shëndetin e nënës gjithashtu. Ky lëng mbush tërë mitrën, kështu që derisa fetusi rritet dhe fiton



Pa lëngun amniotik nuk është e mundur që foshnja të zhvillohet në mitrën e nënës. Ky lëng është prodhuar pa mangësi që nga koha e njeriut të parë e deri më sot. Kjo zhvlerëson pohimin e evolucionistëve se ky zhvillim ndodhi rastësisht fazë pas faze gjatë një periudhe kohore.

peshë, nuk bëhet shtypje në mitër. Sikur ky lëng të mos ishte prezent, rritja e fetusit do të peshonte mitrën poshtë dhe kundërshtypja nga muret e mitrës do të bënte të pamundur zhvillimin normal të fetusit.

Ky lëng i veçantë ofron edhe një nevojë tjetër vitale për fetusin: një temperaturë konstante. Dihet se lëngjet shpërndajnë nxehtësinë në mënyrë të barabartë. Lëngu amniotik qarkullon vazhdimisht dhe ruan një temperaturë konstante. Nxehtësia që nevojitet për zhvillimin e fetusit shpërndalet e barabartë në çdo drejtim.

Problemi më i vogël në prodhimin, pastrimin e vazhdueshëm apo rregullimin e volumit të këtij lëngu, ndikon në mos zhvillim normal të fetusit. P.sh. nëse sasia e lëngut amniotik është më e ulët se sa që

kërkohej, apo nëse fare nuk është i pranishëm, një seri anomalish paraqiten. Gjymtyrët vyshken dhe deformohen, nyjet ngjiten, lëkura lëshohet dhe për shkak të shtypjes, fytyra deformohet. Problemi më serioz është se zhvillimi i mushkërive ndalon dhe foshnja vdes menjëherë pas lindjes.⁴⁸

Gjithë kjo na tregon se nga njeriu i parë e deri më sot, prodhimi i lëngut amniotik ka vijuar pa të meta. Pa atë, foshnja nuk mund të zhvillohet në mitrën e nënës. Ky fakt plotësisht zhvlerëson pohimin e evolucionistëve se zhvillimi ka ndodhur fazë pas faze gjatë një periudhe kohore. Sikur një fazë e vetme në krijimin e njeriut të mos zhvillohej, lindja nuk do të mund të ndodhte kurrë dhe raca njerëzore nuk do të ekzistonte. Për këtë arsye nuk mund të pohohet se lëngu amniotik filloi të prodhohej gjatë një periudhe kohore kur u lind nevoja për të. Ky lëng duhet të ekzistojë së bashku me foshnjën. Është e pamundur të pohohet se një lëngë i tillë, me të tilla funksione vitale, është formuar në një moment rastësisht. Të thuhet se një organizëm kompleks erdhi në ekzistencë në një moment është të thuhet se ky organizëm u krijua. Është e pamundur që veprimet e rastësishme të llogaritin, të

QIME TË POSAÇME MBROJNË FOSHNJËN

Lëngu amniotik mbron foshnjën gjatë zhvillimit në mitrën e nënës. Mirëpo, nëse foshnja kalon shumë kohë në këtë lëng, do të pësoj dëmtime. Por, kjo nuk ndodh. Trupi i foshnjës ka një mbrojtje të shkëlqyeshme kundër dëmtimit nga ky lëng. Në muajin e pestë, qime të imëta pa ngjyrë mbulojnë trupin e foshnjës. Këto qime mbesin në trupin e foshnjës për tre ose katër muaj. Para lindjes ato e mbulojnë trupin e foshnjës gati plotësisht. Për shkak të këtyre qimeve, lëngu amniotik nuk dëmton lëkurën e foshnjës. Është e qartë se prezenca e këtyre qimeve është masë e veçantë e ndërmarrur për mbrojtjen e foshnjës. Në zhvillimin e foshnjës në mitrën e nënës nuk ka mangësi në asnjë detaj. Ky sistem është i organizuar në atë mënyrë që të mos ndodhin probleme dhe është vetëm një nga manifestimet e pakufijë të fuqisë krijuese të Zotit.



vendosin për nevojat, të zgjedhin gjërat e duhura për këto nevoja dhe të zbatojnë ato saktësisht në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

Është e qartë se Zoti krijoi lëngun amniotik dhe sistemet me të cilat është e lidhur ajo. Ai po ashtu vendos për sasinë e nevojshme të këtij lëngu.

All-llahu e di se ç'bart çdo grua dhe çdo tkurrje dhe enjtje (fryrje) të mitrës. Çdo gjë ka masën tek Zoti. (Kur'an, 13: 8)

Përgatitjet për Frymëmarrjen e Parë

Pas lindjes gjëja më e rëndësishme për foshnjën është frymëmarrja; është e nevojshme që mushkëritë, të cilat kurrë nuk e kanë njohur ajrin më parë, të mbushen me atë dhe t'a fillojnë frymëmarrjen. Foshnja, e cila me parë ka pranuar oksigjenin nga gjaku i nënës, tani duhet t'a merr atë nga ajri me anën e mushkërive të saj. Dhe në mënyrë të mrekullueshme, mushkëritë, që kurrë nuk kanë marrë frymë më herët në momentin e parë të lindjes, fillojnë të marrin frymë krejt normalisht.

Vjen koha që foshnja lind, Zoti krijoi çdo gjë të gatshme dhe bëri që përgatitjet e mushkërive të jenë kompletuar siç duhet. Në përgatitjen e

mushkërive, luan rol edhe diafragma; e cila është e lokalizuar në mes stomakut dhe kafazit të brinjëve. Diafragma fillon të funksionojë gjatë muajit të gjashtë të shtatzënisë. Në fillim ajo zgjerohet dhe shtrëngohet me ndërprerje disa herë në orë, por pas lindjes ajo e bën këtë pa ndërprerje.

Nga kjo mund të kuptohet se foshnja është vazhdimisht nën mbrojtje të vazhdueshme, por duhet të mbahet në mend se kjo nuk është mbrojtje nga nëna. Derisa fetusit zhvillohet, nëna bën jetën e saj normale; asnjë nga ndryshimet në trupin e saj nuk janë nën kontrollin e saj. Edhe sikur të dëshironte të intervenonte nuk do të kishte mundësi. Të gjitha këto zhvillime bëhen nga një fuqi e përhershme e Zotit tonë. Zoti në mënyrën më të mrekullueshme ka krijuar të gjitha gjërat e nevojshme që foshnja të vijë në botë si një njeri normal. Të gjitha nevojat e foshnjës përmbushen derisa është në fazën e fetusit, dhe nëna është e kursyer nga të menduarit se çka duhet të bëjë që të sjell foshnjën në botë dhe të sigurojë mbijetesën e foshnjës.

Edhe sikur ajo të mendonte të bënte diçka, nuk do të kishte mundësi të ndërhynte. P.sh. marrja e materialit të ndotur nga trupi i fetusit në veshkët e saj, pastrimi dhe lirimi janë gjëra të cilat asnjë nënë nuk mund t'i bëjë vet. Është Zoti i Cili i vendos të gjitha nevojat për një njeri të ri që do të vijë në botë dhe ndërton sistemet në atë mënyrë që t'i përgjigjen më së miri këtyre nevojave.

Përgatitjet Janë Kompletuar

Ndërkohë që fetusit gradualisht përgatitet për jetë në botën e jashtme, një ekip punëtorësh të jashtëzakonshëm janë organizuar ndërmjet organeve. Puna që bëhet është vendosur në bazë të kushteve të botës së jashtme. Sytë, e papërdorur në mitrën e nënës, janë ndërtuar për të përballuar intensitetin e dritës së botës; veshët janë bërë për të dëgjuar tingujt e botës. Në të njëjtën mënyrë, stomaku dhe organet e tjera tretëse kanë një strukturë fiziologjike që përshatet me ushqimin e botës së jashtme. Qelizat e sistemit tretës janë të programuara dhe të rregulluara në mënyrë të atillë që të tretin ushqimin që kurrë nuk e kanë takuar. Së bashku me aftësinë e tyre për të analizuar karbohidratet dhe yndyrnat, ato janë të programuara të njohin se

cilat ushqime nevojiten për organe dhe bëjnë që këto ushqime të dërgohen te qelizat e nevojshme në trup. Kështu, fetusi përgatitet për botën e jashtme në një mënyrë të planifikuar dhe të programuar. Këtu duhet të theksojmë përsëri se këto organe dhe qeliza që formojnë trupin e një njeriu të ri bëjnë këto përgatitje për një ambient të cilin kurrë nuk e kanë parë, nuk e dëgjuar apo nuk e kanë përjetuar. Ato zhvillohen sikur të jenë në dijeni për ambientin që është duke i pritur mbasi t'a lëshojnë trupin e nënës. Sigurisht se është e pamundur të pohohet se këto qeliza kompletojnë këto veprime nga parashikimi i tyre. Përgatitjet e dijshe dhe të qëllimshme të bëra nga qelizat në formimin e trupit të foshnjës, të inspiruara nga Zoti, duhen të gjykojnë si një dëshmi e rëndësishme e krijimit.

Në muajt e fundit, fetusi fillon të fitojë peshë. Qeliza të caktuara prodhojnë një shtresë yndyrore e cila quhet 'yndyra e kaftë' sepse ajo ka një ngjyrë kafeje. Yndyra e veçantë kafe zhvillohet në vende të posaçme si zverku i qafës, rreth veshkëve dhe prapa dërrasës së gjoksit. Përveç ofrimit të izolimit, kjo yndyrë prodhon edhe nxehtësi. Funkzioni i veçantë i kësaj shtrese është të mbajë foshnjën ngrohtë në javët e para të lindjes.⁴⁹ Fakti që qelizat të cilat prodhojnë këtë shtresë yndyrore pa të meta kryejnë detyrat e inspiruara në to është një dëshmi tjetër e krijimit.





Me teknologjinë e ditëve të sotme është e mundur që me anë të ultrazërit të vështrohet zhvillimi i foshnjës në mitrën e nënës.

Ndërkohë, lëkura e fetusit kalon nëpër ndryshime të rëndësishme që rezultojnë në zhvillimin e sipërfaqes së lëkurës para lindjes e cila është tejet e rëndësishme për mbijetesë pas lindjes. Lëkura e fetusit prodhon një mbulesë vajore sipërfaqësore e cila zbraps ujin nga lëkura që është në kontakt me lëngun amniotik. Kjo shtresë vajore sipërfaqësore ka një efekt të rëndësishëm në ngritjen e pjekurisë së qelizave nënlëkurore dhe në formimin e një barriere lëkurore para lindjes.

Në pjesët e mësipërme, kemi përmendur se në fazat e hershme të embrionit, qelizat mbrojtëse të nënës nuk lejohen të hyjnë në gjakun e foshnjës sepse e konsiderojnë foshnjën si një trup të huaj dhe mund t'a mbysin. Por në muajin e nëntë, papritmas kjo situatë ndryshon dhe antitruapat (një proteinë mbrojtëse e prodhuar nga sistemi imunologjik) në mitrën e nënës kalojnë në fetus përmes placentës. Kur e kuptojmë arsyen e kësaj, mahnitemi nga diçka tejet befasisëse. Në gjashtë muajt e parë pas lindjes, qelizat në sistemin imunologjik të foshnjës nuk zhvillohen, por foshnja ka nevojë për antitruapa që të mbrohet nga mikrobet në botë. Kështu që, në muajin e fundit, antitruapat e nënës, të cilët lejohen të kalojnë në gjakun e foshnjës, do të jenë të gatshme që të mbrojnë foshnjën nga sëmundjet infektive kur të lind. ⁵⁰ Në muajt vijues, sistemi imunologjik i foshnjës fillon të prodhojë antitruapat e vet dhe antitruapat e nënës pushojnë së funksionuari.

Sikurse e kemi përmendur edhe më lart ky veprim, është një shembull i planit perfekt të krijimit të njeriut. Detajet e formimit të qenies njeri janë të llogaritura hollësisht në çdo muaj, në çdo ditë e në çdo minutë. Sistemet pa të meta ndalojnë materialin e dëmshëm që të arrijë foshnjën, por kur këto materiale nevojiten, sistemi i vjetër mënjanohet në bazë të planit të njejtë perfekt, dhe një i ri vendoset. Sigurisht se, ky perfeksion nuk vjen nga vendimi dhe vullneti i paramenduar i qelizave të cilat formojnë njeriun. Të gjitha këto gjëra janë dëshmi e krijimit të pakrahasueshëm të Zotit të Madhërishtëm.

Nga shembujt e dhënë, kuptojmë që secila fazë e zhvillimit të njeriut është e kontrolluar dhe ndodh sipas një plani perfekt të urdhëruar. Dhe secili njeri derisa është në fazën e fetusit, kalon nëpër këtë zhvillim të kontrolluar dhe rritet deri në pjekuri. Për individët e vetëdijshëm plani i veçantë dhe procesi perfekt në zhvillimin e njeriut janë manifestim i diturisë dhe mençurisë së përhershme të Zotit.



Një nga funksionet e placentës është që të mbrojë foshnjën nga qelizat mbrojtëse të nënës (lart). Por kjo mbrojtje vazhdon vetëm deri në muajin e caktuar. Në muajin e nëntë, kjo situatë ndryshon dhe antitropat e gjakut të nënës me ndihmën e placentës kalojnë në fetus (fotoja e madhe). Në gjashtë muajt e parë të jetës në botën e jashtme, qelizat imunologjike të foshnjës nuk formohen. Kjo do të ishte vdekje për foshnjën. Prandaj, është shumë e rëndësishme që placenta i lejon antitropat të kalojnë. Kjo është e qartë për secilin se qelizat që bëjnë kompromis me placentën janë të paafta që vetvetiu të shfaqin sjellje të tillë të vetëdijshme. Është Zoti Ai që i krijon këto qeliza dhe i inspiron ato për atë çfarë duhet bërë.

KRIJIMI NGA NJË PIKË

Gjatë nëntë muajve në mitrën e nënës, rritja vazhdon në mënyrë perfekte. Fetusi së pari hyn në mitër si një pikë lëngu dhe gradualisht kthehet në një qenie njerëzore.

Sikur aty të ishte edhe mungesa më e vogël e kordinimit në zhvillim, fetusi sigurisht se do të vdiste. P.sh. sikur truri të rritej më shpejt se sa eshtrat e kafkës, truri i fetusit do të shtrëngohej dhe do të kishte pasoja. Ky kordinim është po ashtu shumë i rëndësishëm në formimin e syve, mëlçisë, zemrës, organeve të tjera si dhe eshtrave që i rrethojnë. Zhvillimi i renditur i organeve është po ashtu shumë i rëndësishëm sepse, sikur veshkët të zhvilloheshin ngadalë dhe sistemi qarkullues të formohej me kohë, gjaku nuk do të pastrohej dhe trupi do të helmohej.

Por kjo nuk ndodh dhe foshnja gati për të hapur sytë në botën e jashtme është krijuar duke kaluar në mënyrë perfekte nga një fazë në tjetrën.

Fuqia e vetme që krijon një qenie njerëzore komplet nga ajo që në fillim ishte vetëm një pikë lëngu është ajo e Zotit të Madhërishtëm, Zotit të universit.

Kur'ani tregon se si Zoti krijoi njeriun:

"A mendon njeriu se do të lihet të vazhdoj i pa vëzhguar?

A nuk ishte një pikë sperme e derdhur,

e pastaj një alaq (embrion) të cilin Ai e krijoi dhe i dha formë,


duke i bërë nga ai të dy gjinitë, mashkullin dhe femrën?

Ai I Cili e bëri këtë a nuk është në gjendje të sjell të vdekurin në jetë?"
(Kur'an, 75: 36-40)

Një individ që ballafaqohet me këtë të vërtet gjithmonë do t'i jetë falemnderues Zotit të tij që e krijoi atë nga një pikë lëngu dhe e formoi atë në një person që shikon, dëgjon dhe mendon.

Thuaj: "Është Ai I Cili ju solli në qenie dhe iu dha dëgjimin, shikimin dhe zemrat. Sa pak falemnderim tregoni!" (Kur'an, 67:23)






*All-llahu ju nxorri nga mitrat e nënave
tuaja kur nuk dinit asgjë, dhe ju dha
dëgjimin, shikimin dhe zemrat që të jeni
falemnderues. (Kur'an, 16: 78)*

DREJT NJË BOTE TË RE

Kur të gjitha përgatitjet të jenë kompletuar për fetusin që të hyjë në një botë të re, lëngu amniotik fillon të kryej aktivitete të reja. Lëngu amniotik formon fshikëza lëngu të cilat bëjnë që hyrja e mitrës të zgjerohet në një masë që lejon foshnjën të kaloj, dhe nuk lejon që foshnja të shtypet në mitër gjatë procesit të lindjes. Kur lindja fillon, fshikëzat shpërthehen dhe derdhen jashtë lëngun që përmbajnë, duke lyer dhe sterilizuar kanalet nëpër të cilat fetusin duhet të kaloj. Në këtë mënyrë lindja është më e lehtë dhe e mbrojtur nga bakteriet.⁵¹

Së bashku me këto përgatitje, në të njejtën kohë duhet të përmbushen edhe disa kushte të tjera në mitër në mënyrë që lindja të jetë e parrezikshme. P.sh. që foshnja të dal nga mitra, duhet të jetë në pozitën e duhur. Që të arrihet kjo, këmbët e foshnjës, bëjnë që të kthehet ngadalë derisa koka të jetë në qafën e mitrës. Tani foshnja është e madhe që të manevrojë, mundësia e lëvizjes së foshnjës është e zvogëluar dhe nuk mund t'a nxjerr kokën nga ajo pozitë.⁵² Por, si foshnja e palindur merr vendim se cila pozitë është e përshtatshme? Si e di pozitën më të mirë për lindje? Dhe, si fetusin në mitrën e nënës vendos se kur është koha për të lindur? Sigurisht këto janë gjëra shumë të rëndësishme për t'i menduar. Fakti që një qenie vetëdija e të cilës



Veza e fekunduar që të mbijetojë dhe të vazhdojë zhvillimin, ka nevojë për një vend të sigurt në trupin e nënës. Qelizat duhet të gjejnë një vend ku do të mbrohen dhe ushqehen, dhe ku linjda do të ndodh lehtë në muajin e nëntë. Mitra e nënës në mënyrë perfekte përmbush këto kërkesa. Foshnja strehohet në mitër për nëntë muaj. Në fund të muajit të nëntë, ndodhin proceset e nevojshme që të realizohet lindja. Kontrollimet janë bërë dhe foshnja bëhet gati që të merr hapin për në botën e jashtme

nuk është e zhvilluar ende vërteton se një sjellje e tillë e vetëdijshme është një tregues i qartë jo i vullnetit të saj, por i diturisë dhe i inspirimit të Zotit Krijuesit.

Gjatë procesit të lindjes, ka shumë shembuj të ndërtimit mahnitës që ju duhet kushtuar vëmendje. P.sh në mënyrë që lindja të kryhet me sukses, kafa e foshnjës duhet të ketë një ndërtim i cili nuk do të dëmtohet në kanalin e lindjes. Nëse shikojmë kafkën e foshnjës, do të shofim një grup prej 5 eshtrave me një vend të butë në mes tyre të quajtur 'fontanellë". Ky ndërtim i butë i jep kafkës një elasticitet që e mbron trurin dhe kafkën e foshnjës nga dëmtimet që mund të ndodhin nga shtypja gjatë lindjes. Para lindjes së foshnjës, përgatitjet bëhen nën kontroll të rreptë; masat paraprake ndërmerren në çdo aspekt. P.sh. lëngu amniotik futet në veprim që të lehtësoj lindjen dhe të pengoj infeksionin.

Lind pyetja: Kush ndikon që të gjitha këto përgatitje të kompletohen, dhe kush vendos që ka ardhur koha e lindjes? Kush kontrollon që sytë janë të gatshëm për të parë, mushkëritë janë të gatshme për të marrë frymë, nyjet janë të zhvilluara perfekt dhe truri është i formuar plotësisht?

Në trupin e zhvilluar të fetusit, nuk ka ndonjë mekanizëm të atillë që të kontrolloj këto gjëra. Truri, i cili pranohet si qendër kontrolluese e tërë trupit, është një organ që zhvillohet së bashku me fetusin. Edhe një tru i zhvilluar në mënyrë perfekte nuk mund të ndikojë në këtë fazë. Fetusi, i cili deri në atë moment është zhvilluar në mitrën e nënës, është plotësisht i paditur për ambientin e jashtëm. Ai nuk mund të vendos se është apo nuk është në gjendje të përshtatshme për një ambient të cilin kurrë nuk e ka parë. As nëna nuk është ajo e cila vendos për kohën e lindjes. Që prej ditës së parë, nëna nuk mund të ndërhyj në asnjë fazë të vetme të veprimeve që bëhen në trupin e saj; si pra ajo mund të vendos se kur këto faza kanë arritur kompletimin e tyre?

Nuk ka dyshim se është Zoti Ai që kontrollon çdo fazë të zhvillimit të foshnjës dhe vendos kur një njeri do të fillojë jetën e tij në këtë botë. Është vetëm Zoti, Ai I Cili krijon qenien njerëzore, I Cili e di çdo moment të jetës që ata do të bëjnë. Kur një njeri vjen në botë, Zoti e di edhe ditën në të cilën ai do të vdes. Vdekja do të vijë në një kohë të cilën Zoti e ka vendosur. Një person inteligjent i cili ka dije për këto fakte e di se çfarë duhet të bëjë: Ai duhet të mendoj rreth krijimit të tij dhe përsëri i dëshkohet fuqia e përhershme e Zotit të tij, dhe ai duhet të drejtojë tërë jetën në atë mënyrë që është e kënaqshme për Zotin.



Sistemi i ndërtuar në trupin e nënës për zhvillimin e foshnjës funksionon në mënyrë perfekte. Nëse foshnja, për çfarëdo arsye, lind pa u kompletuar këto zhvillime, ajo do të ketë nevojë për kujdesje të veçantë (majtas).


Njerëz! Nëse keni ndonjë dyshim për Ringjalljen, dini se Ne ju krijuam juve prej dheu, pastaj nga një pikë e spermës, pastaj prej një gjaku të ngjizur (alak), pastaj prej një cope mishi, të formuar por ende të paformuar, që Ne t'ua manifestojmë fuqinë Tonë. Ne bëjmë çfarë të duam ju lëmë në mitër deri në një afat të caktuar dhe pastaj ju nxjerrim si fëmijë dhe kështu të mund të arrini pjekurin e juaj të plotë. Disa vdesin të rinjë e disa jetojnë deri në pleqëri të thellë që tërë atë që dinin njëhere nuk e dijnë më. (Kur'an, 22: 5)

Ushqimi i Parë i Kësaj Bote: QUMËSHTI I NËNËS

Prej momentit që foshnja i hap sytë në këtë botë, trupi i saj duhet të adaptohet në një jetë të re. Çdo faktor që do të lehtësoj këtë adaptim është vendosur gjatë dhe pas shtatzënisë. Shembulli më i qartë i kësaj është faza e formimit të qumështit të nënës.

Formimi i qumështit të nënës është ofruar nga hormonet e nënës. Prodhimi i qumështit është i lidhur rrënjësisht me një hormon të quajtur 'prolaktin' që prodhohet nga pjesa e përparme e hipofizës në tru. Gjatë shtatzënisë, hormonet progesteroni dhe estrogeni të prodhuara nga placenta ndalojnë prolaktinën që të aktivizohet dhe të prodhojë qumësht. Por placenta nxirret pas lindjes kështu që shkaktohet rënje e progesteronit dhe e estrogenit në gjak; pas kësaj, prolaktina futet në veprim dhe kontribon në formimin e qumështit. Për shkak të këtij komunikimi në mes të hormoneve, një ushqim i tillë i vlefshëm si qumështi i nënës përgatitet saktësisht në momentin kur foshnja ka nevojë për atë. Në të vërtetë ky është një shkëmbim momental i informacionit. Derisa placenta është në trup, ajo kryen detyra vitale por në momentin e duhur ajo duhet të nxirret. Kjo sjell një zhvillim shumë të rëndësishëm për jetën e njeriut. Sikur që pamë, në fazat e krijimit të njeriut çdo gjë që ndodh kompletion njëra tjetrën. Sigurisht që, këto janë dëshmi të qarta se çdo njeri është i ndërtuar nga një fuqi supreme.

Të gjitha këto faza vazhdojnë edhe mbasi foshnja vjen në botë. Prodhimi i qumështit nga nëna rritet sipas nevojave të ushqyeshmërisë së foshnjës. Në ditët e para prodhohet deri në 50 g.; në muajin e gjashtë, prodhimi i



Çdo detaj në trupin e nënës është projektuar që të përmbush nevojat e foshnjës. P.sh. qumështi i nënës fillon të sekretohet (tajitet) me lindjen e foshnjës. Mirëpo gjatë shtatzanisë të gjitha përgatitjet e nevojshme për prodhimin e qumështit bëhen nën mbikëqyrjen e hormoneve të ndryshme. Qumështi përmban çdo material që foshnja ka nevojë. Kur mendojmë për cilësitë e tij në përgjithësi, qartë shohim se asgjë nuk mund të zëvendësoj qumështin e nënës.

qumështit mund të jetë aq i lartë sa të arrijë deri një litër. Shkencëtarët të cilët janë munduar të gjejnë formulën e qumështit të nënës pas hulumtimeve të gjata kanë qenë të pasuksesshëm sepse nuk ka lloj standard të qumështit të nënës. Në trupin e secilës nënë, qumështi prodhohet sipas nevojave të foshnjës së saj, dhe ky qumësht ushqen foshnjën në atë mënyrë që asnjë ushqim i huaj nuk mundet. Hulumtimet kanë treguar se antitruapat, hormonet, vitaminat dhe mineralet në qumështin e nënës përcaktohen nga nevojat e foshnjës.

Dallimi në Mes të Qumështit të

Nënës dhe Ushqimeve të Tjera

Përdorimi i materialeve të tjera ushqyese në vend të qumështit të nënës nuk përmbush komplet nevojat e foshnjës. P.sh. asnjë material tjetër ushqyes nuk përmban antitruapat e duhur për sistemin imunologjik të foshnjës.

Qumështi i lopës konsiderohet si material ushqyes klasik për foshnjët. Kur krahasojmë atë me qumështin e nënës, kuptojmë më mirë superioritetin e këtij të dytit. Në qumështin e lopës sasia e kazeinës është më e lartë se sa në qumështin e nënës. Kazeina është një proteinë që gjendet në qumështin e koagulluar (të thartë). Ky material zërthehet në copa më të mëdha në stomak

dhe e vështirson tretjen. Për këtë arsye, qumështi i lopës është më i rëndë për tretje se sa ai i nënës. Fakti që ky material gjendet në sasi më të ulët në qumështin e nënës e bën tretjen për foshnjën më të lehtë.

Këto dy lloje të qumështit po ashtu janë të ndryshme në aspektin e përbërjes së amino acideve. Për shkak të këtij dallimi, numri total i amino acideve prezente në palcën e foshnjës së ushqyer me qumësht lope është më i lartë; niveli i disa amino acideve është shumë i lartë ndërsa niveli i disa të tjerave është shumë i ulët. Kjo ka ndikim negativ në sistemin nervor dhe për shkak të përqindjes së lartë të proteinës, vendoset një barrë shtesë për veshkët.

Sheqeri është faktor tjetër që e bën qumështin e nënës të dallueshëm. Qumështi i nënës dhe qumështi i lopës përmbajnë llojin e njejtë të sheqerit-laktozës. Mirëpo sasia e laktozës në qumështin e njeriut (L / 7g) ndryshon nga ajo në qumështin e lopës (L / 4.8g). Përveç kësaj grimcat e mëdha të koaguluara të qumështit të lopës kalojnë shumë ngadalë nëpër zorrët e vogla. Për këtë arsye, sasi të mëdha të lëngut dhe të laktozës, të cilat janë të rëndësishme, absorbohen në pjesën e parë të zorrëve të vogla. Grimcat e koaguluara të qumështit të nënës (ndryshe nga ato të qumështit të lopës) kalojnë lehtë nëpër zorrët e vogla, dhe laktoza dhe lëngu arrijnë zorrët e mëdha. Kështu, zorrët zhvillohen në mënyrë të shëndetshme. Përparësia e dytë e sasisë së madhe të laktozës që gjendet në qumështin e njeriut është se siguron sintezën e materialit të quajtur 'cerebrozid', i cili luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e strukturave themelore të sistemit nervor.

Po ashtu niveli i yndyrës në qumështin e nënës dhe në qumështin e lopës është gati i njejtë por ndryshon në cilësi. Acidi linoleik në qumështin e nënës është yndyra e vetme e cila nevojitet për ushqyeshmërin e foshnjës.

Një faktor tjetër që dallon qumështin e nënës është sasia dhe proporcioni i kripës dhe mineraleve që ai përmban. P.sh. në qumështin e lopës sasia e kalciumit dhe e fosforit është e lartë; por proporcioni i kalciumit ndaj fosforit në qumështin e lopës e bën të vështirë që të tretet ashtu siç duhet. Fosfori mund të kombinohet me kalcium në aparatën e tretjes dhe faktikisht pengon thithjen e kalciumit. Kështu që, nëse foshnja ushqehet me qumësht lope në ditët e para të jetës, mund të shkaktohen anomali të caktuara si rrjedhojë e sasisë së ulët të kalciumit në gjak.

Veç kësaj, qumështi i njeriut përmban 50% hekur. Për shkak që qumështi i lopës përmban një proporcion shumë më të ulët të këtij minerali, foshnjat e ushqyera me qumësht të lopës mund të kenë anemi që është e lidhur me pamjaftueshmërinë e hekurit.

Përmbajtja e pasur me vitamina është një faktor tjetër që e bën qumështin e nënës të domosdoshëm. Nga pikëpamja e vitaminave që përmbajnë, qumështi i nënës dhe qumështi i lopës janë mjaft të ndryshëm. Niveli i vitaminës A është i njejtë, por niveli i vitaminave E, C dhe K është më i lartë në qumështin e nënës. Sasia e vitaminës D në qumështin e nënës është e mjaftueshme për nevojat e foshnjës.

Qumështi i Nënës e Mbron Foshnjën në Çdo Fazë


Foshnja që është duke ardhur në botë nga vendi i mbrojtur – mitra e nënës pa bakterie – duhet të luftojë kundër bakterieve të botës së jashtme. Një nga veçoritë më të rëndësishme të qumështit të nënës është që ai e mbron foshnjën nga infeksionet. Qelizat mbrojtëse (antitruapat) që kalojnë nga qumështi i nënës te foshnja bëjnë që foshnja të fillojë të luftojë kundër bakterieve të panjohura sikur të ishte e informuar përpara. Një funksion posaçërisht mbrojtës e kryejnë antitruapat që gjenden në sasi të mëdha në 'kolostrum' – është qumështi i nënës, që sekretohet (tajitet) në ditët e para mbas lindjes.

Kjo mbrojtje të cilën e ofron qumështi i nënës (mbrojtje nga infeksionet e lehta e deri te ato më serioze), është i rëndësishëm vital për muajt e parë, dhe dobitë e tij rriten në proporcion me periudhën e të ushqyerit në gjë.

Dobitë për foshnjën nga qumështi i nënës bëhen më të dukshme për çdo ditë që kalon. Një nga gjërat që shkencëtarët kanë zbuluar për qumështin e nënës është se ai është tejet i dobishëm për foshnjën deri në dy vjet.

Rëndësia e këtij zbulimi të kohëve të fundit është shpallur në Kur'an 14 shekuj më parë:

Ne e kemi udhëzuar njeriun sa i përket prindërve të tij. Bartja e tij i shkaktoi nënës së tij mund dhe pas dy vitesh ia ndau gjirin: Falemndero Mua dhe prindërit. Unë jam destinacioni yt final." (Kur'an, 31: 14)



*...Zoti im përfshin të gjitha gjërat në diturin e
Tij kështu që a nuk do të kushtoni vëmendje?
(Kur'an, 6: 80)*

EMBRIOLOGJIA HEDH POSHTË GJËNJESHTRËN E EVOLUCIONIT

Lindja është një dëshmi e një krijimi suprem, megjithatë evolucionistët përpiqen që të adresojnë atë në mbrojtje të teorisë së tyre. Procesi i krijimit të njeriut që kalon nëpër faza që zhvillohen sipas një skeme tepër delikate, në ditët e sotme është një fakt i padiskutueshëm në fushën e embriologjisë. Prandaj si ka mundësi që evolucionistët mundohen të interpretojnë këtë fakt të krijimit në adresim të teorisë së tyre?

Në fund të shekullit të 19^{te}, biologu evolucionist Ernst Haeckel propozoi tezën e tij, "Ontologjia Përsërit Filogjenin". Në këtë tezë, Haeckel pohoi se embrionet e gjalla në procesin e zhvillimit të tyre përsërisin procesin evolutiv nëpër të cilin kanë kaluar stërgjyshërit e tyre. P.sh. ai propozoi se një embrion njeriu në mitrën e nënës së tij paraqet karakteristikat e një peshku, pastaj të një zvarraniku para se përfundimisht të kthehet në një qenie njeriu.

Së shpejti u kuptua se kjo tezë nuk pasqyrore fakte. Gushëzat të cilat supozoheshin se paraqiteshin në periudhën e parë të embrionit të njeriut faktikisht ishin kanali i brendshëm i veshit, gjëndrrat paratiroide dhe timusi; pjesa e embrionit që i ngjante të verdhës së vezës në të vërtetë ishte qesja përgjegjëse për prodhimin e gjakut të foshnjës; pjesa e cila mendohej të ishte bishti u identifikua se ishte shtylla kurrizore.

Këto tashmë janë fakte të vërtetuara nga shkenca. Pak kohë pasi Haeckel propozoi teorinë e tij, vetë evolucionistët pranuan se pohimi i tij nuk ishte i saktë. Dy udhëheqës neo-Darvinistë, George Gaylord Simpson dhe W. Beck vërtetuan pavlefshmërinë e kësaj teorie:


Haeckel deklaroi gabim përfshirjen e parimit evolutiv. Tash është plotësisht e vërtetuar se ontologjia nuk e përsërit filogjenin.⁵³

Vlefshmëria e teorisë së Haeckel-it gjithashtu u hodh poshtë në debatin shkencor më 1920. Pas kësaj, më 1950, teoria u hoq plotësisht nga tekstet mësimore.⁵⁴

Vizatimet e Falsifikuara

Në propozimin e teorisë së tij, Haeckel nuk veproi në kundërshtim me traditën e shkencëtarëve evolucionistë; ai bëri vizatime imagjinuese që të ilustronte idetë e tij. Madje kur embriologjia u zhvillua dhe u zbulua se vizatimet ishin të falsifikuara, ai pranoi se nuk kishte ndjekur ndonjë shteg të ndryshëm nga kolegët e tij:

Pas këtij pohimi kompromentues të falsifikimit do të isha i obliguar të konsideroja vehten të dënuar dhe të asgjësuar sikur të mos kisha ngushëllimin që shikoj në bankën e të pandehurve krah për krah me mua qindra bashkë-fajtorë në mesin e tyre shumë vëzhgues të besuar dhe biologjistë të respektuar. Pjesa më e madhe e të gjitha skicimeve në librat më të mirë shkollorë të biologjisë, librat mësimor dhe revistat duhet të bartin në të njejtën shkallë përgjegjësinë e 'falsifikimit', pasi të gjitha ato janë të pasakta, dhe pak a shumë janë të falsifikuara, skematizuara dhe të konstruktura.⁵⁵




Evolucionisti Haeckel nuk hezitoi të sajoi dëshmi. Mirëpo me përparimin e shkencës, u zbulua se skenari i Haeckel-it ishte krejtësisht imagjinues.



Në vizatimet e sajura (fabrikuara) të Haeckel-it, embrionet e gjallesave të ndryshme ishin vendosur krahpërkrah në përpjekje për të lënë përshtypje se ato kishin ngjajshmëri ndërmjet tyre. Në mënyrë që të paraqiste ngjajshmërinë ndërmjet embrionit të njeriut dhe atij të peshkut, Haeckel bëri ca shtesa në disa pjesë dhe hoqi disa pjesë të tjera. Sikur në të gjitha falsifikimet e tjera të evolucionistëve, qëllimi këtu ishte të ofrohen dëshmi false për evolucionin. Mirëpo fotografitë e këtyre embioneve qartë paraqesin falsifikimin e Haeckel-it. Këto fabrikime janë vetëm një dëshmi se teoria e evolucionit është mashtrim i themeluar në falsitet.

Nga ky pranim mund të kuptohet se përpjekjet e Haeckel-it për të përdorur embriologjinë si një dëshmi për evolucionin janë plotësisht pa bazë dhe asgjë më shumë se arsyetim i shtrembër. Detajet për krijimin e njeriut që i kemi dhënë në rrjedhën e këtij libri janë dëshmi të pamohushme të së vërtetës së krijimit.



*A nuk menduan ata se All-Ilahu krijoi qiejt dhe tokën dhe
çdo gjë mes tyre për një përfundim të vlefshëm dhe për
një afat të caktuar? Megjithatë shumë njerëz mohojnë se
ata do të takojnë ndonjëherë Zotin e tyre.
(Kur'an, 30: 8)*

PËRFUNDIM

Secili në botë shkoi në mitrën e nënës së tij si një spermatozoid i vetëm, nën kushte të krijuara në mënyrë të veçantë, u bashkua me një vezë. Pas kësaj, ai filloi jetën si një qelizë e vetme. Ti po ashtu ishe në këtë process, po ashtu nëna jote, babai yt, vëllezërit dhe motrat, shokët dhe ata që i njeh dhe njerëzit të cilët nuk i njeh. Jo vetëm ata që sot janë gjallë, por secili nga qenia e parë njerëzore deri të anëtarët e gjeneratës së sotme, kanë kaluar nëpër fazat e mrekullueshme të spjeguar në këtë libër.

Gjatë muajve që embrionet në rritje nuk kanë as dijeninë më të vogël për ekzistencën e tyre, Zoti u jep formë trupave të tyre dhe krijon secilin në një njeri të tërë nga një qelizë e vetme. Është detyrë e secilit që jeton në faqen e tokës të marrë në konsideratë këtë të vërtetë...


Dhe është detyra e juaj të mendoni se si erdhët në ekzistencë, dhe t'i jeni mirënjohës Zotit I Cili ju krijoi juve.

Mos harro se Zoti I Cili njëherë krijoi trupin tënd do të krijoj atë edhe njëherë pas vdekjes dhe do të kërkojë llogari.

Kjo është shumë e lehtë për Zotin, Zotëruesin e fuqisë së përhershme

Mirëpo, ata të cilët e harrojnë krijimin e tyre dhe e mohojnë Zotin dhe Ditën e Gjykimit janë të shkuajdesur në ekstrem. Në Kur'an Zoti i drejtohet atyre në këtë mënyrë:

A nuk e sheh njeriu se Ne e krijuam atë nga një pikë, dhe ja ku është, një kundërshtar i hapur. Ai na bën Neve shembuj dhe harron krijimin e vet, duke thënë: 'Kush ju jep jetë eshtrave kur ato të jenë kalbur?' Thuaj 'Ai I Cili i bëri ato për herën e parë do t'i kthejë në jetë. Ai ka dije të plotë për çdo gjë të krijuar.' (Kur'an, 36: 77-79)



*Çka! A janë ata në dyshim për takimin me
Zotin e tyre? Çka! A nuk i përfshin Ai të gjitha
gjërat? (Kur'an, 41:54)*

EVOLUCIONI IDE E GABUAR

Çdo detaj në univers argumenton drejt një krijimi superior. Materializimi, i cili përpiqet të mohoj faktin e krijimit në univers, s'është asgjë tjetër përveç se një falsitet anti shkencor.

Kur materializmi të shfuqizohet, të gjitha teoritë e tjera të bazuara në këtë filozofi bëhen të pabaza. Kryesorja e tyre është Darwinizmi, ajo është, teoria e evolucionit. Kjo teori, e cila thotë se jeta zuri fill nga materia e pajetë nëpërmes rastësisë, është hedhur poshtë me njohjen se Zoti e ka krijuar universin. Astrofizikanti amerikan Hugh Ross shpjegon si vijon:

Ateizmi, Darwinizmi, dhe në të vërtetë të gjitha 'teoritë' që burojnë nga filozofitë prej shekullit të 18^{të} deri në shekullin 20^{të} janë të ndërtuara në supozim, në supozim të gabuar, se universi është i pafund. Mënyra e veçantë n'a solli neve ballë për ballë me shkakun – apo shkaktarin – matanë/prapa/para universit dhe gjithë atë që përmban, duke përfshirë edhe vetveten.⁵⁶

Zoti është Ai që e krijoi universin dhe Ai e ndërtoj atë deri në detajet më të vogla. Prandaj, është e pamundur që teoria e evolucionit, e cila konsideron se qeniet e gjalla janë prodhime të rastësisë, të jetë e vërtetë.

Natyrisht që, kur e shikojmë teorinë e evolucionit, kuptojmë se kjo teori është shpallur e pavlefshme nga zbulimet shkencore. Ndërtimi i jetës është jashtëzakonisht kompleks dhe i mrekullueshëm. P.sh. në botën e pajetë

mund të studiojmë se sa të ndjeshme janë balancet në të cilat qëndrojnë atomet, ndërsa, në botën e gjallë mund të vështrojmë se në çfarë ndërtimi kompleks janë bashkuar atomet, dhe sa të jashtëzakonshëm janë mekanizmat dhe strukturat me të cilat janë prodhuar proteinat, enzimet dhe qelizat.

Ky ndërtim i jashtëzakonshëm i jetës zhvlerësoj Darwinizmin në fund të shekullit të 20^{te}.

Me këtë temë jemi marrë në detaje në disa nga studimet tona të tjera, dhe do të vazhdojmë akoma të njejtën gjë. Por, duke pasur parasysh rëndësinë e saj, do të jetë e dobishme që po ashtu të bëhet një përmbledhje edhe këtu.

Dështimi Shkencor I Darwinizmit

Ndonëse është një doktrinë që ka fillimet e saj që nga Greqia e lashtë, teoria e evolucionit u avancua gjerësisht në shekullin e 19^{te}. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri këtë teori temën kryesore të botës së shkencës ishte libri i Charles Darwin-it i titulluar Origjina e Llojeve e botuar me 1859. Në këtë libër, Darwin-i mohonte se Zoti i krijoj llojet e ndryshme të gjalla në tokë veç e veç. Sipas Darwin-it, të gjitha gjallesat kanë një stërgjysh të përbashkët dhe ato me kalimin e kohës ndryshuan nga njëra-tjera nëpërmjet ndryshimeve të vogla.

Teoria e Darwinit nuk bazohej në ndonjë zbulim konkret shkencor; siç e pranoi edhe vet, ajo ishte vetëm një 'supozim'. Veç kësaj, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare, këtë e pranoi edhe vet Darwin-i në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar 'Vështirësitë e Teorisë'.

Darwin-i mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, duke shpresuar se do të zgjidhnin 'Vështirësitë e Teorisë'. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive.

Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegoj në asnjë mënyrë se si zuri fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se 'mekanizmat e evolucionit' të propozuara nga kjo teori, posedojnë ndonjë force evoluese.

3) Të dhënat fosile dëshmojnë plotësisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga teora e evolucionit.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:

Pengesa E Parë E Pakapërcyeshme: Zanafilla E Jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhën nga një qelizë e vetme e shfaqur në tokën primitive 3.8 miliarda vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, pse nuk gjenden gjurmë në të dhënat fosile. Kjo është njëra nga pyetjet në të cilat teoria nuk mund të përgjigjet.

Megjithatë, e para dhe kryesorja, që duhet pyetur në hapin e parë të procesit të supozuar evolutiv është: Si u krijua kjo 'qelizë e parë'?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo pohon se 'qeliza e parë' është shfaqur rastësisht brenda ligjeve të natyrës, pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar një qelizë të gjallë, si rezultat i rastësisë. Por ky është një pohim që bie ndesh bile edhe me ligjet më të pakontestueshme të biologjisë.

"Jeta Rrjedh nga Jeta"

Darwin-i, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Të kuptuarit primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai mbështetej në supozimin se gjallesat kishin një ndërtim shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishëm që ishte shumë e besuar në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, u bashkuan që të formojnë qenie të gjalla. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi që insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të dëshmuar këtë teori janë bërë eksperimente të çuditshme. Pak grurë vendosej në një leckë të ndotur, dhe besohej që pas një kohë do të formoheshin minjtë. Në mënyrë të ngjajshme, krimbat në mish supozohej

se ishin dëshmi e krijimit spontan (që krijoheshin vetvetiu). Por më vonë do të kuptohej që krimbat nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që barteshin aty nga mizat.

Kur Darwin-i shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteriet formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darwin-it, Louis Pasteur shpalli rezultatet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata të cilat hodhën poshtë krijimin spontan, i cili përbënte gur themelin e teorisë së Darwin-it. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonne në vitin 1864, Pasteur tha: 'Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.'⁵⁷

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasteur-it. Mirëpo zhvillimi i shkencës që nxorri në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e dëshmoi tejet pa rrugëdalje iden se jeta erdhi ne ekzistencë rastësisht.

Përpjekjet E Pafrytshme Të Shekullit Njëzet

Evolucionisti i parë, i cili u morrë me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Alexander Oparin. Me teza të ndryshme që i ngriti në vitet 1930, ai u mundua të dëshmoj se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime dolën të pasuksesshme dhe Oparin detyrohet të pranoj këtë: Megjithatë, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.⁵⁸

Pasuesit evolucionistë të Oparin-it u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u bë nga



Me eksperimentet që bëri, Louis Pasteur zhvlerësoj pohimin se 'materia e pajetë mund të krijoj jetë', i cili pohim përbën themelin e teorisë së evolucionit.

kimisti amerikan Stanley Miller në vitin 1953. Duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën e lashtë të tokës në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Miller formoi disa molekula organike (amino acide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Disa vite më pas zbulohet se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të tokës.⁵⁹

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Miller pranoi se mjedisi atmosferik që kishte përdorur nuk ishte real.⁶⁰

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorrën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Jeffrey Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën 'Earth (Toka)', pranoi këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim qysh në fillim të këtij shekulli: Si zuri fill jeta në tokë?⁶¹

Struktura e Ndërlikuar e Jetës

Shkaku kryesor që teoria e evolucionit rreth zanafillës së jetës përfundoi në një gjendje të tillë pa rrugëdalje është se edhe ato organizma të gjallë që mendohej të jenë nga më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se sa të gjitha prodhimet teknologjike të prodhuara nga njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuar të botës, nuk mund të prodhohet një qelizë e vetme nga bashkimi i materieve kimike organike.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësinë. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} për një proteinë mesatare me 500 amino acide. Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen të pamundura.

Molekula e ADN-së, e cila është e vendosur në bërthamën e qelizës dhe e cila mban informacionin gjenetik, është një bankë e jashtëzakonshme të dhënash. Është llogaritur që sikur informacioni i koduar në ADN të shkruhej në letër, do të krijohet një bibliotekë gjigante me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secila.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë tepër interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Për vetë faktin që janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo hedh poshtë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu. Prof. Leslie Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në shtator të vitit 1984 në botimin e revistës Scientific American:


Është krejtësisht e pamundur që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundur ekzistenza e njëres pa tjetrën. Si përfundim, që në shikim të parë, njeriu duhet të arrijë në konkluzion se jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike. ⁶²

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u "krijua" në një mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

Mekanizmat Imagjinues të Evolucionit

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darwin-it të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si "mekanizma të evolucionit", u kuptua se në të vërtetë nuk kanë forcë evoluese.

Darwin-i në tërësi e mbështeti deklaratën e tij të evolucionit në mekanizmin e "seleksionimi natyror." Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi kuptohet qartë nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror"...



Një nga faktet e shfuqizimit të teorisë së evolucionit është ndërtimi jashtëzakonisht i ndërlikuar i jetës. Molekula e ADN-së e lokalizuar në bërthamat e qelizave të qenieve të gjalla është një shembull. ADN-ja është një lloj banke të dhënash e formuar me rregullimin e katër molekulave të ndryshme në radhitje të ndryshme. Kjo bankë të dhënash përmban kodet e të gjitha tipareve fizike të asaj qenie të gjallë. Sikur ADN-ja e njeriut të shkruhej në letër, është llogaritur se kjo do të rezultonte në një enciklopedi të përbërë prej 900 volumeve. Është e padiskuteshme që informacioni i tillë i jashtëzakonshëm definitivisht e përgënjeshtrohet konceptin e rastësisë.

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh. në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë ato që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallesë, për shembull, në kuaj.

Prandaj, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk ka asnjë forcë evoluese. Edhe Darwin-i ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.⁶³

Ndikimi i Lamarck-ut

Pra, si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darwin-i, kësaj pyetje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Lamarck, i cili ka jetuar para Darwin-it, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës tiparet të cilat i kishin fituar gjatë

jetës së tyre dhe këto tipare duke u akumuluar nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, sipas Lamarck-ut, xhirafat evoluan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të ngrënë gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga brezi në brez.

Edhe Darwin-i ka dhënë shembuj të ngjashëm, dhe në librin e tij Origjina e Llojeve, ai thotë se disa arinj duke u futur në ujë për të gjetur ushqim me kalimin e kohës u shndërruan në balena ⁶⁴

Por ligjet e trashëgimisë të zbuluara nga Mendel-i, të cilat u vërtetuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e 20^{të}, hodhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së tipareve të fituara në brezat pasues. Kështu, seleksionimi natyral ra nga përkrahja si një mekanizëm evolutiv.

Neo-Darvinizmi dhe Mutacionet

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët në fund të vitit 1930 nxorën 'Teorinë Sintetike Moderne', apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmi. Përveç mutacionit natyrorë, Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet si 'shkaqe të ndryshimeve të dobishme', të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të jashtëm siç janë rrezatimi apo gabimet në replikim.

Në ditët e sotme, modeli që qëndron për evolucionin është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave si: veshët, sytë, mushkëritë dhe krahët iu nënshtruan 'mutacioneve,' domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk shkaktojnë zhvillimin e gjallesave; përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.


Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja ka një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund t'i shkaktojë vetëm dëm asaj. Gjenetisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vijim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që ndodhin në një mënyrë krejt të rastësishme; çdo ndryshim i rastësishëm në një sistem tejet të rregulltë ndikon negativisht, e jo në të mirë.

Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregulltë siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.

65

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një 'mekanizëm i evolucionit,' është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë ato të gjymtuara. (Efekti më i shpeshtë i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë 'mekanizëm evolutiv.' Në anën tjetër, seleksionimi natyror, siç e ka pranuar edhe vet Darwin-i, 's'mund të bëj asgjë i vetëm'. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë 'mekanizëm evolutiv' në natyrë. Meqenëse nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, nuk ka mundur të ndodhë as ndonjë proces i imagjinuar i quajtur 'evolucion'.



Qysh nga fillimi i shekullit, evolucionistët janë përpjekur të prodhojnë mutacione të mizave të frutave, dhe të japin këtë si një shembull të mutacionit të dobishëm. Mirëpo, rezultati i fituar në fund të këtyre përpjekjeve që zgjati me dekada ishin mizat e shëmtuara, të sëmura dhe me të meta.

Të Dhënat Fosile: Asnjë Gjurmë e Formave Kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas teorisë së evolucionit, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Sipas kësaj teorie, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe kohore prej miliona vitesh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk-gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat do të kishin disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët do të kishin disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqenëse këto gjallesa do të ishin në një fazë tranzicioni (kalimtare), ato duhet të kenë qenë të gjymtuara, të dëmtuara dhe me të meta. Evolucionistët këto qenie imagjinuese, të cilat ata besojnë se jetuan në të kaluarën, i quajnë "forma kalimtare".

Nëqoftëse me të vërtetë kanë ekzistuar këto gjallesa, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojlojshmëria. Më e rëndësishmja është se mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darwin-i, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup sigurisht që duhet të kenë ekzistuar... Si rrjedhim, dëshmitë që ato ekzistuan më parë do të mund të gjenden në mbetjet fosile." ⁶⁶

Shpresat e Shpartalluara të Darwin-it

Megjithatë, edhe pse evolucionistët kanë bërë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të 19^{ësë} në mbarë botën, ende nuk është

FOSILET E GJALLA

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



KARKALECI I DETIT



195 MILION VITE I VJETËR FOSILI I KARKALECIT TË DETIT



PILIVIESA



150 MILION VITE I VJETËR FOSILI I PILIVESËS



MILINGONA



100 MILION VITE I VJETËR FOSILI I MILINGONËS



PESHKAQENI



400 MILION VITE I VJETËR FOSILI I PESHKAQENIT

gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në tokë u shfaq vullshëm dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse është evolucionist, e pranon këtë realitet:

Çështja paraqitet që tek analizojmë të dhënat fosile në hollësi, qoftë në nivel të rradhitjes apo llojeve, vazhdimisht hasim – jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një grupi në llogari të tjetrit.⁶⁷

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe plotësisht të formuara, pa asnjë formë të ndërmjetme. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darwin-it. Gjithashtu, është një dëshmi shumë e fortë se gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucioni, në mes tyre, sjellin shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë shfaqur të zhvilluara plotësisht ato duhet të jenë zhvilluar me anë të ndonjë procesi të modifikimit nga specie që kanë ekzistuar më parë. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.⁶⁸

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në tokë të zhvilluara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera ‘origjina e llojeve,’ në kundërshtim me supozimin e Darwin-it, nuk është evolucioni, por krijimi.

Përralla E Evolucionit Të Njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Pohimi darvinist konsideron se njerëzit modern të ditëve të sotme kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë këtij procesi evolutiv të supozuar, e cila supozohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar disa ‘forma kalimtare’

ndërmjet njeriut modern dhe të parëve të tij. Sipas këtij skenari plotësisht të imagjinuar, janë të radhitura katër 'kategori' bazë:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët të ashtuquajturin paraardhësi i parë i njeriut i ngjajshëm me majmunin e quajten 'Australopitek'.

Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Studimet e shumta të bëra në mostrat e Australopitekëve nga dy anatomist të famshëm botëror nga Anglia dhe SHBA-të, Lordit Solly Zuckerman dhe profesorit Charles Oxnard, tregojnë që këto i përkisnin një lloji të zakonshëm të majmunëve të zhdukur dhe nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.⁶⁹

Evolucionistët klasifikojnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor si 'homo,' që domethënë 'njeri'. Sipas pohimit evolucionist, qeniet e gjalla të serisë 'homo' ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët sajuan një skicim të imagjinuar duke rregulluar fosile të ndryshme të këtyre krijesave në një radhitje të posaçme. Ky skicim ishte imagjinues sepse kurrë nuk është dëshmuar se ka një lidhje evolutive në mes të këtyre klasave të ndryshme. Ernst Mayr, njëri prej ithtarëve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij Një Argument i Gjatë pohon se: 'në veçanti enigmat historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t'i rezistojnë edhe një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.'⁷⁰

Duke radhitur zinxhirin si Australopitek > Homo Habilis > Homo Erectus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie janë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet e fundit të paleo-antropologëve nxorrën në dukje se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erectus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.⁷¹

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erectus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.⁷²

Kjo situatë dëshmon qartë pavlefshmërinë e pohimit që pretendon se ata janë stërgjyshër të njëri tjetrit.

Një palentolog nga universiteti Harvard, Stephen Jay Gould, shpjegon këtë situatë pa rrugëdalje të teorisë së evolucionit megjithëse edhe vet është evolucionist:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.⁷³

Me pak fjalë, skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të disa krijesave imagjinuese 'gjysmëmajmun-gjysmënjeri', që shfaqen në media apo libra shkollorë, me anë të mjeteve propaganduese, është sinqerisht, asgjë tjetër pos një përrallë pa bazë shkencore

Lordi Solly Zuckerman, një nga shkencëtarët më të famshëm dhe më të respektuar të Mbretërisë së Bashkuar, i cili studioj këtë çështje me vite dhe në veçanti për 15 vite studioj fosilet e Australopitekut, edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut. Zuckerman gjithashtu bëri interesant një 'spektër të shkencave'. Këtë spektër të shkencave ai e bëri duke i radhitur shkencat nga ato që ai i konsideronte më shkencore kah ato që i konsideronte më joshkencore. Sipas spektrit të Zuckerman-it, më 'shkencoret,' d.m.th. mbështetja në të dhëna konkrete, janë shkenca e fizikës dhe e kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më 'joshkencore', radhitet 'perceptimi jashtëshqisor' – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit vjen 'evolucioni i njeriut'. Zuckerman shpjegon kështu gjykimin e tij:

Pastaj ne lëvizim nga regjistri i të vërtetës objektive kah ato fusha të shkencës që konsiderohen shkenca biologjike, si: perceptimi jashtëshqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për besnikun (evolucionistin) gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (në



evolucion) ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.⁷⁴

Siç shifet, përralla e evolucionit njerëzor nuk është gjë tjetër veçse interpretime të paragjykuara të disa fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët verbërisht ndjekin teorinë e tyre.

Teknologjia E Syrit Dhe E Veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë në temën e syrit, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes 'si shikojmë ne?' Rrezet e dritës që vijnë nga ndonjë objekt, bien në retinën e syrit dhe japin një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, që quhet qendra e shikimit. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësi të plotë dhe drita nuk arrin vendin ku është i vendosur truri. Vendi i quajtur qendra e shikimit është një vend në errësi të plotë ku nuk hyn kurrë dritë; ka mundësi të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, në këtë errësi të plotë ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë.

Imazhi i formuar në sy është aq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngritni kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekрани më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i mirë i televizorëve në botë nuk mund të ofrojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për më shumë se 100 vite, mijëra inxhinierë janë përpjekur që të realizojnë këtë mprehtësi. Fabrika, e lokale gjigante janë ndërtuar, shumë hulumtime, plane e projekte janë bërë për këtë qëllim. .

Përsëri, shiko ekranin e TV-së dhe librin të cilin e mban në duar. Do të vëshesh një dallim të madh në mprehtësi dhe veçori. Veç kësaj, ekrani i televizorit paraqet imazh dy dimesional, ndërsa me sytë e tu, ti sheh pamje tre dimensionale me thellësi.

Për shume vite, dhjetra mijëra inxhinierë janë munduar të prodhojnë televizor tre dimensional, dhe të realizojnë cilësinë e imazhit të syrit. Po, kanë prodhuar sistem televizioni tre dimensional por është e pamundur të shikosh atë pa përdorur syza; veç kësaj, ai është një tre dimensional artificial. Prapaskena është më e turbullt, e plani i parë duket si një rregullim prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh i mprehtë dhe i dallueshëm sikurse ai i syrit. Edhe në kamera edhe në televizorë, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pohojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i rastësisë, se të gjitha atomet e tij ndodhi që të bashkohen dhe të prodhojnë këtë mjet që paraqet imazhe, çfarë do të mendonit? Si mundën atomet të bëjnë atë që mijëra njerëz nuk mundën?



Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë formuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt me laprën e veshit dhe ia drejton veshit të mesëm, veshi i mesëm i transmeton dridhjet e tingujve duke i përforcuar ato; veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin vlen edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë, tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri. Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Mirëpo, nëse në ato momente bëhet një matje e përpiktë e nivelit të tingujve në trurin tonë, do të kuptonim se aty mbizotëron një qetësi absolute.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Përkundër kësaj teknologjie dhe përpjekjeve të mijëra inxhinierëve dhe ekspertëve që punuan në këtë drejtim, nuk është ofruar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë; ose kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Prandaj, tingujt që prodhohen nga teknologjia e trupit të njeriut janë jashtëzakonisht të mprehta dhe të qarta.

Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë siç ndodh me HI-FI; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, të mprehtë e të qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

Deri me tash, asnjë aparat vizual apo inçizues të prodhuara nga njeriu nuk kanë qenë të ndjeshëm apo të suksesshëm në të dhënat e perceptimit shqisor ashtu siç janë veshi dhe syri.

Megjithëse, interesimi për shikimin dhe dëgjimin është shumë i madh, një fakt tepër më i madh qëndron prapa gjithë kësaj.

Kujt i Takon Vetëdija që Sheh dhe

Dëgjon në Brendi të Trurit

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafililit?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një vetëdije në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo vetëdije? Natyrisht që nuk ka dyshim se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo vetëdije është shpirti i krijuar prej Zotit. Shpirti nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor duhet të mendoj thellë për Zotin e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

Një Besim Materialist

Informacioni që kemi paraqitur deri këtu tregon se teoria e evolucionit është një pohim që bie në kundërshtim të hapur me faktet shkencore. Pohimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të shtyhet anash si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër tokën, gjatë historisë janë hequr nga agjenda e shkencës.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në agjendën shkencore. Madje disa njerëz përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si 'sulm ndaj shkencës'. Pse?

Arsyeja është se teoria e evolucionit është një besim dogmatik i domosdoshëm për disa qarqe. Këto qarqe i janë kushtuar filozofisë materialiste dhe e kanë pranuar Darwinizmin sepse është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Është mjaft interesant që nganjëherë ata e pranojnë këtë. Richard C. Lewontin, gjenetist i famshëm nga universiteti Harvard dhe po ashtu evolucionist i njohur pranon që është 'së pari materialist, pastaj shkencëtar':

Nuk është se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, pa marr parasysh se sa kundër intuitës janë, pa marr parasysh se sa të mjegullta janë për të paditurin. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë që në skenë të dal një Qenie Hyjnore.⁷⁵

Këto janë deklaratat e qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo thotë se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoj jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla: si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore u shfaqën prej materies së pajetë si rezultat i bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve, etj. Kjo është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe me

shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë me qëllim që 'të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.'

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili është Fuqplotë, I Mençur dhe I Gjithëdijshëm. Ky Krijues është Zoti, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, e ndërtoj atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

Teoria e Evolucionit është Magjia më e Fuqishme në Botë

Duhet të bëhet e qartë se çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, i cili e përdor arsyen dhe logjikën e tij, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, që na përkujton paragjykimet e shoqërive pa njohuri të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lart, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijonin profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe të gjykojnë; shkencëtarë si Einstein (Ajnshajtini) dhe Galileo; artistë si Hemphrey Bogart, Frank Sinatra dhe Pavarotti; si edhe antilopa, drunj limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për 'magjinë më të fuqishme në histori.' Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër në këtë mënyrë nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit njerëzve, nuk i ka lejuar ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve të ndërtuar me duart e tyre nga fisi i Profetit Ibrahim apo adhurimi i Viçit të Artë nga populli i Profetit Musa.

Në të vërtetë kjo situatë paraqet mungesën e arsyes të cilën Zoti e ka përmendur në Kur'an. Ai shpall në shumë vargje se mendjet e disa njerëzve

do të jenë të mbyllura dhe ata do të jenë të pafuqishëm për të parë të vërtetën. Disa nga këto vargje janë si në vijim:

Sa për ata të cilët nuk besojnë, nuk ka ndryshim tek ata nëse ua tërheq vërejtjen apo nuk ua tërheq vërejtjen, ata nuk do të besojnë. Zoti ju ka mbyllur zemrat e tyre dhe dëgjimin dhe shikimi i tyre ka një perde. Ata do të kenë një dënim të tmerrshëm (Kur'an, 2: 6-7)

...Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Njerëzit e tillë janë si kafshët. Jo, ata janë bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Kur'an 7: 179)
Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lartë në të, ata vetëm do të thoshin: "Neve na është trulllosur shikimi. Apo ne jemi vënë nën një magji!". (Kur'an 15: 14-15)

Fjalët nuk mund të shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos thyhet për 150 vjet. Është e kuptueshme që një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme plot marrëzi dhe paarsyeshmëri. Mirëpo, 'magjia' është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën të cilët besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit pa të meta, disiplinë, arsye dhe vetëdije, planetin Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën, dhe gjallesat e mbushura me sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Zoti në Kur'an paraqet ngjarjen e Profetit Musa dhe të Faraonit që disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

Ai tha, "Hedhni ju". Dhe kur ata hedhën, ata lëshuan në sytë e njerëzve një magji dhe bën që ata të ndjejnë frikë prej tyre. Ata gatuan një magji jashtëzakonisht të fuqishme. (Kur'an, 7: 116)

Siç po shikojmë, magjistarët e Faraonit ishin të aftë të mashtronin të gjithë, përveç Profetit Musa dhe atyre që i besonin atij. Sidoqoftë, dëshmia që paraqiti Profeti Musa theu atë magji, apo 'gëlltiste atë që ata kishin

magjepsur" sikurse që e paraqet vargu.

E Ne e frymëzuam Musain (duke i thënë): "Hidhe shkopin tënd!" Dhe ai menjëherë gëlltiste atë që ata kishin magjepsur. Atëherë u dëshmuar e vërteta dhe ajo që ata bënë u pa se ishte gënjeshtër. (Kur'an 7: 117-118)

Siç shofim nga ky varg, kur njerëzit e kuptuan se ata ishin magjepsur dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët humbën gjithë kredibilitetin e tyre. Edhe në ditët tona, ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pohime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetën e tyre duke i mbrojtur ato, nëse nuk i braktisin ato, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë të shfaqet dhe magjia të prishet. Në të vërtetë, Malcolm Muggeridge, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshme do të çuditen se si një hipotezë aq jobindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e jashtëzakonshëm që ajo posedon. ⁷⁶

Ajo e ardhme nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do të kuptojnë se 'rasti" nuk është zot dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë me shpejtësi ka filluar të ngrihet prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që shohin fytyrën e vërtetë të teorisë së evolucionit po pyesin vehten me habi se si është e mundur që ishin të kapluar prej saj.

**Ata thanë "Lavdia të qoftë Ty!
Ne nuk kemi dituri tjetër përveç asaj që
na mësove Ti.
Ti je I Gjithëdijshmi, I Urti"
(Kur'an, 2: 32)**

SHËNIMET

1. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1005, 1017
2. Keith L. Moore, The Developing Human - Clinically Oriented Embryology, W. B. Saunders Company, 1983, Canada, s. 141
3. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1003
4. Guyton&Hall, Human Physiology and Mechanisms of Disease, 6. baskı, 1997, ABD, s. 649
5. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1004
6. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1005
7. Vander, Sherman, Luciano, İnsan Fizyolojisi, Bilimsel ve Teknik Yayınları Çeviri Vakfı, 1994, s. 654
8. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1006
9. Prof. Dr. Ahmet Noyan, Yaşamda ve Hekimlikte Fizyoloji, Ankara, Mart 1998, 10. baskı, s. 1113
10. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1005
11. Guyton&Hall, Human Physiology and Mechanisms of Disease, 6. baskı, 1997, ABD, s. 12; Gerard J. Tortora, Introduction to the Human Body The Essentials of Anatomy and Physiology, Biological Science Textbooks, 1997, s. 527
12. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1007
13. Guyton&Hall, Human Physiology and Mechanisms of Disease, 6. baskı, 1997, ABD, s. 659
14. Laurence Pernoud, J'attends un enfant, Pierre Horay, Paris, 1995, s.107
15. Prof. Dr. Ahmet Noyan, Yaşamda ve Hekimlikte Fizyoloji, Ankara, Mart 1998, 10. baskı, s. 1119
16. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1006
17. Lennart Nilsson, A Child is Born, Delacorte Press, NY, 1977, s. 22
18. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1005
19. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1007
20. Solomon, Berg, Martin, Villee, Biology, Saunders College Publishing, ABD, 1993, s. 1056
21. Gerard J. Tortora, Introduction to the Human Body The Essentials of Anatomy and Physiology, Biological Science Textbooks, 1997, s. 569-570
22. Solomon, Berg, Martin, Villee, Biology, Saunders College Publishing, ABD, 1993, s. 1066
23. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 28
24. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1034
25. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1039
26. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 33
27. Gerard J. Tortora, Introduction to the Human Body The Essentials of Anatomy and Physiology, Biological Science Textbooks, 1997, s. 556
28. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 38
29. Science et Vie, Mart 1995, sayı: 190, s. 48-50
30. Hoimar Von Ditfurth, Dinozamların Sessiz Gecesi 2, Alan Yayıncılık, 1997, s.126
31. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 42
32. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 42-43
33. Richard Dawkins, The Selfish Gene, Oxford University Press, New York, 1976, s. 37
34. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 34
35. Science et Vie, Mart 1995, sayı: 190, s. 48-50
36. Intimate Universe, The Human Body, Volume 1, 1998 British Broadcasting Corporation
37. Guyton&Hall, Tibbi Fizyoloji, Nobel Tıp Kitabevleri, İstanbul, 1996, 9. baskı, s. 1035
38. Science et Vie, Mart 1995, sayı: 190, s. 48-50
39. Solomon, Berg, Martin, Villee, Biology, Saunders College Publishing, ABD, 1993, s. 1069
40. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 73
41. Science Vie, Mart 1995, sayı: 190, s. 88
42. Science et Vie, Mart 1995, sayı: 190, s. 48-50
43. Hoimar Von Ditfurth, Dinozamların Sessiz Gecesi 2, Alan Yayıncılık, 1997, s.129-130
44. Keith L. Moore, The Developing Human - Clinically Oriented Embryology, W. B. Saunders Company, 1983, Canada, s. 374a
45. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 74
46. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 64
47. Keith L. Moore, The Developing Human - Clinically Oriented Embryology, W. B. Saunders Company, 1983, Canada, s. 126
48. Science et Vie, Mart 1995, sayı: 190, s. 48-50
49. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 87
50. Laurence Pernoud, J'attends un enfant, Pierre Horay, Paris, 1995, s.135
51. Laurence Pernoud, J'attends un enfant, Pierre Horay, Paris, 1995, s. 138
52. Geraldine Lux Flanagan, Beginning Life, A Dorling Kindersley Book, Londra, 1996, s. 103
53. G.G.Simpson, W.Beck, An Introduction to Biology, New York, Harcourt Brace and World, 1965, s. 241
54. Keith S.Thomson, Ontogeny & Phylogeny Recapitulated, American Scientist, cilt:76 Mayıs/Haziran 1988, s. 273
55. Francis Hitching, The Neck of the Giraffe: Where Darwin Went Wrong, New York, Ticknor and Fields 1982, sf.204
56. Hugh Ross, The Fingerprint of God, p. 50
57. Sidney Fox, Klaus Dose, Molecular Evolution and The Origin of Life, W.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
58. Alexander I. Oparin, Origin of Life, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
59. "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", Bulletin of the American Meteorological Society, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
60. Stanley Miller, Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules, 1986, p. 7.
61. Jeffrey Bada, Earth, February 1998, p. 40
62. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", Scientific American, vol. 271, October 1994, p. 78.
63. Charles Darwin, The Origin of Species by Means of Natural Selection, The Modern Library, New York, p. 127.
64. Charles Darwin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, Harvard University Press, 1964, p. 184.
65. B. G. Ranganathan, Origins?, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
66. Charles Darwin, The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition, Harvard University Press, 1964, p. 179.
67. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", Proceedings of the British Geological Association, vol 87, 1976, p. 133.
68. Douglas J. Futuyma, Science on Trial, Pantheon Books, New York, 1983, p. 197.
69. Solly Zuckerman, Beyond The Ivory Tower, Toplinger Publications, New York, 1970, pp. 75-94; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", Nature, vol 258, p. 389.
70. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final answers or by society's reluctance to pay the bills?" Scientific American, December 1992, p. 20.
71. Alan Walker, Science, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, Physical Anthropology, 1st ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, Olduvai Gorge, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
72. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist With Modern Humans," Time, 23 December 1996.
73. S. J. Gould, Natural History, vol. 85, 1976, p. 30.
74. Solly Zuckerman, Beyond The Ivory Tower, p. 19.
75. Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World," The New York Review of Books, January 9, 1997, p. 28.
76. Malcolm Muggeridge, The End of Christendom, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43.